

1 E mërkurë, 5 qershor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi merr pjesë përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
8 Seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
14 procesverbal, vërej që të gjithë të akuzuarit janë të
15 pranishëm në sallën e gjyqit me përjashtim të z. Krasniqi, që
16 na ndjek përmes videolidhjes.

17 Përpara sesa të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
18 Prokurorisë 04410, kemi një urdhër me gojë.

19 Trupi Gjykses ka marrë një kërkesë nga Mbrojtja e z.
20 Thaçi që të ndryshojë një vendim të mëhershëm të Trupit
21 Gjykses sa i takon përdorimit të dokumenteve nga ana e Trupit
22 Gjykses. Mbrojtja i kërkoi Trupit Gjykses t'i japë Mbrojtjes
23 materialet që synon të përdorin Gjykatësit gjatë pyetjeve që
24 t'i bëjnë dëshmitarit. Dhe këto materiale i nxirren në fakt
25 Mbrojtjes në bazë të rregullës 103 përveç materialeve që

1 nxirren sipas rregullës 102(3).

2 Trupi Gjykses përgatitet që të njoftojë siç duhet
3 Mbrojtjen dhe Prokurorinë edhe do të ndryshojë një urdhër të
4 mëhershëm të Trupit Gjykses të datës 19 mars 2024 dhe Trupi
5 Gjykses do të përpigjet që kur të mundet të njoftojë Ekipet e
6 Mbrojtjes dhe Prokurorinë lidhur me materialet që synon të
7 përdorë gjatë pyetjeve të veta paraprakisht.

8 Me kaq e mbyll urdhrin me gojë.

9 Tani mund të vijojmë me dëshmitarin.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Kur të vijë dëshmitari do t'i
11 lutesha Sekretares që të vendosë në ekran provën materiale
12 1268 në sekondën 30 në ekran. Këtë e bëj paraprakisht para se
13 të hyj dëshmitari.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ashtu për
15 procesverbal, desha t'ju thoja që ne sot do të jemi në seancë
16 publike.

17 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
19 Dëshmitar. Urojmë të keni pushuar.

20 Sot, do të fillojmë me dëshminë tuaj. Ju lutem të
21 përgjigjeni qartë me fjali të shkurtër. Flisni ngadalë ju
22 lutem. dhe në qoftë se nuk e kuptoni një pyetje, lirisht thoni
23 që pyetja të përsëritet që ta sqarojmë.

24 Gjithashtu, mos harroni të na thoni ku i bazoni ju
25 faktet, rrethanat, dijeninë që keni.

1 Jeni ende nën betim për të thënë të vërtetën sikurse vetë
2 e cituat përmes betimit solemn.

3 Flisni pranë mikrofonit, prisni pak përpara se të
4 përgjigjeni dhe një herë ju lutem flisni ngadalë për
5 përkthyesit që të kenë mundësi t'ju ndjekin.

6 Nëse keni nevojë për pushim, në çdo moment na thoni.

7 Aktualisht pyetjet do të vijojnë nga ana e Prokurorisë.

8 Vazhdoni, z. Halling.

9 DËSHMITARI: Nuhi Bytyqi [Vijon]

10 Pyetje nga z. Halling: [Vazhdim]

11 Z. HALLING: [Përkthim

12 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Kam disa pyetje ende për ju, do
13 filloj atje ku e lamë dje.

14 Do shihni në ekran, kjo është pjesa e dytë e dokumentarit
15 të Agim Qelaj ku dilte Hashim Thaçi që ju pyeta dje. Tani që
16 të vijojmë me pyetjen ku e lashë dje. Kur është bërë,
17 për afërsisht, kur është bërë intervista me Hashim Thaçin kjo
18 që shohim në ekran?

19 PË. Fillimisht, dua të them se Kryetari i Trupit Gjykses më
20 pyeti "A ke pushuar?". Unë kam pushuar pak. Sepse dje

21 Prokurori Halling më shqetësoi me disa informacione të
22 paverifikuara nëpër mediat e ndryshme për të cilat unë nuk

23 kisha njohuri deri më dje. Prandaj ju lus që të fokusoheni në

24 punën time si gazetar në gjërat që kam ndjekur unë dhe në

25 informacionet e konfirmuara nga unë.

1 Dje, për shembull, në mediat në Kosovë doli nga dëshmia
2 ime, nga një pjesë e dëshmisë sime doli shifra se janë vrarë
3 10.000 civilë serbë. Unë kam deklaruar se janë vrarë mbi
4 10.000 civilë shqiptarë. Gabime të tilla mund të bëjnë edhe
5 gazetarët edhe mediat prandaj të keni kujdes që njerëzit që
6 janë të akuzuar mos të ndëshkohen në bazë të disa shkrimeve
7 ose informacioneve të paverifikuara.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ju
9 lutem përpiquni -- t'u përgjigjeni pyetjeve që ju bën
10 Prokurori. Në qoftë se ka ndonjë problem me pyetjet, vendos
11 Trupi Gjykses nëse do të bëhet pyetja.

12 Dhe, gjithashtu, ne nuk e kontrollojmë dot çfarë boton
13 shtypi. Shpesh ndodh që dalin në shtyp gjëra që s'i kemi thënë
14 as ne. Kështu që ju lutem me aq sa të mundeni përpiquni t'i
15 përgjigjeni pyetjes që zgjedh të bëjë Prokurori.

16 Z. HALLING: [Përkthim]

17 PY. Pyetja që ju bëra ishte e thjeshtë. Kur është incizuar
18 intervista me z. Hashim Thaçi për këtë dokumentar?

19 PË. Kjo intervistë është incizuar në vitin 2009. Ka qenë,
20 mund të jetë qershor i vitit 2009.

21 PY. Faleminderit.

22 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem tani Sekretares të nxjerrë
23 në ekran materialin 061427-28 tek minuta 05:12. Dhe më pas ju
24 lutem të shohim nga minuta 05:12 deri në 05:58.

25 PY. Dëshmitar, do shohim një video tjetër në ekran. Do të

1 shohim pak nga kjo video dhe më pas do t'ju bëj pyetjet.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Edhe një herë për Sekretarinë
3 bëhet fjalë për videon me numër 061427-28. Jo kjo që po shohim
4 në ekran. Dhe duhet të shohim nga minuta 05:12.

5 [Luhet videoincizimi]

6 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe në transkript na nevojitet
7 faqja numër 1. Faleminderit. Tani mund ta shohim videon.

8 [Luhet videoincizimi]

9 [Zëri] "Tani Ushtri Çlirimtare e Kosovës i ka organizimin
10 e saj hierarkik, prej Shtabit të Përgjithshëm e deri në
11 instancat më të ulëta të saj. Ushtria Çlirimtare e Kosovës e
12 ka organizimin institucional dhe së shpejti në territoret e
13 lira që ka krijuar Ushtria Çlirimtare e Kosovës do të krijohet
14 pushteti ushtarako-civil, pushtet i popullit që do të jetë një
15 pushtet i pavarur dhe funksional, tani të gjitha këto së
16 shpejti do të njihet edhe opinionin e mbrendshëm".

17 Z. HALLING: [Përkthim]

18 PY. Dëshmitar, e njihni këtë incizim?

19 PË. Po.

20 PY. Na përshkruani çfarë është, çfarë po shohim?

21 PË. Po kjo është një pjesë film dokumentar kushtuar Ushtrisë
22 Çlirimtare të Kosovës që u transmetua më 18 korrik të vitit
23 1998 në televizionin shqiptar. Këtu z. Krasniqi flet në mënyrë
24 afirmative për organizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
25 sepse zëdhënësi e ka këtë detyrë. Në rrethanat si thashë edhe

1 dje që Kosova nuk e kishte shtetin e vet, nuk e kishte
2 ushtrinë e rregullt. Nevojitet që para opinionit zëdhënësi të
3 paraqesë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës sa më të organizuar në
4 mënyrë që te populli të dalë në Kosovë po dhe në mërgatë të
5 krijohet bindja e fuqishme se Ushtria Çlirimtare e Kosovës
6 është një ushtri që lufton për çlirimin e Kosovës dhe atë
7 duhet, ajo duhet të mbështetet nga i tërë populli
8 PY. Dëshmitar, e kuptoj që kjo pjesë e këtij incizimit ka
9 qenë pjesë e dokumentarit të 18 korrikut, por kur është
10 incizuar për herë të parë?

11 PË. Është incizuar pas betimit në Kleçkë, do të thotë, ato
12 ditë qershori, ka fundi i qershorit të vitit 1998.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ky është
14 pjesë e filmimit origjinal e cila është më pas përshtatur në
15 një dokumentar është bërë dhe është vendosur në një
16 dokumentar. Do të donim që të pranohej kjo si prova materiale,
17 pra, flasim për materialin me numrin 61427-28.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
19 kundërshtime?

20 Mesa shoh asnjë nga palët nuk ka kundërshtime. Materiali
21 061427-28.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo që po citoni është e gjithë
23 ERN, por ne ju luajtëm, treguam vetëm një pjesë dëshmitarit
24 për të komentuar.

25 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Më thanë që ka një gabim në

1 transkript, këtu në transkript ka dalë që ai ka thënë:

2 "... kjo ka qenë një nga detyrat e tij si zëdhënës."

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sqaroheni
4 vetë kur të bëni pyetjet këtë pjesë të transkriptit.

5 Prokuror, a doni të pranohet e tëra apo vetëm pjesa që
6 pamë?

7 Z. HALLING: [Përkthim] E tëra.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E keni fjalën
9 nga 27 te 28?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Është materiali me numër 061427-
11 28. Ky numër me këtë ERN.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. E
13 pranojmë.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Videoja, bashkë me
15 transkriptin përkues, merr numrin e provën materiale P01284
16 dhe klasifikimin aktual e kanë konfidencial.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
18 riklasifikohet si publike.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

20 Tani i lutem Sekretares të nxjerrë në ekran materialin
21 SPOE00204121, kjo është një fotografi.

22 PY. Dëshmitar, ndërkohë që presim të dalë fotografia në
23 ekran. Pas ceremonisë së betimit në qershor, a bëre incizime
24 të mëtutjeshme në Luzhnicë, në Bazrak?

25 PËRKTHYESJA: Përkthyesi nuk e kupton mirë emrin e fshatit

1 siç e shqiptoi Prokurori.

2 DËSHMITARI: Po, në qershor të vitit 1998, bashkë me Abaz
3 Zekën kemi bërë disa filmime edhe në fshatin Luzhnicë, në
4 Bajrak të Luzhnicës. Kjo është një fotografi e nxjerrë nga
5 incizimi ku është komandant Ismet Jashari, Kumanova, unë dhe
6 Kadri Veseli.

7 PY. Dëshmitar, mesa kuptoj ju identifikuat këta personat nga
8 e majta në të djathtë në fotografi, kështu?

9 PË. Po.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo është një
11 fotografi që e kemi zmadhuar nga libri i dëshmitarit, e kemi
12 zmadhuar që ta kishim më të lehtë për ta parë dhe do të
13 kërkonim që të pranohej si provë materiale. Fotografia
14 konkretisht është në faqen 283 dhe 284 të librit.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
16 kundërshtime? Mesa shoh nuk ka. Në rregull. Materiali me numër
17 SPOE00204121 pranohet.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Merr numrin e provës
19 materiale P01285. Klasifikimin aktual e ka konfidencial.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
21 riklasifikohet si material publik.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Tani i lutem Sekretares të vendosë
23 në ekran prova materiale P838, përndryshe me numër 061427-30
24 dhe të shkojmë tek minuta 06:44.

25 PY. Dëshmitar, në faqen 286 të librit ke përmendur për faktin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 9

1 që keni bërë një incizim të një mbledhjeje të UÇK-së me
2 civilët në Malishevë në fund të qershorit 1998, a ka ndodhur
3 kështu?

4 PË. Po. Më 29 qershor të vitit 1998 në Malishevë është
5 mbajtur një tubim me qytetarët e komunës së Malishevës ku
6 është biseduar për zhvillimet në atë periudhë në zonat e
7 luftës dhe për nevojën e mbështetjes më të fuqishme të
8 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për t'u përballuar sulmeve dhe
9 provokimeve të vazhdueshme të forcave serbe.

10 PY. Faleminderit.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Për Sekretarinë ju lutem faqja 2
12 në transkriptin e anglishtes. Ju lutem të shohim minutën 06:44
13 në 07:14.

14 [Luhet videoincizimi]

15 [Zëri] "Në emër të ushtarëve të njësitit Çeliku nëpër
16 vijat e frontit dhe në emër të ushtarëve të njësitit Lumi, po
17 ashtu vijave të frontit, ju përshëndesim. Njësitit Lumi-Çeliku
18 është një, pa marrë parasysh fjalët e diskutuara në terren.
19 Është një me komandën e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë
20 Çlirimtare të Kosovës. Andaj një herë e përgjithmonë të
21 lirohemi nga këto ngarkesa se ushtri mbi ushtri nuk ka,
22 ushtria nuk ka parti, është vetëm një".

23 Z. HALLING: [Përkthim]

24 PY. Dëshmitar, po ky incizim është pjesë e kësaj mbledhjes në
25 Malishevë që sapo diskutuat në dëshminë tuaj?

1 PË. Po. Ky është.

2 PY. Kush po flet këtu?

3 PË. Është Fatmir Limaj, komandant Çeliku.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Shohim sekondën e parë të të
5 njëjtës video po e mbani ekranin të ngrirë. Sekonda e parë,
6 vetëm për të parë kush është në podium. Kjo është minuta e
7 parë, ne jse sidoqoftë dhe kjo mjafton.

8 PY. Dëshmitar, a mund të na identifikoni kush janë personat
9 që shohim në ekran nga e majta në të djathtë?

10 PË. Po nga e majta në të djathtë është Fatmir Limaj, në mes
11 është Gani Krasniqi dhe në të djathtë është Shukri Buja.

12 PY. Gani Krasniqi apo Dini Krasniqi?

13 PË. Gani Krasniqi. Gani Krasniqi.

14 PY. Faleminderit.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Tani lutem të vendoset në ekran
16 materiali 096352-096352 në shqip dhe në anglisht.

17 Trupi Gjykses, videoja që sapo pamë është e pranuar si
18 provë materiale.

19 PY. Dëshmitar, në të majtë keni shqipen, e njihni?

20 PË. Po.

21 PY. A është nënshkrimi juaj ky në fund të faqes?

22 PË. Po, është nënshkrimi im.

23 PY. Dhe në krye jep datën 6 korrik 1998. Rreth kësaj periudhe
24 është dërguar kërkesa?

25 PË. Po.

1 PY. Çfarë është kjo kërkesë?

2 PË. Kjo është një kërkesë që në rrethanat e luftës të kishte
3 nevojë që ekipi, të cilin e udhëheqsha unë në zonat e luftës,
4 bashkë me Abaz Zekën dhe në mbështetje të Migjen Kelmendit, që
5 të kemi një teknikë për të bërë xhirimet me zonat e luftës,
6 sepse nuk e dinim sa mund të zgjasë lufta dhe duhet të
7 përgatiteshim për një periudhë më të gjatë për të informuar
8 opinionin se çka po ndodhë në Kosovë në zonat e luftës. Kjo
9 është kërkesë për blerjen e kamerave dhe disa pajisjeve tjera
10 teknike për montimin e misioneve të cilat planifikojmë t'i
11 xhironim në zonat e luftës.

12 PY. Kërkesa thotë: "Për Shtatën dhe Gjarprin"?

13 PË. Kush është Gjarpri?

14 PË. Gjarpri ka qenë Hashim Thaçi, Shtatëshi nuk e di, në atë
15 kohë ndoshta e kam ditë, po tash kam harru kush ka qenë
16 Shtatëshi me të vërtet.

17 PY. Nëse nuk e dije kush ishte Shtatëshi në atë kohë, atëherë
18 pse ia ke drejtuar Gjarprit dhe Shtatëshit?

19 PË. Po dy njerëzit me të cilët unë kam komunikuar në atë
20 periudhë. Kam menduar që ata mund të ndihmojnë sigurimin e kësaj
21 teknike.

22 PY. Që të jem i qartë, po thua që nuk të kujtohet më kush
23 është Shtatëshi apo nuk e ke ditur dhe në atë kohë kush ka
24 qenë Shtatëshi?

25 PË. Jo, e kam ditur, me siguri e kam ditur. Po tash nuk e di. Kam

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 12

1 harru singerisht mos ta them ndonjë emër gabim. Unë dua të jem
2 i përgjegjshëm, dua të jem shumë i saktë.

3 PY. Mbase do t'ju kujtohet një dëshmitari tjetër.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që
5 të pranohet dokumenti me numër 096352-096352.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
7 kundërshtime?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kam kundërshtime.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
10 kundërshtime. Materiali me numër 096352-096352 pranohet dhe
11 është me klasifikim publik.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti merr numrin e
13 provës materiale P01286. Për sqarim, desha t'ju thoja që ka
14 qenë fillimisht konfidencial dhe u riklasifikua si publik.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të jetë publik si dokument.

16 Materiali tjetër që do kërkoja të shfaqej në ekran është
17 K050-8439 deri në K050-8449 në faqen 4. Mund të vendoset e
18 plotë në ekran, ju lutem.

19 PY. Është në anglisht, por do të përkthehet. Ndërkohë që
20 presim të shfaqet dokumenti desha t'ju thoja këtë. Në faqen,
21 në librin tuaj, Dëshmitar, në faqen 842 është një fotografi e
22 kësaj, po në 17 tetor 1998 a ke bërë një intervistë me Jakup
23 Krasniqin për Zërin?

24 PË. Kur po thoni?

25 PY. Në 17 tetor 1998, keni bërë një intervistë?

1 PË. Po, e kam botuar në këtë datë këtë intervistë me z. Jakup
2 Krasniqi.

3 PY. Do t'ju lexoj një pjesë të asaj që shohim në ekran. Diku
4 mbi mesin e faqes.

5 "[Zëri] A ka të vërtetë në akuzat e Beogradit për krime
6 të supozuara të UÇK-së kundër popullatës civile serbe në
7 Kosovë?"

8 Përgjigja e Krasniqit:

9 "[Krasniqi] UÇK-ja gjithmonë ka deklaruar dhe po e
10 përsëris dhe tani, që nuk i ka marrë armët për të luftuar
11 civilët, por të luftojë policinë dhe forcat ushtarake. Shenjat
12 e tjera që UÇK-ja nuk është përfshirë me popullatën serbe
13 është për faktin që nuk ka djegur një shtëpi të vetme serbe,
14 nuk u ka plaçkitur pronat, nuk ka djegur asnjë kishë dhe asnjë
15 shkollë."

16 Dëshmitar, këto pyetje-përgjigje a janë pjesë e
17 intervistës së 17 tetorit 1998 për gazetën Zëri?

18 PË. Me siguri janë, po unë nuk e kam origjinalin këtu. Më
19 vjen keq, duhet ta qitni dhe origjinalin si dëshmi konkrete,
20 jo vetëm transkriptin. Duhet paralelisht me origjinalin ta
21 qitni dhe transkriptin jo vetëm transkriptin, jo në mënyrë
22 selektive. Në mënyrë shumë të njëanshme po punoni. Unë nuk e
23 di shumë mirë anglishten.

24 PY. Dëshmitar, nuk e kemi origjinalin të këtij dokumenti kemi
25 vetëm fotografinë e librit tuaj. Megjithatë shkojmë në faqen

1 1, këtu mund të shohim "Zëri në Shqip 17 tetor 1998", pak më
2 poshtë në faqe thotë:

3 "[Intervistë me Jakup Krasniqin zëdhënës i Ushtrisë
4 Çlirimtare të Kosovës, nga Nuhi Bytyqi ...]"

5 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që
6 të pranohet ky dokument sepse gjykojmë që përmbush kriteret e
7 pranueshmërisë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
9 kundërshtime?

10 DËSHMITARI: Meqenëse, Prokuror, meqenëse --

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar.

12 DËSHMITARI: Meqenëse ju pyetët --

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar.

14 DËSHMITARI: Meqenëse më pyetët --

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
16 një çast, ju lutem. Prisni pak.

17 Ka kundërshtime nga palët?

18 [Mikrofoni çaktivizuar].

19 Materiali me numër KO508439 në KO50-8449 pranohet.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti merr numrin e
21 provës materiale P01287 me klasifikimin aktual konfidencial.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të jetë një dokument publik.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mesa shoh nuk
24 ka kundërshtime, kështu riklasifikohet si dokument publik.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do të doja të shihnim në

1 ekran një material që u pranua dhe si provë prova materiale
2 shoqëruese, dokumenti ka numrin PO1256. Dhe ju lutem ta
3 vendosim tek sekonda e parë. Ndërsa transkripti është faqja 1.
4 PY. Dëshmitar, ndërkohë që presim të shohim materialin në
5 ekran, ju keni xhiruar paraqitjen e parë publike të Hashim
6 Thaçit, kështu?

7 PË. Po, e kam xhiruar.

8 PY. Ku e keni xhiruar këtë?

9 PË. Kjo është xhiruar në Fshatin e Ri, në fund të tetorit ose
10 fillim të nëntorit 1998.

11 PY. Fshati i Ri dhe Novosela janë i njëjti vend?

12 PË. Po. Në gjuhën shqipe Fshati i ri, kurse në gjuhën serbo-
13 kroate Novoselë.

14 PY. E kuptoj.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Lutem tani Sekretares që ta shohim
16 videon deri tek sekonda e 00:57.

17 [Luhet videoincizimi]

18 "[Zëri] Forcat e armatosura të Kosovës, nën udhëheqjen e
19 Shtabit të Përgjithshëm të saj, gjatë këtij viti u përballë
20 kundër shumë ofensivave të pushtuesit serb. Ajo arriti t'u
21 bëjë ballë me sukses të gjitha këtyre ofensivave. Kështu që
22 sot, Ushtria Çlirimtare e Kosovës është më e përgatitur si në
23 planin kombëtar dhe në atë ndërkombëtar. Në planin kombëtar
24 Ushtria Çlirimtare e Kosovës, përkundër propagandës dhe luftës
25 speciale, që u bë para, gjatë dhe pas ofensivave të pushtuesit

1 serb, të ndihmuar edhe nga elementet autonomist, ajo arriti që
2 vetëm të konsolidohet e profesionalizohet dhe sot ka arritur
3 shkallën më të lartë të organizimit të saj politiko-ushtarak”.

4 Z. HALLING: [Përkthim]

5 PY. Dëshmitar, po ky xhirim është i paraqitjes së parë
6 publike të Hashim Thaçit?

7 PË. Po. Ky është xhirimi i paraqitjes së parë publike të z.
8 Hashim Thaçi si udhëheqës politik i UÇK-së.

9 PY. Në faqen 3380 dhe 381 të librit ju thoni që keni folur me
10 Hashim Thaçin lidhur me përdorimin e një gjuhe më diplomatike
11 krahasimisht me atë çfarë ai tha në këtë pjesë që sapo pamë.
12 Kjo gjuha që përdoret këtu, sipas jush, a duket sikur është
13 gjuhë më diplomatike, Dëshmitar?

14 PË. Po. Gjatë përgatitjes për xhirimin e kësaj paraqitjeje
15 publike është shënuar që meqenëse është paraqitja e parë
16 publike dhe z. Thaçi nuk kishte përvojë në paraqitjen publike,
17 kishte emocione, të cilat janë të natyrshme në situata të
18 tilla të cilat na ndodhin dhe neve gazetarëve me përvojë.
19 Emocionet janë shumë të natyrshme sepse paraqitja publike
20 nënkupton dhe një përgjegjësi publike para publikut.

21 Dhe z. Thaçi u mundua që të dalë publikisht me
22 konstatimet se Ushtria Çlirimtare e Kosovës duhet të gëzojë
23 mbështetjen më të madhe nga i tërë populli edhe nga lidershipi
24 në Prishtinë, sepse në atë periudhë, si dihet, lidershipi
25 politik në Prishtinë, i udhëhequr nga Ibrahim Rugova, kryetari

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 17

1 i Lidhjes Demokratike të Kosovës, nuk ishte në nivel të duhur
2 të përgjegjësisë politike për situatën e cila ekzistonte në
3 atë periudhë në Kosovë.

4 PY. Dëshmitar, ju përgjigjët pyetjes që ju bëra.

5 Faleminderit. Ju keni përdorur pjesë të komenteve të Hashim
6 Thaçit në dokumentarin në fillim të nëntorit të 1998, apo jo,
7 Dëshmitar?

8 PË. Po, një pjesë nga kjo paraqitje publike e z. Thaçi është
9 përfshirë në dokumentarin i cili është transmetuar në nëntor
10 të vitit 1998 me titull "Këtu janë".

11 Z. HALLING: [Përkthim] Për procesverbal, kjo është prova
12 materiale P1261.

13 PY. Kush e mori vendimin se cilat nga komentet do të
14 përfshiheshin në dokumentarin për të cilin po flasim,
15 Dëshmitar?

16 PË. Po unë bashkë në konsultim me Migjen Kelmendin i cili ka
17 qenë udhëheqësi i redaksisë së Kosovës në televizionin
18 shqiptar. Në atë periudhë ka qenë redaksia në Prishtinë ka
19 funksionuar në Prishtinë. Dhe bashkë me Migjen Kelmendin dhe
20 me montazherët Ekran Dobërçani dhe Ergyn Dobërçani, si dhe me
21 Abaz Zekën, kemi qenë një ekip i vogël, i cili është munduar
22 që të informojë opinionin për të gjitha zhvillimet në zonat e
23 luftës.

24 PY. Dëshmitar, kur keni bërë këtë dokumentar a ishit i
25 shqetësuar lidhur me shqetësimet e Hashim Thaçi të bëra në

1 komentet e veta sa i takon luftës speciale dhe elementëve
2 autonom?
3 PË. Po në atë periudhë, si thashë edhe më herët, situata
4 ishte shumë e rëndë në Kosovë, forcat serbe kishën marrë një
5 ofensivë të vazhdueshme mbi popullatën civile, por edhe mbi
6 pozicionet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe lidhshipi
7 politik në Prishtinë nuk ishte në nivel të përgjegjësisë që
8 duhet të kishte në ato rrethana për të ndihmuar Ushtrinë
9 Çlirimtare të Kosovës, për ta apeluar te populli që ta
10 mbështesë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovë dhe kjo ka reflektuar
11 dhe në terren. Ka reflektuar sepse Kosova në të vërtetë ishte
12 në një situatë shumë të rëndë. Popullata civile ishte strehuar
13 nëpër male dhe ishin djegur shumë shtëpi, shumë shkolla, shumë
14 ambulanca, ishin vrarë mijëra, mijëra civilë, ishin dhunuar
15 mijëra, mijëra femra shqiptare, ishin vrarë edhe shumë pleq
16 edhe shumë gra shtatzëna dhe shumë fëmijë.

17 PY. Dëshmitar, nuk ju pyeta për këto pyetje. Kështu që do
18 t'jua bëj dhe një herë pyetjen. Ju lutem më jepni përgjigje.
19 Kur e keni përgatitur këtë dokumentar a ishit i shqetësuar për
20 komentin apo fjalinë që tha Hashim Thaçi në paraqitjen e vet
21 kur fliste për luftën speciale dhe elemente autonomë?

22 PË. Unë në asnjë mënyrë nuk isha shqetësuar, por insistimi im
23 ishte që paraqitja e parë publike të jetë në funksion të
24 unifikimit të faktorit politik dhe ushtarak në Kosovë dhe të
25 krijohet opinioni se Ushtria Çlirimtare e Kosovës duhet të

1 mbështetet më shumë edhe nga lidershipi në Prishtinë i cili
2 nuk ishte, si thashë disa herë, në nivel të përgjegjësisë që
3 kishte.

4 Rugova ishte lider politik dhe kishte shumë autoritet në
5 Prishtinë, por atij i mungonte guximi, i mungonte vendosmëria
6 që publikisht të dalë dhe të ftojë popullin që ta mbështesë
7 fuqishëm Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

8 PY. Dëshmitar, në qoftë se unë ju them se tri fjalitë e para
9 të këtij fjalimi janë në dokument dhe dy fjalitë e tjerë të
10 cilën kanë të bëjnë me luftën speciale dhe elementët autonomë
11 ndërkohë që gjysma e dytë e kësaj fjalisë nuk është e përfshirë
12 në dokumentar, a mund të na thoni që pse posaçërisht kjo
13 gjysma e fjalisë mungon te dokumentari, pse e keni hequr nga
14 dokumentari gjysmën e fjalisë?

15 PË. Po gjatë montazhit normalisht varësisht prej konceptit
16 aty hiqen fjalitë, disa fjali shtohen dikun tjetër, krejt
17 varësisht nga konturiteti, nga narracioni edhe nga aktualiteti
18 dhe argumentet që përdoren në dokumentar.

19 PY. Pra, po thoni që kjo fjalia, domethënë, gjysma e fjalisë
20 që kishte të bënte me luftën speciale dhe me përpjekjet
21 autonome, ju e keni shkurtuar vetëm se nuk ka pasur kohë të
22 mjaftueshme, këtë po thoni, Dëshmitar?

23 PË. Sigurisht edhe ajo është një nga elementët. Sepse ne e
24 kishim hapësirën e kufizuar, nuk mund të zgjatej dokumentari
25 një orë, dy orë.

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 20

1 PY. Thatë që koha ishte një prej elementëve që pse nuk është
2 përfshirë kjo gjysma e fjalisë. Përveç kohës, cilët kanë qenë
3 elementët e tjerë, Dëshmitar?

4 PË. Po ishte edhe elementë të tjerë. Që në opinion të bëhet,
5 në një farë mënyre apel, një lloj ftese që popullata të jetë
6 më afër luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe
7 lidhshipi politik të jetë në nivel të përgjegjësisë sepse
8 vërtetë nuk ishte në nivel të përgjegjësisë, në raport me
9 situatën që ekzistonte në zonat e luftës. Kur ishte lufta për
10 jetë a vdekje.

11 PY. A morët parasysh që përmendja nga Hashim Thaçi i luftës së
12 posaçme ose luftës speciale dhe elementëve autonomë ndoshta
13 nuk do kishte ndonjë kuptim për publikun.

14 PË. Po në ato momente kishte elemente të tilla, por nuk ishte
15 me rëndësi që të fokusohemi në ato aspekte. Me rëndësi ishte
16 që z. Thaçi publikisht të dilte sa më serioz, të dilte me një
17 apel për të unifikuar mbarë popullin rreth Ushtrisë Çlirimtare
18 të Kosovës dhe të fitohej mbështetja dhe nga faktorët
19 ndërkombëtarë.

20 PY. Dëshmitar, nuk iu përgjigjët pyetjes që ju bëra. Ju lutem
21 më thoni me po apo jo dhe pyetja dhe një herë është që a
22 mendonit ju që përmendja nga Hashim Thaçi e luftës speciale
23 dhe elementëve autonomë nuk do të bënte ndonjë apel për
24 publikun, nuk do të kishte ndonjë lidhje të madhe me publikun?

25 PË. Unë e kam vlerësuar që nuk ishte mirë me u përfshi kjo, ky

1 element sepse, si gazetar me përvojë edhe unë e kisha synim që
2 mos të krijohen dilema. Dhe ashtu dilema kishte në Prishtinë.
3 Prishtina jetonte sikur nuk po ndodhë asgjë në zonat e luftës
4 dhe ishte me të vërtet shumë me rëndësi që Ushtria Çlirimtare
5 e Kosovës të gëzonte përkrahje më të madhe nga të gjitha
6 shtresat e popullit nga intelektualët, nga mërgata dhe nga
7 faktorët ndërkombëtarë. Kjo ishte me rëndësi për mua dhe unë
8 këtu jam fokusuar.

9 PY. Dëshmitar, domethënë, nuk ishe arsyeja vetëm thjesht që
10 të shkurtonit këtë gjysëm fjalie për arsye kohe. Por
11 qëllimisht vendosët që këtë gjysëm fjalie të mos e përfshinit
12 fare, Dëshmitar, apo jo?

13 PË. Po nuk është puna për që kam bërë ndonjë censurë. Po unë
14 e kam vlerësuar ashtu se duhet të përfshihet ajo pjesa që
15 është përfshirë.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do ta lëmë
17 këtu këtë temë. Për procesverbal, është prova materiale P303,
18 është faqja 84, është një dokument të cilin besoj që
19 Gjykatësit mund ta kenë parë kohët e fundit, përmendet e
20 njëjta gjuhë ose gjuhë e ngjashme me gjuhën që është përdorur
21 dhe në fund të tetorit 1998.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do i kërkoj Sekretares së
23 seancës që të paraqesë në ekran videon me numër 069758-04 dhe
24 dua që të paraqiten minuta 04:40 deri 20:02. Kjo është e
25 gjithë videoja në fakt. Dhe nga ky segment do kërkoja që të

1 transmetonit nga 09:13 deri në 10:17.

2 PY. Ndërkohë që dokumenti paraqitet në ekran, Dëshmitar,
3 dëshiroj t'ju them që ju keni filmuar dhe keni folur në librin
4 tuaj lidhur me filmimin e Ditës së Flamurit të UÇK-së,
5 domethënë, festimeve që janë bërë për Ditën e Flamurit më datë
6 28 nëntor 1998, a është e vërtet kjo, Dëshmitar?

7 PË. Po. Më 28 nëntor të vitit 1998 në Divjakë është mbajtur
8 manifestimi qendror në atë zonë kushtuar Ditës së Flamurit,
9 Ditës së Pavarësisë së shtetit shqiptar.

10 PY. Faleminderit.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë do i kërkoja Sekretares që
12 kurdo që të jetë gati të mund ta transmetojë segmentin që sapo
13 thashë të videos në fjalë.

14 [Luhet videoincizimi]

15 "[Zëri] Ushtria Çlirimtare e Kosovës luftoi në shumë
16 fronte, secili më egër se tjetri, secili më finok se tjetri.
17 Luftoi kundër një makinerie të tërë ushtarake propagandistike.
18 Përballoi ofensiva ushtarake të papara që pas Luftës së Dytë
19 Botërore në Kosovë. Përballoi një luftë speciale të koordinuar
20 nga jashtë e mbrenda dhe eci pandalshëm përpara. Dhe çuditen
21 miqtë dhe armiqtë me mbijetesën e Ushtrisë Çlirimtare të
22 Kosovës, me gatishmërinë dhe vendosmërinë e saj luftarake.
23 Qëllimi i armiqtë të të gjitha ngjyrave ishte zhdukja e UÇK-
24 së, eliminimi i saj nga jeta politike që pastaj Kosovës t'i
25 imponohet një zgjedhje e parëndësishme mjerake pacifiste apo

1 gandiste.”

2 Dëshmitar, kjo që sapo pamë a ishte një segment i
3 filmimeve që ju keni bërë për festimet e Ditës së Flamurit më
4 datë 28 nëntor 1998?

5 PË. Po.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do i kërkoja Sekretares që të
7 ngrijë në ekran nga kjo video fragmentin që pasqyrohet në
8 minutën 05:36, në mënyrë të tillë që të kemi një vështrim të
9 përgjithshëm të personave që kanë qenë në podium që kanë marrë
10 fjalën.

11 PY. Dëshmitar, me aq sa dini ju, na thoni, ju lutem, se cilat
12 janë personat nga e majta në të djathtë.

13 PË. Fotografia është mjaft e turbullt, por do të përpiqem t'i
14 identifikoj. Nga e majta --

15 PY. Për të qenë i qartë do fillojmë me këtë zotërinë që
16 qëndron në këmbë në majtë në skaj fare, duke filluar nga ky
17 persona ju lutem na thoni cilat janë personat?

18 PË. Ai është Shefqet Bucaj, komandant Mësuesi, Ramë Buja,
19 babai i dëshmorit heroit të Kosovës Nuhi Mazrekut, Zejnullah
20 Mazreku. Pastaj është z. Jakup Krasniqi duke folur. Është një
21 prind i një dëshmori, nuk e di emrin. Pastaj është Fatmir
22 Limaj, është Naim Maloku, është komandant Musë Jashari dhe
23 komandant Tahir Sinani.

24 PY. Faleminderit. Kam një pyetje tjetër plotësuese. Zotëria
25 që është Ramë Buja, besoj që mund të shikoni që ka dhe një

1 persona tjetër pas këtij personi. A e dini kush është ky
2 personi që është pas zotërisë që ju thatë që është Ramë Buja?
3 PË. Shihet që është një civil. Sigurisht edhe ky është prind
4 i ndonjë dëshmori. Nuk e njoh, nuk po mund ta identifikoj.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës kërkojmë që ky
6 fragment i videos 069758-06 të pranohet si provë gjyqësore.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
8 kundërshtim për këtë? Me ç' duket nuk ka kundërshtim. Kështu që
9 dokumenti 069758-04 nga minuta 04:40 deri në minutën 20:20 do
10 të pranohet si provë.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
12 videoja dhe transkriptet përkuese të saj do të marrin numrin e
13 provën materiale P01288. Klasifikimi aktual është
14 konfidencial.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
16 riklasifikohet si publik dokumenti.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Videoja tjetër është 0659758-05.
19 Ky është një fragment që do kërkoja që të transmetohej nga
20 minuta i 19:15 deri në minutën 24:12. Jam më shumë i
21 interesuar nga fragmentin nga minuta 02:22 deri minuta 03:06.
22 PY. Dëshmitar, ndërsa paraqitet kjo video. Dua t'ju pyes në
23 qoftë se gjatë kremtimeve të Ditës së Flamurit, keni filmuar
24 apo jo, Fatmir Limajn në këtë festë ose në këtë ngjarje pas
25 ceremonisë së flamurit?

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 25

1 PË. Po. Atë ditë në mbrëmje, bashkë me luftëtarët e UÇK-së,
2 edhe unë dhe kameramani Abaz Zeka kemi qenë në kremtimin e
3 kësaj feste tonë kombëtare në Fshatin e Ri.

4 PY. Po Fatmir Limaj ka dhënë një lloj fjalimi për të rinjtë,
5 për rininë, kështu sikur e keni përshkruar në libër, apo jo,
6 Dëshmitar?

7 PË. Po. Z. Fatmir Limaj kishte në dorë revistën shkollore
8 "Gjimnazisti" të gjimnazit Xhevdet Doda të Prishtinës dhe në
9 atë revistë ishin botuar disa shkrime të nxënësve të kësaj
10 shkolle edhe për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ku shprehur
11 vullnetin e tyre për ta ndihmuar Ushtrinë Çlirimtare të
12 Kosovës për ta përkrahur në mënyrën e vet. Dhe z. Fatmir Limaj
13 ju drejtohet me një apel nxënësve të kësaj shkolle dhe i
14 falënderon për përkrahjen e tyre të luftës sonë çlirimtare.

15 PY. Faleminderit.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem mund të
17 vazhdoni me videon tani.

18 [Luhet videoincizimi]

19 "[Zëri] Porosia ime është që këta të mos ndalem, të
20 veprojnë, të punojnë me kokë më vete se vetëm atëherë është
21 rini tamam e pastër dhe vetëm ashtu mund të gjejmë rrugën e
22 drejtë, rrugën e lirisë e të patriotizmit. Kërkoj nga ju që të
23 mos imponoheni, të mos bini në intrigat partiake ose të disa
24 pseudoprofesorëve të cilët ju preferojnë rrugë të moderuar, po
25 të veproni me mendje e arsye të shëndoshë dhe të jeni në

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 26

1 funksion dhe në moment kur e kërkon atdheu.”

2 Z. HALLING: [Përkthim]

3 PY. Dëshmitar, a është filmimi që ju keni përshkruar lidhur
4 me Fatmir Limaj dhe ky fragmenti kur ai ka enë bashkë me këtë
5 revistën në duart e tij?

6 PË. Po, ky është.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do kërkojmë
8 që të paraqitet si provë materiale segmenti përkatës. Dhe një
9 herë për procesverbal, është dokumenti 069758 deri në 05 dhe
10 nga minuta 19:24 deri në minutën 24:12.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
12 kundërshtim? Meqenëse nuk ka kundërshtim, dokumenti me numër
13 069758-05 nga minuta e 19:15 deri në minutën 24:12 pranohet si
14 provë.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
16 videoja që sapo u përmend, së bashku me transkriptet përkuese,
17 do të marri numrin e provës materiale P01289 dhe aktualisht
18 është e klasifikuar si konfidenciale.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
20 riklasifikoheni si publike.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Tani i kërkoja Sekretares të
22 paraqesë në ekran dokumentin 108459-01 dhe të shkoni tek
23 minuta 12:43.

24 PY. Dëshmitar, përpara sesa të shohim këtë dokument, më
25 lejoni t'ju them që në faqen 405 të librit tuaj, ju flisni për

1 filmimin në zonën e Llapit më datë 27, 28 dhjetor 1998,
2 gjithashtu edhe për filmimin e festës së Vitit të Ri me UÇK-
3 në, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

4 PË. Po, e saktë është.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë do i kërkoja Sekretares që
6 të transmetohet videoja nga minuta 12:43 deri në minutën
7 12:57, ndërkohë që transkript është në faqen 4.

8 [Luhet videoincizimi]

9 Z. HALLING: [Përkthim]

10 PY. Dëshmitar, nuk jam i sigurt në qoftë se e dëgjuat audion
11 apo jo, megjithatë për ta bërë të qartë për procesverbal.
12 Thuhet që:

13 "Kur ka dalë në terren UÇK-ja, zona operative e Llapit ka
14 pasur mundësi që të krijojë një ushtri profesionale."

15 Kush është ky personi që është në ekran, Dëshmitar?

16 PË. Zëri nuk u dëgjua në gjuhën shqipe. Teknika juaj po
17 dështon.

18 Por dua të konfirmoj se ky është eprori ushtarak Kadri
19 Kastrati, me pseudonimin Daja. Ky ka qenë epror ushtarak në
20 zonën operative të Llapit.

21 PY. A është kjo pjesë e filmimit që keni bërë juve në zonën e
22 Llapit më datë 28, 29 dhjetor 1998, Dëshmitar?

23 PË. Po. Më 28, 27 dhe 28 dhjetor të vitit 1998 kam qenë në
24 këtë zonë për të xhiruar për një emision special që u
25 transmetua në televizionin shqiptar.

1 PY. Nëse do shikojmë këtë dokument me të njëjtën ERN, pra, në
2 qoftë se do kalojmë përpara në video, në faqen 1 të
3 transkriptit në anglisht dhe ndërkohë në video është minuta
4 02:33. Do kërkoja që të transmetohet kjo pjesë, pra, nga
5 minuta 02:33 deri në minutën 03:05.

6 [Luhet videoincizimi]

7 DËSHMITARI: Nuk ka zë. Ju lutem, nuk ka zë.

8 Z. HALLING: [Përkthim]

9 PY. Po. Dëshmitar, vumë re të njëjtën gjë. Ndërkohë videoja
10 në sistemin tonë ka zë, pra, ka audio. Megjithatë për t'u
11 siguruar se çfarë thuhej në video, po ua them unë, po bëj një
12 përmbledhje, thuhet:

13 "Fatmir Limaj: Përshëndetje të gjithëve, ushtarë dhe
14 eprorë."

15 Dhe më tej Fatmir Limaj thotë që:

16 "Në natën e fundit të vitit që po lëmë pas në emër të
17 Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ju
18 uroj gëzuar Vitin e Ri."

19 Dëshmitar, a është ky filmimi që keni bërë me rastin e
20 fundit të vitit në vitin 1998, Dëshmitar?

21 PË. Po. Ky xhirim është bërë më 31 dhjetor të vitit 1998 në
22 zonën që komandohej nga Fatmir Limaj.

23 PY. Po komenti që sapo ju lexova dhe ky personi që patë në
24 ekran besoj që ishte Fatmir Limaj dhe këto ishin komente të
25 bëra nga Fatmir Limaj, apo jo?

1 PË. Po. Po, ishin komentet e z. Fatmir Limaj natën e Vitit të
2 Ri ku i thoshte ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që
3 për vitin e ardhshëm do ta kremtojmë në liri. Dhe ashtu
4 ndodhi.

5 PY. Faleminderit.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do kërkoj që të paraqitet një
7 tjetër video me një tjetër ERN dhe shpresoj që të kemi pak më
8 tepër fat me audion. Është dokumenti 108460-01, është një
9 fragment i kësaj videoje që do kërkoja që të transmetohet nga
10 sekonda 00:51 deri tek minuta 3:00 dhe këto janë në faqen 2,
11 domethënë, teksti jepet në faqen 2 dhe 3 të transkriptit në
12 anglisht.

13 Në rregull, ju lutem transmetojeni tani.

14 [Luhet videoincizimi]

15 "[Zëri] A po respektohet vendimi i Shtabit të
16 Përgjithshëm gjatë kësaj feste.

17 "A ka thyerje të rregullave?

18 "Natyrisht që për çdo situatë Shtabi i Përgjithshëm
19 nxjerr vendime konkrete. Edhe për natën e Vitit të Ri, Shtabi
20 i Përgjithshëm dha një urdhër që të mos shtihet me armë
21 zjarri. Ky urdhër po respektohet me përpikëri dhe nuk kemi
22 shënuar asnjë rast të thyerjes së kësaj rregulle.

23 "Po përcjellim një vit ku Ushtria Çlirimtare e Kosovës
24 është zhvilluar dhe ka arritur që të jetë me njëmend një forcë
25 reale ushtarake dhe politike në betejat për çlirimin e

1 definitiv të Kosovës.

2 "A mund të na thoni shkurtimisht për rezultatet që ka
3 arritë kjo ushtri gjatë këtij viti?

4 "Gjatë vitit 1998, kaluam një vit me plot sakrifica për
5 popullin e Kosovës me plot --

6 "Në mesin e ushtarëve të batalionit Sadik Shala takuam
7 edhe dy anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë
8 Çlirimtare të Kosovës, zotërinjtë Rexhep Selimin i cili
9 njëherësh është edhe inspektor gjeneral i shtabit dhe z.
10 Fatmir Limajn. Z. Rexhep, na thoni se çfarë është gatishmëria
11 e forcave të Ushtri Çlirimtare të Kosovës gjatë kësaj feste?

12 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe Shtabi i Përgjithshëm i
13 saj janë çdo herë në nivel të detyrave ushtarake, janë çdoherë
14 në nivel të detyrave ndaj atdheut. Kështu dhe sonte në
15 ndërrimin e moteve, ushtarët e UÇK-së janë në pozicione, janë
16 në detyra, po i zbatojnë me përpikëri të gjitha urdhrat e
17 Shtabit të Përgjithshëm dhe komandave tjera në hierarki.
18 Kështu që mund të themi dhe të themi me plot gojën që UÇK-ja
19 edhe sonte është në nivel ashtu siç ka qenë edhe më parë."

20 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

21 PY. Dëshmitar, a është intervista që keni bërë ju me Rexhep
22 Selimin më 31 dhjetor 1998?

23 PË. Po, më 31 dhjetor kam realizuar edhe një intervistë me z.
24 Rexhep Selimi për festën e Vitit të Ri për mobilizimin e
25 luftëtarëve të UÇK-së për të pritur Vitin e Ri dhe për të

1 analizuar një vit të suksesshëm në frontet e luftës.

2 PY. Në çfarë vendi është bërë filmimi, Dëshmitar?

3 PË. Është bërë në rajonin ku ka vepruar Brigada 121 e

4 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ismet Jashari, Kumanova, aty

5 dikund afër fshatit Javor dhe Luzhnicës, në mes të Javorit dhe

6 Luzhnicës dikund.

7 PY. Faleminderit.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani kërkojmë

9 që të pranohen dy videot e fundit që u treguan si prova

10 gjyqësore. Më konkretisht janë videot 108459-01 dhe 108460-01.

11 Për videon e fundit, kërkojmë që të pranohet segmenti nga

12 minuta 04:10 në minutën 09:47.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka

14 kundërshtime? Meqenëse nuk ka kundërshtime. Atëherë dokumenti

15 108459-01 pranohet.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

17 videoja, së bashku me transkriptet përkatëse, do të marrë

18 numrin e provës gjyqësore P01290. Aktualisht është e

19 klasifikuar si konfidenciale.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do

21 riklasifikohet si publike.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe do

24 pranohet gjithashtu edhe videoja 0108460-01 nga minuta 04:10

25 në minutën 09:47.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
2 videoja, së bashku me transkriptet përkuese, do të marrë
3 numrin e provës materiale P012691 dhe si në rastin e mëparshëm
4 klasifikimi është konfidencial në sistemin e *Legal Workflow*.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe do
6 riklasifikohet kjo si publike.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

8 Z. HALLING: [Përkthim]
9 PY. Dëshmitar, besoj se e dëgjuat përkthyesen që tha që ju
10 lutem flisni pak më pranë mikrofonit për t'ju dëgjuar më mirë.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duke pasur
12 parasysh kohën dhe nuk e di në qoftë se do bëjmë pushim, apo
13 jo? Megjithatë dua të them që na duhet dhe ca kohë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po do bëjmë
15 një pushim prej dhjetë minutash.

16 Dëshmitar, do bëjmë pushim prej dhjetë minutash. Do dilni
17 nga salla e gjyqit së bashku me Asistenten. Dhe do kthehemi
18 përsëri në orën 10.10 në sallë.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
21 pushim deri në orën 10.10.

22 --- Seanca ndërpritet në orën 10.01

23 --- Seanca rifillon në orën 10.11

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
25 sillni sërish dëshmitarin në sallë.

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 33

1 Z. HALLING: [Përkthim] Ndërkohë që presim dëshmitarin, ju
2 lutem vendosni në ekran videon e radhës me numër 108460-02, do
3 shohim tre pjesë të ndryshme të kësaj videoje. Fillimisht do
4 shohim që nga fillimi deri në minutën 04:31 dhe do të ndalojmë
5 tek sekonda 00:10 e pjesës së parë të xhirimit.

6 [Dëshmitari vijon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
8 Dëshmitar, do të vijojmë me pyetjet nga ana e Prokurorisë.

9 Vazhdoni, z. Halling.

10 Z. HALLING: [Përkthim]

11 PY. Do shohim një video tjetër që është në ekran aktualisht.
12 E njihni këtë xhirim?

13 PË. Po, është z. Fatmir Limaj.

14 PY. Çfarë lexon ajo emblema që ka ai?

15 PË. Është emblema e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

16 PY. Është e Shtabit të Përgjithshëm?

17 PË. Nuk po lexohet qartë, po si duket ashtu duhet të jetë.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem të shkojmë që në fillim
19 të xhirimit.

20 PY. A është me e lexueshme tani?

21 PË. Po.

22 PY. Çfarë thotë?

23 PË. Ushtria Çlirimtare e Kosovës Shtabi i Përgjithshëm.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Tani ta shohim nga sekonda e 00:39
25 deri në minutën 01:08, ju lutem.

1 [Luhet videoincizimi]

2 "[Zëri] Prandaj dolëm që në emër të Shtabit të
3 Përgjithshëm edhe të emërtimit personal si ish-komandant i
4 kësaj brigadës të uroj Vitin e Ri. Urojmë që vitin tjetër të
5 jemi edhe më të përkushtum, më të disiplinum dhe të përgatitum
6 për sfidat e kohës që do të na vijnë. Urojmë që vitin tjetër
7 armiku ta presim sa më të forcuar, më të disiplinuar duke
8 respektuat të gjitha urdhërat dhe detyrat që na jep Shtabi i
9 Përgjithshëm."

10 Z. HALLING: [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, kush është personi që po flet këtu?

12 PË. Po, z. Fatmir Limaj fliste.

13 PY. Ku dhe kur është xhiruar kjo video?

14 PË. Është Xhiruar në fshatin Tërpezë të komunës së

15 Malishevës më 31 dhjetor 1998.

16 PY. Pra, është xhiruar edhe kjo natën e Vitit të Ri të vitit
17 1998.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Të shohim tani pjesën e dytë të
19 kësaj videoje, ka numrin 108460-02 deri në 33 dhe të shohim
20 xhirimin nga fillimi deri në sekondën e 00:49.

21 [Luhet videoincizimi]

22 "[Zëri] Sikur çdokush edhe ne e bëmë analizën vjeçare
23 sesi e kemi kalu dhe si e kemi përjetu, mesa humbje e sa
24 fitore po bëjmë. Gjatë këtij viti ne po përgatitni për luftën
25 dhe betejat e ardhshme. Duhet me punu se, natyrisht, është

1 fillimi i luftës ky. Unë tash kam dhe vetë përvojë detyrë të
2 re të njeriut i cili ka analizue para [E pakuptueshme] sesa
3 shqiptarë janë vra, sa shqiptarë prehen, sa shqiptarë të
4 maltratum, sa motra u dhununë, sa shqiptarë lëshun atdheun.
5 Kjo a kanë përpara analiza. E asgjë për fitoret tona. Se s'ka
6 pas kurrgjë. Kjo a, domethënë, vetë mbas kohës së Skënderbeut,
7 viti i parë që ne bajmë analizat jo vetëm për humbjet që jemi
8 mësu me i bë, por bëjmë edhe për fitoret, për dëmet.”

9 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk jam i sigurt nëse i përkonin
10 titrat shqipes, megjithatë mund të ndiqnim diçka nga titrat.

11 PY. Dëshmitar, kush ishte personi që fliste në videon që sapo
12 pamë?

13 PË. Po ishte z. Fatmir Limaj, në familjen e heroit të Kosovës
14 Nuhi Mazrekut ku flet për gjendjen në atë kohë, për betejat,
15 për rënien e dëshmorëve, për sakrificën e popullit tonë,
16 rrugëtimin e tij për liri.

17 PY. Kur edhe ku është xhiruar?

18 PË. Është xhiruar në fshatin Gurisht të komunës së Malishevës
19 natën e Vitit të Ri.

20 PY. Këtu janë tre persona me uniformë që i shohim këtu, në
21 sekondën 00:49. A mund të na thoni nga e majta në të djathtë
22 cilët janë këta persona?

23 PË. Po është Haxhi Shala, Rexhep Selimi dhe Fatmir Limaj.

24 PY. Faleminderit.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do të çoja të shihni pjesën e

1 fundit të kësaj ERN dhe doja të shihnim më konkretisht nga
2 minuta 52:15 deri në minutën 56:17 dhe të ndalojmë tek minuta
3 02:36.

4 PY. Dëshmitar, a keni xhiruar dhe një fjalim të Ajet
5 Kastratit në mbrëmjen e Vitit të Ri?

6 PË. Po. e kemi xhiruar dhe fjalimin e eprorit ushtarak Ajet
7 Kastrati. Ky xhirim është bërë në fshatin Javor më 31 dhjetor
8 1998.

9 PY. Në atë kohë Ajet Kastrati ka qenë komandant batalioni?

10 PË. Nuk e di saktë çka ka qenë, po ka qenë një nga
11 komandantët e UÇK-së

12 PY. Tani në ekran në minutën 02:36, cilët janë personat që
13 shohim këtu nga e majta në të djathtë?

14 PË. Nga e majta në të djathtë është Ajet Kastrati, pastaj
15 është Fatmir Limaj.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem ta shohim deri tek minuta
17 03:18.

18 [Luhet videoincizimi]

19 "[Zëri] ... kur është zbatuar komanda nga vertikale, pra,
20 është zbatuar hierarkia ushtarake. Duke e falënderuar dhe
21 komandën e brigadës e cila me komandantët e batalioneve çdo dy
22 herë në javë bën analizën e punës, ku aty tregohen të mirat
23 dhe dobësitë dhe prej asaj mbledhjeje dalim gjithmonë me
24 propozime që të eliminohen dobësitë, të cilat janë paraqitë
25 gjatë asaj periudhe. Pra, në fund edhe njëherë zotohem se do

1 t'i kryejmë të gjitha urdhrat që vijnë prej Shtabit të
2 Përgjithshëm, komandës së brigadës e më tutje”.

3 Z. HALLING: [Përkthim]

4 PY. Dëshmitar, a është ky fjalimi i Ajet Kastratit që sapo
5 diskutuam në dëshminë tuaj?

6 PË. Po, ky është fjalimi i Ajet Kastratit, i cili si çdo
7 epror në ato rrethana në analizën e vitit që e linin pas,
8 fliste në mënyrë afirmative për Ushtrinë Çlirimtare të
9 Kosovës. Thoshte se ka hierarki, po në të vërtetë hierarki nuk
10 kishte, as ai vetë s’e ka dit sigurisht se ka, por fliste para
11 ushtarëve se ka hierarki e kështu

12 PY. Dëshmitar, dje thatë që nuk e njihnit hierarkinë e UÇK-
13 së. Po tani mbi ç’baza thoni që nuk ka pasur?

14 PË. Po edhe dje edhe sot them se nuk e kam njohur. Se
15 përmenda shumë shembuj konkret dje se nuk kishte hierarki të
16 mirëfilltë si duhet të ketë një ushtri e rregullt. Kjo ishte
17 ushtri vullnetare dhe askush askënd s’mund ta detyronte me
18 dhunë kur e bënte një veprim. Z. Thaçi ishte përgjegjës për
19 informim por fjala e tij nuk respektohej nga disa komandantë
20 lokal të fshatrave. Kam përmend rastin konkret edhe në libër
21 edhe në dëshminë time dje që e thashë para jush edhe para
22 Trupit Gjykues edhe para opinionit. Kjo është dëshmia ime
23 konkrete.

24 PY. Faleminderit.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të doja që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 38

1 të pranoheshin këto tri pjesë të videos. Të tria pjesët janë
2 pjesë e videos më të gjerë me numër 108460-02. Por ne i
3 paraqitëm dëshmitarit vetëm tre pjesë, që ishin nga sekonda
4 00:00 deri në minutën 04:31 dhe më pas pamë edhe minutën
5 52:15, 56:17.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
7 kundërshtime?

8 PËRKTHYESI: Ekipet e Mbrojtjes jo.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
10 Materiali me numër 108460-02 dhe tre pjesët përkatëse
11 pranohen. Mund t'i ndajmë Pjesa 1, Pjesa 2, Pjesa 3 - më falni,
12 doja thoja .1, .2, .3.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Po, do të ishte me mend.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Materiali i parë me
15 numrin A005 deri në 04:31 merr numrin e provës materiale
16 P10292.1. I dyti merr numrin, pra, që fillon në minutën 33
17 merr numrin e provës P1092.2. Dhe materiali i tretë nga minuta
18 00 -- më falni, 52:15 deri në 56 -- më falni.

19 Z. HALLING: [Përkthim] 56:17.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] 56:17 merr numrin e
21 provës materiale P1092.3, bashkë me transkriptet përkuese. Dhe
22 klasifikimi i tyre aktual është konfidencial.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

24 Riklasifikohet si material publik.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

1 Tani do lutesha të vendosej në ekran materiali U015-8743,
2 U015-8935, më konkretisht faqja U0158885 në anglisht dhe në
3 shqip.

4 PY. Dëshmitar, ndërkohë që presim materialin, në librin tuaj
5 keni shkruajtur për krijimin KosovaPress në radion Iliria kjo
6 është në librin tuaj. A ju kujtohet ta keni diskutuar këtë gjë
7 në librin tuaj?

8 PË. Po, në librin tim kam shkruar edhe për themelimin e dy
9 institucioneve të lira informative të pavarura si ka qenë
10 agjencia e lajmeve KosovaPress dhe radio Kosova e Lirë.

11 PY. Do t'ju tregoj një faqe të Jakup Krasniqi "Kthesa e
12 Madhe" që ta kemi treguar dhe gjatë seancës përgatitore.
13 Presim të dalë dhe anglishtja.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Dëshiroj të them që sapo më thanë
15 që do të bëjmë një verifikim përkthimi në faqen 32, rreshti
16 24.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
18 Do ta bëjmë.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Për Sekretaren desha të thoja që
20 është 8885. Më duket se është faqja 143 në versionin PDU. Në
21 rregull. Faleminderit

22 PY. Dëshmitar, këtë e keni parë edhe gjatë seancës
23 përgatitore. Do t'ju lexoj disa pjesë. Krasniqi shkruan:

24 "Ndonjëherë kishte dhe mbështetje nga disa programe nga
25 Nuhi Bytyqi dhe komandant Abazi dhe televizioni shqiptar me

1 kamerat e veta. Nuhi Bytyqi dhe komandant Abazi me kamerën e
2 tij nga TVSH-ja”.

3 Më pas ai thotë sesi:

4 “ ... ofensiva armike e verës 1998 na detyroi që të
5 hulumtonim mundësinë e krijimit të një agjencie të lajmeve të
6 një radio-televizionit të një gazete. Kështu në mbledhjen e
7 përmendur caktuam përgjegjësit e këtyre mjeteve. Përgjegjës
8 kryesor do të ishin Berat Luzha dhe Ahmet Qeriqi ...”

9 Dhe po ashtu thotë në fund:

10 “... dy institucionet e fillua punën më 4 janar 1999 në
11 Malet e Berishës”.

12 Dëshmitar, ajo që ka shkruar Jakup Krasniqi në këtë faqe
13 është e korrekte, është e drejtë, domethënë, për themelimin e
14 shtypit të Kosovës - më falni - KosovaPress dhe Kosova e Lirë,
15 radio Kosova e Lirë, a është e saktë kjo që ka thënë z. Jakup
16 Krasniqi?

17 PË. Po, është e saktë sigurisht.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Do të kërkonim që të pranohet edhe
19 kjo faqe. Është pjesë e një seksioni me tre faqe të këtij
20 libri që është pranuar më herët, vetëm këto tre faqe na
21 nevojiten ne dhe mund të bashkëngjitet në numrin e prova
22 materiale të librit të z. Krasniqi.

23 Ne e dimë që ky libër ka ERN të ndryshme, nuk e dimë a
24 është e mundur që t'i bashkojmë të gjitha faqet e këtij libri
25 në një numër të vetëm të provës materiale.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
2 kundërshtime?

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Po besoj se thatë një faqe,
4 nuk thatë tre.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Jo. Ju thashë është kjo faqe është
6 pjesë e tre faqeve që na nevojiten ne aktualisht nga ky libri
7 dhe do të doja që në këtë kuadër të pranoni tre.

8 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Po vetëm një faqe u tregua
9 dëshmitarit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyete dhe për
11 dy faqet e tjera nëse i njeh.

12 Z. HALLING: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, në rregull, do shohim dhe faqet pararendëse,
14 Jakup Krasniqi ka filluar kreun e nëntë për "Institucionet
15 Informative" dhe këtu flet për mbështetjen që ka marrë nga
16 shtypi gjatë luftës dhe në fund flet që:

17 "Është mbuluar nga shtypi lufta e UÇK-së ..."

18 Dhe:

19 "Ka qenë një mbështetje të madhe në krahë të fortë të
20 luftës sonë, kemi pasur nga shtëpi televizive që janë
21 superfuqi mediale botërore si CCN-ja dhe BBC-ja".

22 Dëshmitar, kjo përputhet edhe me atë që thatë ju sa i
23 takon mbulimit të luftës, apo jo?

24 PË. Po. Këto institucione informative kanë bërë përpjekje ta
25 informojnë opinionin për zhvillimet në zonat e luftës por edhe

1 më gjerë edhe për ata që jetonin në Prishtinë edhe në qytete
2 të tjera ku nuk kishte luftë frontale. Radio Kosova e Lirë dhe
3 KosovaPress kanë luajtur rol të rëndësishëm në informimin e
4 opinionit të këto zona në atë periudha sepse Kosova, si kam
5 thënë dje në dëshminë time, ishte në terr informativ. Nuk
6 kishte asnjë institucion në gjuhën shqipe, nuk kishte as
7 radio, as televizion, as gazetë ditore. Kështu që këto dy
8 institucione kanë luajtuar rolin e informimit bashkë me
9 televizionin shqiptar dhe me televizionet më të fuqishme të
10 botës CCN-i, BBC dhe media të tjera botërore.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës dhe faqja që
12 treguam e plotëson këtë pjesë besojmë. Ju thamë që këto janë
13 tre faqe që na nevojiten për kontekstin.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
15 Do t'i pranojmë të tria faqet. Do t'i pranojmë për momentin,
16 do t'i pranojmë.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Këto tri faqe i
18 bashkëngjiten provës materiale P00189.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

20 Tani i lutem Sekretares të vendosë në ekran materialin
21 101928-01. Është një video tjetër. Do të mbulojmë pjesën nga
22 minuta 36:19 deri në 38:48. Dhe tani nga ky minutazh ne do të
23 shohim minutën 01:10 dhe pastaj 01:41.

24 PY. Dëshmitar, në librin tuaj në faqet 472, 473 flisni për
25 faktin që keni ndihmuar për një program apostafat apo të

1 posaçëm që është transmetuar më 4 dhe 5 qershor 1999. A ju
2 kujtohet kjo?

3 PË. Po, në atë periudhën kam qenë në Tiranë, në televizionin
4 shqiptar. Dhe më është sjellë një kasetë nga zonat e luftës
5 për gjendjen në zonat e luftës për radion Kosova e Lirë dhe
6 agjencinë KosovaPress.

7 PY. Po.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do shohim nga minuta 01:10,
9 pastaj 01:41.

10 PY. Tani që po presim që të transmetojmë videon, kush janë
11 këta personat nga e majta në të djathtë.

12 PË. Po, nga e majta është Berat Luzha, ka qenë përgjegjës i
13 agjencisë së lajmeve KosovaPress dhe z. Hashim Thaçi.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem, të shohim videon.

15 [Luhet videoincizimi]

16 "[Zëri] Të kërkohet një [E pakuptueshme] sistemet kanë
17 dëshmuar punën tonë dhe të na respektohet tash në qarqet
18 evropiane dhe botërore për informacione që ne i japim. Hajt
19 ditën e mirë. Ditën e mirë. [E pakuptueshme] Mirupafshim"

20 PY. Dëshmitar, kjo që sapo pamë a është një pjesë e xhirimit
21 që është përdorur për atë programin e 4, 5 qershorit 1999?

22 PË. Po, është kjo vetëm një pjesë e atij misioni special që
23 është transmetuar me 4 dhe më 5 qershor 1999.

24 PY. A është kjo vizita e udhëheqësve dhe një ekipi nga
25 KosovaPress, agjencia e mediave KosovaPress të cilin e

1 drejtonte Berat Luzha të cilën ju keni përshkruar dhe në
2 librin tuaj?

3 PË. Po.

4 PY. E kuptoj që këtë s'e keni xhiruar ju, po e keni idenë me
5 për afërsi kur është xhiruar kjo?

6 PË. Nuk e di. Se mund të ketë qenë maj 1999. Në maj me
7 siguri. Se derisa kaseta ka ardhë në Tiranë mes rrugëve
8 tokësore përmes kufirit i cili ka qenë i barrikaduar me
9 ushtrinë dhe policinë serbe është dashtë një kohë më e gjatë
10 për të mbërrir kaseta në Tiranë përmes vijave të furnizimit që
11 atëherë përdorte Ushtria Çlirimtare e Kosovës për armatime dhe
12 nevoja tjera.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që
14 kjo pjesë dhe transkriptet përkuese, të pranohen në prova
15 materiale. Për procesverbal bëhet fjalë për dokumentin 01928-
16 01 dhe do kërkonim vetëm pjesën që përkon me minutën 36:19
17 deri në minutën 38:48.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
19 kundërshtime?

20 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes, nuk kemi kundërshtime.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
22 019128-01 pjesa nga 36:19 deri në 38:48 pranohet.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
24 videoja dhe transkriptet përkatëse, do të marrin numrin e
25 provës gjyqësore P01293. Aktualisht dokumenti është i

1 klasifikuar si konfidencial.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do
3 riklasifikohet si publik.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të
6 paraqesë në ekran faqe 519 të librit të dëshmitarit. Është
7 prova materiale P1264 ose faqja SPOE00128889.
8 PY. Ndërkohë që paraqitet kjo faqe e librit tuaj Dëshmitar, a
9 mund të na thoni a keni qenë duke xhiruar në Lladrovc në vitin
10 1999, më konkretisht data 13 mars?

11 PË. Po.

12 PY. Poshtë në të djathtë në fund të faqes, sikurse mund ta
13 shihni, jepet një fotografi ku jeni ju edhe një person tjetër.
14 A mund të na thoni kush është ky personi tjetër me ju në
15 fotografi, Dëshmitar?

16 PË. Në cillën fotografi? Ka shumë fotografi këtu.

17 PY. Në fotografinë në mes të faqes në të djathtë.

18 PË. Për këtë fotografi.

19 PY. Në shënimin që është në anglisht thuhet:

20 "Me njërin prej organizatorëve të rezistencës së
21 armatosur kundër Serbisë Kadri Veselin, Lladrovc, 13 mars
22 1999".

23 A është ky përshkrimi i saktë?

24 PË. Po, është përshkrim i saktë. Unë jam në fotografi me z.
25 Kadri Veseli, e cila është realizuar me 13 mars të vitit 1999

1 në fshatin Lladrovc të Malishevës.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do i kërkoja Sekretares të
3 paraqesë në ekran dokument 079613 dhe transkripti është në
4 faqen 1 dhe kërkoj që të transmetohet nga sekonda 00:30 deri
5 në minutën 01:11.

6 PY. Në të njëjtin vend dhe të njëjtën datë a keni
7 intervistuar gjithashtu edhe Hashim Thaçin, Dëshmitar?

8 PË. Po, më 13 mars. Kur delegacioni i Ushtrisë Çlirimtare të
9 Kosovës është nisur për në Paris, unë e kam realizuar një
10 intervistë të veçantë me udhëheqjen e delegacionit të Kosovës
11 në konferencën ndërkombëtare për Kosovën e cila kishte filluar
12 më 6 shkurt të vitit 1999 në Rambuje dhe kishte përfunduar më
13 23 shkurt dhe vazhdimi i saj ishte caktuar më 13 mars të vitit
14 1999 në Paris. Këtu në Lladrovc e kam realizuar këtë
15 intervistë për qëndrimet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për
16 atë marrëveshjen që ishte propozuar të nënshkruhej në Rambuje,
17 por që u nënshkrua në Paris më 18 mars të vitit 1999.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë do i kërkoja Sekretares që
19 të transmetojë fragmentin e cituar më sipër.

20 [Luhet videoincizimi]

21 "[Zëri] Pas konsultimeve që Shtabi i Përgjithshëm i
22 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe tërë struktura organizative
23 e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që bëri me masat popullore,
24 Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe struktura e saj organizative
25 zbriti në nivele më të ulëta për të biseduar për t'u

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 47

1 konsultuar dhe për të arritur në vendimin me të drejtë të
2 cilin do ta themi në Paris. Qëndrimi i Shtabit të Përgjithshëm
3 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës do të jetë qëndrim i
4 opinioneve të realizuara në Kosovë.”

5 Z. HALLING: [Përkthim]

6 PY. A është intervista që keni realizuar ju me Hashim Thaçi
7 në Lladrovë më 13 mars 1999, Dëshmitar?

8 PË. Po, kjo është intervista që kam realizuar me z. Thaçi dhe
9 z. Thaçi flet këtu për konsultimet që janë bërë në të gjitha
10 nivelet në Kosovë lidhur me tekstin definitiv të marrëveshjes
11 ndërkombëtare që ishte propozuar nga ndërmjetësuesit
12 ndërkombëtarë për arritjen e një marrëveshjeje paqësore rreth
13 të ardhmes të Kosovës në Paris të Francës që është nënshkruar
14 më 18 mars nga z. Thaçi dhe anëtarë tjerë të delegacionit të
15 Kosovës.

16 PY. Faleminderit.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që
18 kjo video të pranohet si provë. Është dokument 069758-07.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
20 069758-07 e keni fjalën vetëm për videon, vetëm për këtë
21 video?

22 Z. HALLING: [Përkthim] ERN e videos.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Domethënë, të
24 gjithë videon?

25 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni

2 kundërshtime?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 [Përkthim] Dokumenti 0697585-07 Pranohet.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
7 videoja dhe transkriptet përkatëse, do të marrin numrin e
8 provës P01294. Aktualisht është i klasifikuar si konfidenciale
9 në *Legal Workflow*.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta
11 riklasifikoni si publike.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

13 Z. HALLING: [Përkthim]

14 PY. Kam edhe disa pyetje tjera.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Tani nëse mundemi dëshirojmë që të
16 shohim dokumentin 069186-049186. Kemi marrë një fragment të
17 kësaj videoje nga minuta 05:33 deri në minuta 07:40. Le të
18 fillojmë me sekondën e 11, do lutesha që në sekondën e 11 të
19 ngrihet pamja në ekran. Janë faqet 3 deri në 4 të transkriptit
20 në anglisht.

21 PY. Dëshmitar, ndërkohë që bëhet gati videoja dhe
22 transkripti, atëherë sa për fillim më lejoni të them që ky nuk
23 është regjistrim nuk është filmim që është bërë prej jush, apo
24 jo, Dëshmitar?

25 PË. Jo. Kjo video nuk është bërë nga ekipi im. Por sigurisht

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 49

1 nga një ekip i huaj që ka qenë atëherë me rastin e çlirimit të
2 Kosovës në qershor të vitit 1999.

3 PY. Ku është bërë filmimi në çfarë vendi?

4 PË. Këtë e kam parë edhe në YouTube. Kjo është në Malishevë
5 më 16 qershor të vitit 1999, kur është çliruar edhe Malisheva.

6 PY. Nga e majta në të djathtë kë mund të identifikoni në këtë
7 fotografi që keni të ngrirë përpara?

8 PË. Po nga e majta është i pari është Avdi Rraci, pastaj
9 është Haxhi Shala, pastaj është Rexhep Selimi dhe pse është me
10 shpinë po duket që është Rexhep Selimi dhe Sabit Shala, vëllau
11 i dëshmorit Sadik Shala.

12 PY. Kush është Avdi Rraci?

13 PË. Po ishte një luftëtar i UÇK-së, një luftëtar shumë i mirë
14 i UÇK-së.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do i lutesha Sekretares që të
16 transmetojë nga fillimi fare i kësaj videoje 00:00 deri në
17 sekondën e 00.57 të saj.

18 [Luhet videoincizimi]

19 "[Zëri] [E pakuptueshme] Po shihni çfarë ka bërë ushtria
20 dhe policia serbe? Ka djegur të gjitha ndërtesat që kanë
21 ekzistuar në Malishevë -- ku është? Ku është ky vend? Ky vend?
22 Ky vend është Malisheva. Dhe në këtë komunë ka vrarë shumë
23 civilë, në mesin e tyre edhe xhaxhain tim dhe gjashtë civilë
24 tjerë të fshatit tim. Po ashtu në fshatrat tjera ku kam
25 qëndruar në Drenicë, është vrarë edhe Shaban, Nezir Shabani. I

1 riu ku kam qëndruar në familjen e tij bashkë, me 100 civilë të
2 tjerë në fshatin Rezar të Skënderajt dhe në shumë e shumë
3 fshatra të tjera të Kosovës.”

4 DËSHMITARI: Ky është një moment në Malishevë kur është
5 çliruar Malisheva ku luftëtarët e UÇK-së kremtojnë çlirimin e
6 Malishevës.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Dëshmitari po fliste ndërkohë që
8 po jepnin, domethënë, kur kishte tek pjesa audio e videos,
9 megjithatë besoj që ishte e mjaftueshëm ajo çfarë dëgjuam.

10 Të nderuar Gjykatës, dëshirojmë që të kërkojmë pranimin
11 në provë të videos nga minuta 05:33 deri në minutën 07:40.
12 Sikurse e tha dhe dëshmitari, videoja është e disponueshme në
13 internet në burim të hapur. Është një fragment i cili është
14 filmuar nga Paul Refsdal. Neve dëshirojmë që të kërkojmë
15 pranimin e saj si provë dhe, sikurse thamë edhe gjatë
16 diskutimeve dje, nuk është se do kërkojmë segmente të tjera të
17 librit të z. Refsdal por thjesht tani për momentin kërkojmë që
18 të regjistrohet ky fragment i videos si provë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
20 kundërshti për pranimin e këtij segmenti të videos si provë?

21 Z. TULLY: [Përkthim] Dëshiroj që të na shpjegojë
22 Prokurori relevancën dhe z. Selimi në atë kohë duke qenë që ka
23 qenë ministër i rendit publik ka qenë në Malishevë gjatë kësaj
24 kohe. Dhe ndërkohë kemi të njëjtën kundërshtim sa i takon
25 përdorimit të librit të z. Refsdal, megjithatë do të donim të

1 dinim pak më shumë për relevancën e saj.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, bëhet
3 fjalë vetëm për këtë pranim të këtij segmenti, jo për gjë
4 tjetër.

5 Ka ndonjë kundërshtim nga palët e tjera? Siç duket nuk ka
6 kundërshtim. Kështu që do e pranojmë këtë segment të videos.
7 Domethënë, dokumenti 069186 deri në 049186, fragmenti nga
8 minuta 05:33 deri në minutën 07:40 pranohet.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Pranohet dhe merr
10 numrin e provën materiale P01295 dhe klasifikohet si publik.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është publike.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do kërkoja që të paraqitet
14 një tjetër video që është 087008-01 në minutën 02:10.

15 PY. Dëshmitar, pyetja e fundit që kam për juve ka të bëjë me
16 diskutimet për demilitarizimin dhe për këtë çështje që keni
17 trajtuar në librin tuaj. Kam një pyetje ose ndoshta dy pyetje
18 lidhur me këtë temë dhe për periudhën e qershorit të vitit
19 1999.

20 Si pyetje të parë, a e dini në qoftë se ka qenë i
21 përfshirë Kadri veseli në procesin e demilitarizimit,
22 Dëshmitar, diskutimet që janë bërë për demilitarizimin?

23 PË. Unë nuk e di saktësisht se a ka marrë pjesë konkretisht
24 z. Veseli në diskutimet për demilitarizimin e Ushtrisë
25 Çlirimtare të Kosovës, por e di se z. Thaçi dhe z. Krasniqi

1 kanë marrë pjesë dhe i kanë harmonizuar qëndrimet bashkë me
2 ish-zëvendëskryetarin amerikan të shtetit James Rubin në
3 Fshatin e Ri dhe Divjakë. Pastaj marrëveshja është nënshkruar
4 më 21 qershor të vitit 1999 në bazën e KFOR-it në Prishtinë
5 mes z. Thaçi dhe gjeneralit të KFOR-it gjeneralit Michael
6 Jackson.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë, duke marrë parasysh këtë
8 përpara sesa të transmetojmë këtë videon e fundit, do kërkoja
9 që të paraqitej në ekran faqja 692 e librit, që është prova
10 materiale P1264 në faqen 692. Na duhet vetëm versioni në
11 anglisht i librit sepse do bëj vetëm një pyetje lidhur me
12 fotografinë dhe dua që të lexoj këtë citimin poshtë
13 fotografisë për procesverbal. Edhe njëherë, faqja është
14 SPOE00128935.

15 PY. Në fotografinë në fillim tek shënimi poshtë fotografisë
16 shkruhet si më poshtë:

17 "Kadri Veseli, Fatmir Limaj, Agim Çeku dhe përfaqësues të
18 NATO-s dhe komandës së KFOR-it, Prishtinë 21 qershor 1999".

19 Dëshmitar, a pasqyron dhe a përshkruan drejtë kjo pjesa
20 që sapo u lexova përmbajtjen e fotografisë që ekziston në
21 ekran?

22 PË. Po. Fotografia po shënon drejt kush është në fotografi.
23 Është Kadri Veseli, Fatmir Limaj, Agim Çeku dhe një epror i
24 KFOR-it, i NATO-s. Por ju më pyetët a ka qenë, a ka marrë
25 pjesë në bisedime z. Veseli. Për në bisedime nuk e di, po ka

1 qenë i pranishëm bashkë me shumë eprorë tjerë të UÇK-së. Se ka
2 pas shumë eprorë të UÇK-së tjerë që nuk kanë qenë në krye të
3 delegacionit të Kosovës në Paris dhe në Rambuje, por kanë
4 marrë pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes midis
5 UÇK-së dhe KFOR-it në Prishtinë më 21 qershor të vitit 1999.

6 Kur ta formuloni pyetjen, duhet të jeni më i qartë çka po
7 më pyetni, se unë jam gazetar edhe dua ta them mesazhin, ta
8 them vetëm të vërtetën.

9 PY. Faleminderit për saktësimin, Dëshmitar.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Tani mund të kalojmë tek videoja.
11 Edhe një herë Sekretares do i lutesha që të transmetojë videon
12 nga minuta 02:10 në minutën 02:40.

13 [Luhet videoincizimi]

14 Z. HALLING: [Përkthim]

15 PY. Dëshmitar, e di që sapo pamë nuk është regjistruar prej
16 jush, megjithatë pyetja që kam për ju është kjo: A e dini ku
17 është bërë ky filmim?

18 PË. Kjo si duket është një video amatore. Data po thotë 17
19 qershor 1999. Ambienti po më duket që është në Fshatin e Ri.

20 PY. Në ekran tani nga e majta në të djathtë, kush janë këta
21 personat, në qoftë se e dini kush janë?

22 PË. Ky me flokë të thirra është një anëtar, vëzhgues i
23 misionit vëzhgues amerikan, KDOM-it amerikan, ashtu më duket.
24 E kam parë disa herë në Dragobil. Pastaj aty është në mes
25 është z. Fatos Klosi, shefi i Shërbimit Informativ Shqiptar

1 dhe z. Kadri Veseli.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Tani të transmetojmë videon ka
3 minuta 03:50 deri tek minuta 04:15.

4 [Luhet videoincizimi]

5 PY. Dëshmitar, në ekran kush është ky personi që është në të
6 djathtë të ekranit?

7 PË. Është z. Kadri Veseli.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo video,
9 ndërmjet identifikimeve që janë dhënë nga dëshmitari ,kohët
10 ose segmentet përkatëse në video, si dhe diskutimet në libër
11 sa i takon pranisë së Kadri Veselit në procesin e diskutimeve
12 për demilitarizimin, përmbushë kriteret për pranueshmërinë për
13 këtë video përkatëse, kështu që ne do kërkonim që kjo video të
14 pranohet si provë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
16 kundërshtim? Palët nuk kanë kundërshtim.

17 Atëherë, dokumenti 087008-01 -- Prokuror, të dyja
18 fragmentet apo jo?

19 Z. HALLING: [Përkthim] E gjithë videoja kërkojmë që të
20 pranohet.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
22 videoja dhe transkriptet përkuese, do të marrin numrin e
23 provës P01296, klasifikimi aktual është publik. Faleminderit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
25 vazhdoni.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
2 Nuk kemi pyetje të tjera për këtë dëshmitar.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë do
4 bëjmë pushimin e paradites tani. Dhe do fillojmë me Ekipet e
5 Mbrojtjes në orën 11.30.

6 Dëshmitar, do bëjmë 30 minuta, pak më shumë se 30 minuta
7 pushim sipas planit të zakonshëm. Ju lutem mos flisni me
8 askënd jashtë sallës së gjyqit për dëshminë këtu.

9 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, për arsye
11 planifikimi. E di që ZPS-ja e zgjati goxha kohën e vet
12 krahasimisht me planifikimin paraparak, megjithatë nuk është se
13 po them që jam në kundërshtim të kësaj. Por unë nuk planifikoj
14 që të përdor më shumë kohë seç kam thënë më përpara. Atëherë
15 edhe unë mbase mund të përdor pak më shumë kohë sesa ç'kisha
16 planifikuar fillimisht.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë. Në
18 rregull. Na e thoni kur të vij momenti.

19 Z. Tully, mendoni se dy orë do ju duhen?

20 Z. TULLY: [Përkthim] Besoj se mbase më pak sesa dy,
21 megjithatë do ta shikoj si do shkoj procesi.

22 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Edhe ne na duhen diku dy orë
23 dhe do na duhen që t'i përdorim plotësisht këto dy orë sipas
24 vlerësimit paraparak.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 Do bëjmë pushimin tani. Do kthehemi përsëri në orën

2 11.30.

3 --- Pauza fillon në orën 10.57

4 --- Seanca rifillon në orën 11.30

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më duhet të
6 them që e vlerësoj përpjekjet e të gjithëve. Këto javë janë
7 shumë të vështira për të gjithë. E kuptoj që të gjithë
8 ndjehemi të lodhur. Edhe unë ndjehem shumë i lodhur.

9 Mund të sillni dëshmitarin në sallë.

10 Me sa duket me këtë dëshmitar do përfundojmë nesër. Me të
11 ngjarë, Dëshmitari i radhës nuk do bëhet këtë javë. As i dyti.
12 Pra, e kuptoj që ky dëshmitar do të marrë goxha kohë. Do ketë
13 pyetje përsëri nga Trupi Gjykses. Do ketë pyetje shtesë. Është
14 e mirëkuptueshme, kështu që do sugjeroja që të paktën të
15 mbarojmë me këtë dëshmitar këtë javë.

16 [Dëshmitari vijon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë,
18 Dëshmitar. Tani do të fillojnë ekipet e Mbrojtjes. Z. Misetic
19 nga Mbrojtja e z. Thaçi do fillojë me pyetjet tani.

20 Fjala për ju, z. Misetic.

21 Z. MISETIC: [Përkthim]

22 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

23 Z. MISETIC: [Përkthim]

24 PY. Mirëmengjesi, Dëshmitar. Unë quhem Luka Misetic. Jam
25 Avokati i z. Thaçi. Edhe unë kam disa pyetje për ju.

1 Dëshmitar, unë dua të fillojmë me një fotografi që ta
2 tregoi dje edhe Prokurori.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Lutem që të vendoset në ekran
4 prova materiale P01272.

5 PY. Dëshmitar, dje në dëshminë tuaj, ju thatë se kjo
6 fotografi është bërë më 17 qershor të vitit 1998 te Bardhi i
7 Madh. Kështu?

8 PË. Po, kjo fotografi është bërë më atë datë si thoni ju.

9 PY. Ju lutem shikojeni nga afër fotografinë, dhe ki parasysh
10 veshjet që kanë të katërt personat në fotografi, veçanërisht
11 shohim çfarë ka veshur z. Veseli dhe çfarë keni veshur ju
12 personalisht.

13 Tani, duke pasur këtë në mendje, të shohim një video që
14 ua tregoi z. Halling, Prokurori.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë do të përpiqem të mos i shohim
16 të gjitha videot. Sidoqoftë, do të doja që fillimisht të
17 shihnim videon me numër P01280, në sekondën e 14, deri në
18 sekondën e 20. Më falni, nuk e thashë mirë. Nga sekonda 14
19 deri në sekondën e 22-të. Nuk na nevojitet zë për këtë video.

20 [Luhet videoincizimi]

21 Z. MISETIC: [Përkthim]

22 PY. Dëshmitar, arrini ta shquani se çfarë keni veshur në këtë
23 fotografi?

24 PË. Po.

25 PY. A keni një këmishë të bardhë dhe pantallona bluxhins?

1 PË. Po.

2 PY. Po Z. Veseli e sheh pak më pas.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të shkojmë deri te -- mund të
4 shkoj -- mund të shkojmë te sekonda e 35 ju lutem sepse do të
5 jetë më e qartë aty, dhe e mbajmë ta ndaluar te sekonda e 35-
6 të. Jo, më mirë kthehemi te sekonda e 22.

7 PY. E shihni që duket sikur z. Veseli ka të njëjtat rroba që
8 kishte edhe te fotografia e 17 qershorit te Bardhi i Madh?

9 PË. Po, të njëjtat i ka. Ashtu duket.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Do shohim një video tjetër që po
11 ashtu ua tregoi z. Halling.

12 PY. Ju thoni që kjo video është marrë më 26 qershor në Kleçkë
13 për këtë që sapo pamë, apo jo?

14 PË. Po, më 26 qershor të vitit 1998, në Kleçkë.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim videon P01281. Do fillojmë
16 në sekondën e 33 dhe do shikojmë deri te sekonda e 49.

17 [Luhet videoincizimi]

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk jam i sigurt nëse ishte kjo
19 videoja. Duhet të jetë videoja që mbaj numrin P1281 [Sipas
20 përkthimit].

21 [Luhet videoincizimi]

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, për këtë video bëhet fjalë.

23 [Luhet videoincizimi]

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Ndaloni këtu, ju lutem.

25 PY. Dëshmitar, i shini rrobat që ka z. Veseli këtu?

1 PË. Po.

2 PY. A janë të njëjtat rroba që ka edhe në fotografinë e 17
3 qershorit në Bardhin e Madh?

4 PË. Ashtu po duket, e njëjta.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani mund ta shohim videon, deri
6 te sekonda e 49-të.

7 [Luhet videoincizimi]

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Kthehu ju lutem një sekondë më
9 mbrapa. Një sekondë vetëm më mbrapa, të shkojmë te sekonda e
10 48.

11 PY. Dëshmitar, po z. Thaçi a duket sikur ka të njëjtat rroba
12 që kishte te fotografia e 17 qershorit të vitit 1998,

13 PË. Po --

14 PY. -- që ju thoni që është marrë në Bardhin e Madh?

15 PË. Po, ashtu -- ashtu duket, të njëjtat i ka.

16 PY. Po ju personalisht, a keni të njëjtat rroba veshur?

17 PË. Po, të njëjtat. Më 26 -- 26 qershor kjo është.

18 PY. Po, që ta kemi edhe të qartë për procesverbal - po ju
19 personalisht, keni veshur të njëjtat rroba?

20 PË. Po, po, të njëjtat rroba janë.

21 PY. A është e mundshme që të tre ju të keni të njëjtat rroba
22 për 9 ditë radhazi?

23 PË. Është e mundshme se në kohë të luftës s'kemi pasur
24 mundësi që t'i ndërrojmë çdo ditë rrobat, edhe kam -- kam qenë
25 një kohë të gjatë në zonët a luftës. Nuk kam shku në Prishtinë

1 për t'i ndërruar rroba të tjera. Ka qenë e pa mundur të -- të
2 ndërrohen për çdo ditë rroba.

3 PY. Pra, këtu jeni në një dasmë, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Ju menduat që edhe në dasmë s'patët mundësi t'i ndërronit
6 rrobat?

7 PË. Po bre, çka -- luftë ka qenë. Ka qenë rrethana lufte.

8 PY. Dëshmitar, ju thatë që i mbani mend këto data sepse keni
9 mbajtur shënime të vendeve edhe kohëve kur i keni incizuar
10 videot. Kështu?

11 PË. Kam deklaruar edhe në libër, edhe në dëshminë time dje se
12 i kam mbajtur shënimet e misionit që kam realizuar dhe
13 transmetuar në televizionin shqiptar. Kemi shënuar datën, kur
14 janë realizuar dhe kur janë transmetuar. Edhe këto i di shumë
15 mirë. Kjo ka qenë datë shumë e rëndësishme, 26 qershori i
16 vitit 1998, datë historike për UÇK-në. Është dhënë betimi
17 solemn dhe unë e kam pasur nderin, bashkë me Abaz Zekën ta
18 xhirojmë të gjithë betimin solemn dhe dasmën e parë në
19 rrethana lufte. Dhe kjo është e pamundur të harrohet.

20 PY. Po, te fotografia në Bardhin e Madh, kur ke shkruar
21 librin, ke pasur shënime për datat kur janë bërë disa
22 fotografi apo kur janë xhiruar disa video? Pra, keni pasur
23 data të shënuara në një bllok apo i kishit të gjitha të
24 gdhendura në kujtesë?

25 PË. Jo, në bllok nuk i kisha të shënuara se ka qenë e

1 pamundur të mbaj ditar në rrethana lufte. Por e mbaj mend, për
2 shembull, me 16 të qershorit të vitit 1998 është vrarë
3 dëshmori Imer Krasniqi nga Caralloka e Malishevës dhe ky është
4 dëshmori i parë i asaj treve ku jetoj edhe unë dhe familja
5 ime, kurse më 17 qershor, të nesërmen, është bërë varrimi në
6 fshatin Carallokë me nderime ushtarake, ku kam marrë pjesë një
7 numër i madh i banorëve të Llapushës dhe kjo datë, domethënë,
8 ka qenë më 17 qershor. E mbaj mend shumë mirë si datë, kur
9 është xhiruar edhe -- kemi shkuar pastaj bashkë me z. Thaçi
10 dhe z. Veselin në Bardh të madh për të parë gjendjen në
11 minierën sipërfaqësore.

12 PY. Në rregull. Pra, datat i ke pasur në mendje, kështu?

13 PË. Po, në mendje.

14 PY. I keni thënë ZPS-së në Shënim Përgatitor numër 2, kështu.

15 I keni thënë që:

16 "Kur përgatisnim programe për televizionin shqiptar, e
17 dinit se u përcoll ky emision sepse keni marrë shënime në atë
18 kohë për këtë emisione. Dhe këto shënime i ke mbajtur në
19 shtëpi gjatë luftës, që të ishin të sigurta. Dhe më pas kur
20 shkruat librin, i morët të gjitha këto shënime, në mënyrë që
21 të plotësonit kronologjinë kohore."

22 Kështu?

23 PË. Po, ashtu.

24 PY. Pra, shënime i përdore më shumë për të ndihmuar -- për
25 t'ju ndihmuar personalisht me kronologjinë kohore që do të

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 62

1 vendosej në librin tuaj. Kështu?

2 PË. Ashtu është --

3 PY. -- për të plotësuar datat që dinit

4 PË. Ashtu është.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani i lutem Skretares që të
6 vendosim në ekran dokumentin 50154328 deri në 5014329. Ju
7 lutem, edhe shqipen edhe anglishten.

8 DËSHMITARI: Këtu është vetëm në gjuhën shqipe -- në
9 gjuhën angleze, nuk është në gjuhën shqipe.

10 Z. MISETIC: [Përkthim]

11 PY. Është një faqe tjetër në shqip, por është faqja tjetër.
12 është kjo.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] A kemi ndonjë mundësi t'i vendosim
14 të dyja në ekran?

15 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet që para se të bënit intervistën
16 me ZPS-në në vitin 2019, të dorëzuan një urdhër për të
17 paraqitur materiale? Urdhrin ta ka dorëzuar Prokuroria. Të
18 kujtohet?

19 PË. Po, më kujtohet. Shënim me shkrim ka qenë urdhri.

20 PY. Po. A është ky urdhri që po shohim në ekran, për këtë
21 bëhet fjalë?

22 PË. Nuk po shoh të tërin. Te lutem a -- të shkojë në fund.
23 Është i firmosur. Nuk është komplet. Po --

24 PY. Tani dua të shohim çfarë të kanë kërkuar të paraqesësh.

25 Numër 1 thotë:

1 "Të gjitha regjistrimet me audio dhe/ose video, duke
2 përfshirë xhirimet e paredaktuara si dhe materialet e tjera
3 lidhur me Drejtorinë Politike të Ushtrisë Çlirimtare të
4 Kosovës dhe Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, të krijuara
5 gjatë periudhës nga 1 maji i vitit 1998 deri më 30 shtator të
6 vitit 1999, duke përfshirë mes të tjerash, regjistrimet e
7 deklaratave dhe paraqitje të anëtarëve të drejtorisë politike
8 të UÇK-së dhe të Shtabit të Përgjithshëm si dhe regjistrimet
9 nga ngjarjet në të cilat këta persona kanë qenë të pranishëm."

10 Dëshmitar, a ja keni dhënë Prokurorisë të gjitha
11 materialet që kishe në posedim dhe që janë pjesë e këtyre
12 materialeve që përmenden në këtë paragraf?

13 PË. Po, ja kam dhënë Prokurorisë por ja kam dhënë edhe
14 Mbrojtjes. Të gjitha materialet që i kam dhënë Prokurorisë, të
15 njëjtat i kam dhënë edhe Mbrojtjes.

16 PY. Thoni që ja keni dhënë Prokurorisë. Për Prokurorinë duam
17 ta konfirmojmë dhe ja keni dhënë Prokurorisë?

18 PË. Po, po.

19 PY. Kur thoni "edhe Mbrojtjes", kujt ja keni dhënë këtë nga
20 Mbrojtja?

21 PË. I kam shënuar në Prishtinë atje, disa emra të anëtarëve -
22 - të gjithë të akuzuarit i kam dhënë të njëjtën kopje. Ata m'i
23 kanë dërguar disa përfaqësues që kanë qenë pjesë e ekipit të
24 Mbrojtjes dhe ja kam dhënë të gjithëve, pa përjashtim.

25 PY. Në rregull. Lexojmë pikën 3. Dhe do ta shtjellojmë pak më

1 vonë këtë që sapo thatë.

2 Te pika 3 të është kërkuar të japësh?

3 "Të gjitha regjistrimet me audio dhe/ose video, duke
4 përfshirë xhirimet e paredaktuara si dhe materiale të tjera të
5 aktiviteteve të UÇK-së të krijuara për dokumentarët dhe
6 emisionet televizivë."

7 Dhe ka renditur katër dokumentarë ose programe
8 televizivë. Dhe këtu bëhet fjalë edhe për ato që janë xhiruar
9 dhe tra -- më fal, transmetuar më 24 nëntor të vitit 1998.
10 Kështu?

11 PË. Po, ashtu.

12 PY. Ja keni dhënë këto Prokurorisë, këto regjistrimet?

13 PË. Po, ja kam dhënë.

14 PY. Në paragrafin 74 të Shënimit Përgatitor numër 2 thuhet se
15 kishit shënime në shtëpi gjatë luftës, ku kishit shënuar datat
16 për të cilat -- të cilat i keni përdorur për të ndërtuar
17 kronologjinë kohore. Këto shënime të cilat sapo përmenda unë,
18 ja keni dhënë Prokurorisë?

19 PË. Jo.

20 PY. Pse nuk ja keni dhënë?

21 PË. Se s'mi ka kërku ato, dhe ato janë shënime personale të
22 miat, e s'mi ka kërku.

23 PY. Në rregull. Që të jemi të qartë, te pika 1 dhe 3 -- dhe
24 thuhet:

25 "... dhe materiale të tjera të aktiviteteve që lidhen me

1 Drejtorinë Politike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe çdo
2 regjistrim e deklaratë të mëtutjeshme ku kanë qenë të
3 pranishëm këta persona.”

4 Sipas jush, shënimet tuaja nuk mund -- nuk janë pjesë e
5 kësaj kategorie materialesh në pikën 1 dhe as në pjesën e
6 materialeve që përmenden në kategorinë 3?

7 PË. Unë e kam kuptuar se më kërkohen xhirime, materiale art -
8 - filmike. Ashtu -- nuk më -- nuk, nuk më është thënë në
9 mënyrë decisive ndonjë shënim mbase tjetër -- tjetër. këtë s'e
10 kanë specifiku. Kam kuptue se për xhirime është fjala.

11 PY. Në rregull.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim urdhrin tjetër, që mban
13 numrin 5007784-5007793.

14 PY. Pasi është lëshua ky urdhër dhe pas intervistës me ZPS-
15 në, ZPS-ja ju dha një urdhër tjetër, apo jo? Dhe ju tha që
16 duhet të dorëzoni edhe materiale të tjera. Ju kujtohet ky
17 urdhër?

18 PË. Po, ka qenë një urdhër i dytë dhe unë e kam hulumtuar
19 arkivin tim, se ashtu s'e kam pas komplet në atë periudhë. Një
20 pjesë e arkivit është djegur gjatë vitit 2012 në televizionin
21 publik të Kosovës dhe ndërkohë, kam gjet xhirimet, i kam
22 kompletuar xhirimet të tjera, të cilat kanë qenë edhe publike.
23 Janë transmetuar pjesa më e madhe e tyre në televizionin
24 shqiptar. Dhe unë e kam parë të arsyeshme që nëse i shërben
25 drejtësisë ndërkombëtare mund të përdoren për drejtësinë

1 ndërkombëtare.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim faqen e parë. Duhet të
3 nxirrni edhe anglishten ju lutem, në të djathtë. Po, kjo
4 është.

5 PY. Dëshmitar, nëse ke nevojë, mund ta lexosh, por nëse nuk
6 është nevoja, a mund t'ju pyes nëse është ky urdhri i dytë për
7 të paraqitur dokumentin që e keni marrë më 21 qershor të vitit
8 2019?

9 PË. Nuk po e di a është ky urdhri i parë a i dytë. S'e di
10 tash cili ka qenë -- cili ishte data e urdhrit të parë. S' --
11 nuk e mbajta mend datën. Të jem i saktë.

12 PY. Urdhri i parë ka qenë më 21 qershor, më falni. Lexojeni.
13 Lexojeni urdhrin dhe thotë:

14 "Në vijim të urdhrit të qershorit, duhet të dorëzoni
15 materiale të tjera."

16 PË. Po, ky është urdhri i parë. Një pjesë të materialit e kam
17 dorëzuar herën e parë. Pastaj herën e dytë kur është bërë
18 urdhri i dytë, e kam dorëzuar edhe pjesën e dytë. Aty data
19 shkrun, shkrun diku në shtator, a ku ishte.

20 PY. Po. Shohim të gjitha pikat. Të shohim çfarë ka kërkuar
21 ZPS-ja. Të gjitha thonë "xhirimet e paredaktuara" thuhet deri
22 këtu, por nëse shkojmë te pika 9 --

23 Z. MISETIC: [Përkthim] -- që do të thotë që duhet të
24 shkojmë në faqen tjetër, që mban numrin 5007787.

25 PY. Këtu është një kërkesë që nuk të kërkon vetëm xhirimet,

1 por thotë edhe materiale të tjera. E shihni?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe sipas teje, shënimet e tua nuk ishin materiale të
4 tjera? Nuk ishin pjesë e kategorisë pjesë e materialeve të
5 tjera që ju kërkohen këtu?

6 PË. Jo, s' -- unë e kam kuptuar se më është fjala për
7 xhirime, jo për materiale të tjera.

8 PY. Në rregull, dhe nga shtatori i vitit 2019 e deri më sot,
9 në asnjë moment -- pra që nga shtatori i vitit 2019 nuk të ka
10 thënë ZPS-ja që duhet të na jepni këto dokumente? Këto shënime
11 që përmenden në paragrafin 74 të Shënimit Përgatitor numër 2.
12 Pra nga shtatori deri tani, t'i ka kërkuar ZPS-ja këto
13 shënime?

14 PË. Jo, nuk më ka kërkuar asgjë më tepër.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. I nderuar
16 Kryegjykatës, kërkoj të pranohen si prova dy urdhrat në fjalë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
18 kundërshtime?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtojmë për -- në bazë të
20 relevancën, pse duhet të pranohen.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Janë
22 relevante, dhe do t'i pranojmë. Kështu që ju lutem, jepini
23 numrin përkatës materialeve me numër 5014328 deri në 50114329
24 [Sipas përkthimit]. Gjithashtu, e njëjta gjë, 5007784 deri në
25 5007793 pranohet.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti i parë merr
2 numrin e provës materiale 1D0016 -- 56, dhe dokumenti i dytë
3 merr numrin e provës materiale 1D00157 me klasifikim
4 konfidencial.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të klasifikohen si publike,
6 në qoftë se Prokuroria nuk ka kundërshtime.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi asnjë kundërshtim që të
8 jenë publikë këto materiale.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
10 riklasifikojini si publike.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Ka diçka --
12 nënshkrimet veçse, nuk duhet të paraqiten për publikun. Kështu
13 që ju lutem të bëjmë një klasifikim konfidencial që të -- për
14 momentin, dhe ta redaktojmë, sepse nuk duhet të shfaqet
15 nënshkrimi i punonjësve të Prokurorisë.

16 Përmbajtja mund të jetë publike, vetëm atë pjesë ta
17 redaktojmë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. e
19 mbajmë klasifikimin konfidencial për momentin, deri sa të
20 bëjmë redaktimin përkatës.

21 DËSHMITARI: Z. Avokat, mund të shtoj këtu ku është fjala
22 për materiale të tjera? A mund të shtoj?

23 Z. MISETIC: [Përkthim]

24 PY. Çfarë do të --

25 PË. Rreth materialeve --

1 PY. -- çfarë, çfarë doni të thoni?

2 PË. Rreth materialeve që më janë kërkuar nga Prokuroria.

3 Është shumë me rëndësi të theksohet se në mesin e materialeve
4 që kam dorëzuar për Prokurorinë, kam dorëzuar edhe qindra orë
5 material për dëshmitë e dëshmitarëve që kanë mbijetuar në
6 masakrat e forcave serbe mbi popullatën civile në Kosovë, dhe
7 as në -- asnjë pyetje dhe asnjë sekondë nga këto xhirimet nuk
8 m'u -- nuk u pyeta dje nga Prokuroria, as sot.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
10 dëshmitar.

11 Ju lutem mos shtoni informacion që nuk kanë lidhje me
12 pyetjen që ju kanë bërë, ju lutem. Ishte krejt e panevojshme.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

14 PY. Dëshmitar, ju punoni ende si gazetar, apo jo?

15 PË. Jo, aktualisht jam në pension, por punoj në realizime të
16 disa dokumentarëve, shkruaj libra, monografi, kështu me radhë.

17 PY. Kur keni dalë në pension?

18 PË. Kam dalë në 17 gusht të vitit 2020.

19 PY. A është e vërtetë që keni filluar ta mbuloni -- jo do ta
20 bëj edhe një herë pyetjen.

21 Kur keni filluar për herë të parë të mbuloni veprimtarinë
22 e UÇK-së në cilësinë tuaj si gazetar?

23 PË. Po, menjëherë pas epopesë së lavdishme të UÇK-së në
24 Prekaz me 5, 6, 7 mars të vitit 1998, kam marrë iniciativën që
25 të angazhohem vullnetarisht si gazetar për t'i informuar

1 opinionit të zonës së luftës sepse nuk kishim televizion, as
2 nuk kishim gazetë të përditshme -- ditore, siç ishte në atë
3 kohë Rilindja. Por në bashkëpunim me Qeverinë e atëhershme në
4 Ekzil të Kosovës, dhe me kolegët e tjerë që punonin në Radio
5 Televizionin publik të Prishtinës, e redaksinë në Tiranë, kemi
6 marrë iniciativën që unë të angazhohem bashkë me Sadik
7 Shabanin, Migjen Kelmendin, Abaz Zekën e kolegët e tjerë, në
8 realizimin e disa emisioneve televizive për televizionin
9 shqiptar. Domethënë, ka qenë kjo - marsi, prilli i vitit 1998.
10 PY. A është e vërtetë që ju vendosët ta ndiqnit këtë më tej
11 përmes një kontakti që kishit në Prishtinë, me emrin Shaban
12 Shala?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem, a keni fjalën -- ta
14 sqarojmë me Miseticin, Shaban Shala deshët të thoshit?

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, po shosh librin e tij. E ka në
16 libër.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Madje po ju jap edhe referencën ku
19 po e shoh. Është -- është prova materiale P01269 -- jo më
20 falni. Është P01264 në faqen SPOE00128582.

21 PY. Lexoj, meqë u vu në pikëpyetje. Keni shkruar:

22 "Disa ditë më përpara, para se të shkoja në Drenicë,
23 takova Shaban Shalën, i cili ishte -- ishte zëvendëskryetari i
24 KLD-së -- KLDNG-së në zyrat qendrore në Prishtinë. Kështu?

25 PË. Po, ashtu. Shaban Shala ka qenë nënkryetari për mbrojtjen

1 e të drejtave e të lirive të njeriut me seli në Prishtinë por
2 mora vesh që ishte angazhuar edhe në Ushtrinë Çlirimtare të
3 Kosovës, dhe bisedoja me të se si të gjeja rrugë më të sigurta
4 për të depërtuar në zonat e luftës, sepse ishte situatë shumë
5 e vështirë, dhe çdo vend kishte punkte të policisë serbe dhe
6 ishte e pamundur që me kamerë të qarkullohej në mënyrë të
7 rregullt, sepse nuk kisha akreditim dhe ishte shumë e vështirë
8 të -- që të shkohej në zonat e luftës.

9 PY. Ju jeni mbështetur te Shaban Shala në mënyrë të tillë që
10 të krijoni kontakte me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së në
11 mënyrë që të koordinoheni me ta, për të informuar publikun se
12 çfarë po ndodhte gjatë luftës. Apo jo, Dëshmitar?

13 PË. Po, ashtu është.

14 PY. Në librin tuaj thuhet që kjo ka ndodhur në prill të vitit
15 1988. A ju kujtohet tani muaji, Dëshmitar?

16 PË. Po, në prill ka qenë me siguri. Tash datat nuk i di të
17 sakta. S'i kam të shënuara, por ka qenë me siguri prilli i
18 vitit 1998.

19 PY. Shaban Shala ka qenë personi që ka folur me disa
20 komandantë në Drenicë në emrin tuaj, apo jo. A është e saktë
21 kjo?

22 PË. Nuk e di, ndoshta ka folur, nuk e di.

23 PY. Do të lexoj atë çfarë thuhet në librin tuaj.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Përsëri, për procesverbal bëhet
25 fjalë për provën materiale P01264, në faqen SPOE00128602.

1 PY. Ju shkruani:

2 "Unë nuk doja që të më ndodhte diçka e tillë, sepse kisha
3 gatishmërinë dhe vullnetin që të mbështesja luftën. Shaban
4 Hoxha foli me Iliaz Selimin, vëllain e Selimit dhe me disa
5 komandantë të tjerë në zonën e Drenicës, megjithatë nuk kishte
6 marrë asnjë lloj garancie. Ai më tha, megjithatë, "Nuhi, në
7 qoftë se je gati mund të shkojmë bashkë në Drenicë dhe mund
8 t'ju ndihmoj që të kontaktoni me Iliaz Selimin, që është një
9 prej komandantëve në Drenicë."

10 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

11 PË. Shumë e saktë është. Ashtu është.

12 PY. Pra, a është e saktë se në vend që fillimisht të
13 kontaktonit me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, ju jeni marrë
14 me komandantët lokalë në zonën e Drenicës. Është e vërtetë
15 kjo, Dëshmitar?

16 PË. Po, po. Po, se s'kam dit atëherë kush është Shtab, a kush
17 është në krye të Shtabit e kështu. Atëherë s'është dit.

18 PY. Ndërkohë që Shtabi i Përgjithshëm po shqyrtonte kërkesën
19 tuaj, ju pavarësisht kësaj, vendosët që të shkonit dhe të
20 mbulonit zhvillimin në Llaushë të Drenicës në maj të vitit
21 1998. A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

22 PË. Po, kam shkuar në Mitrovicë fillimisht, ku jam takuar me
23 kameramanin e parë, Shaban -- Sadik Shabanin, i cili jetonte
24 në Mitrovicë, dhe nga Mitrovica kemi shkuar bashkë me Halit
25 Baranin dhe dëshmorin Agim Ramadani, në Likovc -- në Polac, në

1 Prekaz e në fshatrat të tjera, në Qirez, në Likoshan e pastaj
2 edhe në Llaushë.

3 PY. Dhe ky raportimi juaj ose kjo që -- puna juaj, u
4 transmetua në radiotelevizionin shqiptar më pas, Dëshmitar,
5 apo jo?

6 PË. Po, është transmetuar në televizionin shqiptar.

7 PY. Sipas librit tuaj, pasi u bë transmetimi i këtij emisioni
8 në radiotelevizionin shqiptar, juve u kontaktuat më pas nga
9 Rexhep Selimi që ju tha që i kishte pëlqyer reportazhi i bërë
10 prej jush. A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

11 PË. E vërtetë është. Sepse e thashë edhe dje: Në atë kohë
12 televizioni shqiptar, dhe gazeta Bujku dhe mediat të tjera,
13 përdornin termin "mbrojtja e pragut të shtëpisë". Dhe Rexhep
14 Selimi me të drejtë kritikoi këtë informim jo të saktë. Tha,
15 Ushtria Çlirimtare po lufton për çlirimin e Kosovës e jo vetëm
16 për mbrojtjen e pragut të shtëpisë. Dhe unë shkova, hyra në
17 Skënderaj, që ishte shumë rrezik, kishte shumë policë,
18 rrezikova bashkë me veprimtarë të shoqatës humanitare Nëna
19 Terezë dhe hyra në qendër të Skënderajt. Ishte një atmosferë e
20 zyrtë, pa njerëz, e shkatërruar, e djegur dhe shkova në
21 Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në
22 Skënderaj, dhe aty -- nga aty mora telefonin dhe raportova për
23 gjendjen në Llaushë dhe në Skënderaj dhe përdora termin tamam
24 se Ushtria Çlirimtare e Kosovës po lufton për çlirimin e
25 Kosovës dhe kur u takova pastaj me z. Rexhep Selimi, Rexhep

1 Selimi tha "bravo, e ke kryer detyrën si -- si gazetar
2 objektiv".

3 PY. Kjo ngjarje do ishte e drejtë të thuhej që ishte
4 pikërisht ky reportazh dhe po kjo ngjarje që ju krijoi një
5 lloj besimi juve te Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. Domethënë,
6 ky lloj reportazhi që ti e kishe bërë vetë, apo jo?

7 PË. Po ishte -- ishte raport telefonik. Ishte lajmet te
8 televizioni shqiptar. E kisha bërë vetë.

9 PY. E gjithë ka ndodhur përpara se sa të dilte ose të bëhej
10 paraqitja e parë e zëdhënësit të UÇK-së në qershor të vitit
11 1998. A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

12 PË. Po, ashtu është.

13 PY. Sa i takon paraqitjes së parë dhe organizimit të saj, pra
14 e kam fjalën për paraqitjen e parë të zëdhënësit. Si ndodhi,
15 të kontaktuan ata ty, apo ishe nisma juaj që të kontaktoni me
16 ta dhe të pasqyroni paraqitjen e parë të zëdhënësit?

17 PË. Po ishte nisma ime që të kontaktoja dhe të kisha
18 përkrahjen e luftëtarëve të UÇK-së për të bërë imazhet në
19 zonat e luftës, për të pasqyruar gjendjen reale në zonat e
20 luftës, dhe u takova, si kam shkruar edhe në librin tim të
21 luftës, me z. Thaçi në Drenovc të Rahovecit, dhe z. Thaçi më
22 premtoi se "nëse dikush do ta xhirojë paraqitjen e parë
23 publike, do jesh ti, Nebih [Sipas përkthimit]." Dhe ashtu
24 ndodhi.

25 Unë dhe Abaz Ike kemi xhiruar paraqitjen e parë publike

1 të z. Jakup Krasniqi, më 14 qershor të vitit 1998 në Kleçkë.
2 PY. Si ndodhte, reportazhet tuaja ose filmimet, ndodhnin me
3 nismën tuaj apo ndodhnin me kërkesë të UÇK-së. Domethënë, të
4 kontaktonte UÇK-ja ty për të bërë reportazhet ose filmimet,
5 apo ti vetë me iniciativën tënde i bëje këto gjëra?

6 PË. Jo, pas marrëveshjes me z. Thaçi, unë e kisha pëlqimin
7 nga ai që -- si përgjegjës për informim që të -- bashkë me
8 Abaz Ikën, që të bënë të gjitha ato imazhe në zonat e luftës.
9 Ideja ishte e jona, por kemi pasur përkrahjen e luftëtareve të
10 UÇK-së në të gjitha zonat që kanë qenë nën kontrollin e
11 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

12 PY. Por ka pasur raste, besoj që ju vazhdonit me lajmet tuaja
13 pa miratimin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së apo jo? Është
14 e saktë kjo? Se për shembull në rastet e Grykës së
15 Llapushnikut --

16 PË. Po, është e vërtetë. Unë kam qenë gazetar i pavarur dhe
17 kam konsideru se çka është në funksion të informimit objektiv,
18 duhet ta plotësoj. Jam konsultuar normalisht, me njerëzit
19 përgjegjës për informacion në kuadër të UÇK-së, por gjithmonë
20 e kam ruajtur vijën time profesionale. Objektivitetin dhe
21 informimin real.

22 PY. Dëshmitar, më thonë që ndoshta nuk është pasqyruar diçka
23 në përkthim. Kur ju pyeta pak më herët dhe kur thashë më herët
24 që gjatë gjithë vitit 1998 ju kontaktonin ata juve apo juve
25 merrnit nismën vetë. Ideja e kujt ishte kjo --

1 PË. Ideja --

2 PY. -- e kujt ishte ideja?

3 PË. Ideja ishte e jona por na kanë kontaktuar disa herë me
4 telefon dhe jemi konsultuar dhe kemi bashkëpunuar.

5 PY. Në rregull. Tani të flasim pak për Grykën e Llapushnikut.

6 Në këtë rast ju filmuat dhe bëre lajm pa lejen e Shtabit të
7 Përgjithshëm të UÇK-së. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

8 PË. Po, e saktë është.

9 PY. Në këtë rast, ju keni regjistruar një deklaratë nga
10 Shaban Shala, një ushtar i UÇK-së. A është e saktë kjo?

11 PË. E saktë është. Me Shaban Shalën jemi nisur për të shkuar
12 në Drenovc të Rahovecit dhe duke shkuar aty kaluam nga Gryka e
13 Llapushnikut, dhe filloi të tregonte Shabani për betejën e
14 Grykës së Llapushnikut dhe unë i thashë, "Shaban, është mirë
15 që ta shfrytëzojmë rastin të xhirojmë pranë këtij pizgaverit,
16 i cili është dëmtuar gjatë betejës me Grykën e Llapushnikut
17 mes forcave të UÇK-së dhe forcave serbe, dhe Shabani tha, "nuk
18 është mirë, tha, që të xhirohet pa ndonjë marrëveshje me
19 njerëzit për informim", por unë insistova që të xhirohet
20 deklarata e Shabanit për këtë ngjarje që ishte me rëndësi, dhe
21 pastaj e kam transmetuar në televizionin shqiptar.

22 PY. Dhe kjo krijoi një lloj fërkimi midis jush dhe zotit
23 Thaçi. A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

24 PË. Ishte një fërkim i vogël, por jo i madh. Unë e mbrojta
25 atë vijën profesionale time, se e kam xhiruar intervistën dhe

1 nuk e shoh të arsyeshme që të mos transmetohet. Edhe ishte
2 shumë pozitive që të transmetohej në atë periudhë, por ndoshta
3 Thaçi ka menduar se duhet të dalë zëdhënësi i UÇK-së që pritej
4 të dilte ato ditë, dhe sigurisht i ka pasur arsyet e veta që
5 mos të transmetohej paraqitja e z. Shaban Shala me atë
6 pretekst. Me siguri. Ashtu kam menduar, por unë e kam mbrojt
7 vijën time profesionale se duhet të transmetohej dhe është
8 transmetuar.

9 PY. Në rregull. Në disa raste, edhe me miratimin e Shtabit të
10 Përgjithshëm, ndodhte që ju të ishit në zonë. Për shembull në
11 zonën e Dukagjinit, dhe edhe pse kishit leje nga Shtabi i
12 Përgjithshëm, ju nuk lejoheshit që të bënit filmime ose
13 xhirime pa lejen e komandantit të zonës. A është kështu,
14 Dëshmitar?

15 PË. Po, kjo është e vërtetë, që thashë edhe dje. Kemi shkruar
16 bashkë me z. Thaçi dhe z. Selimi në Dukagjin, dhe me z. -- dhe
17 me Lahi Brahimaj, kemi shkruar në Dukagjin, po ka qenë me neve
18 edhe Avdi Raci. Kemi shkruar në Dukagjin për të marrë disa
19 imazhe sepse mungonin imazhet nga Dukagjini. Ishin kryesisht
20 imazhe nga Drenica, dhe zona e Pashtrikut kështu që unë
21 propozova që të shkojmë në Dukagjin dhe të marrim imazhe edhe
22 në Dukagjin.

23 Mirëpo kur shkuam atje në fshatin Krushec dhe në fshatin
24 Vranoc, takuam disa luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të
25 Kosovës, të cilët ishin nën komandën e komandantit të zonës

1 operative të Dukagjinit, z. Ramush Haradinaj, dhe ata na
2 urdhëruan që të mos xhirojmë asnjë imazh. Unë kisha kaluar
3 bashkë me z. Thaçi dhe z. Selimi dhe Lahiu në rrugë shumë të
4 rrezikshme dhe nuk e respektova urdhrin e luftëtarëve të UÇK-
5 së. Thashë "unë do të xhiroj shtëpitë e djegura, do të xhiroj
6 popullatën civile. Nuk do xhiroj Ushtrinë Çlirimtare të
7 Kosovës, po të xhiroj shtëpitë e djegura", dhe pa urdhrin e
8 tyre unë i xhirova ato imazhe sepse vlerësova se ato janë
9 shumë të rëndësishme për opinionin tonë.

10 PY. Po, kjo ka ndodhur në korrik të vitit 1998, apo jo,
11 Dëshmitar?

12 PË. Në qershor -- në qershor të vitit 1998.

13 PY. Në rregull. Pavarësisht kësaj, juve bëtë regjistrimet pa
14 pëlqimin e komandantit të zonës, apo jo, Dëshmitar?

15 PË. Po, pa pëlqimin e -- bëra xhirimet pa pëlqimin. Mora
16 rrezikun mbi vete si gazetar sepse vlerësova që është shumë me
17 rëndësi që të kemi imazhe edhe nga zona operative e
18 Dukagjinit. E isha i vetëdijshëm për pasojat, por gazetarët
19 nëse nuk rrezikojnë, nuk mund ta kryejnë me sukses detyrën e
20 vet.

21 Mu më erdh keq që nuk u respektu urdhri i z. Thaçi aty,
22 shumë e ndiva veten keq, por unë dhe veprova sipas etikës sime
23 profesionale.

24 PY. Këtë incident juve e përshkruani edhe në librin tuaj, në
25 provën materiale për procesverbal P01264, duke filluar në

1 SPOE00128650.

2 I keni thënë ZPS-së që si rezultat i këtij incidenti, ju
3 krijua përshtypja se si komandantët lokalë i përgjigjeshin
4 urdhrave nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Këtë e keni thënë në Shënimin
6 Përgatitor numër 2, në paragrafin 16.

7 PY. A mund të na e shpjegoni pak më tepër, Dëshmitar, se
8 çfarë përshtypje krijuat ju?

9 PË. Unë krijova përshtypjen se nuk ka hierarki në Ushtrinë
10 Çlirimtare të Kosovës, nuk respektohen urdhrat e njerëzve
11 kompetentë që ishin caktuar për informim, konkretisht. Çdo
12 fshat e kishte komandantin e batalionit e të njësisë së UÇK-së
13 dhe ai ishte përgjegjës për gjithçka. Domethënë, nuk vlenin
14 shumë urdhrat e Shtabit të Përgjithshëm.

15 Ashtu ndodhi edhe në Zatriq të Rahovecit. Kur shkova aty,
16 ishte komandanti i fshatit Idriz Vehapi dhe ai më urdhëroi që
17 kameramani im, Abaz Rekaç të mos xhirojë asnjë sekondë. Z.
18 Thaçi ishte i pranishëm aty, po ashtu më erdhi keq më erdhi
19 keq që nuk u respektu urdhri i z. Thaçi për të xhiruar dhe ne
20 u kthyem pa bërë asnjë sekondë xhirim.

21 PY. Dëshmitar, përsëri përkthyesit kërkojnë që të flisni pak
22 më ngadalë nëse është e mundur, sepse flisni shumë shpejt dhe
23 është e vështirë që t'ju ndjekin.

24 PË. Kërkoj falje, do të përpigem të flas më ngadalë.

25 PY. Dëshmitar, ju përshkruani një tjetër incident në librin

1 tuaj ku nuk jeni lejuar fillimisht që të bëni xhirime në
2 Zatriq. A ju kujtohet ky incident?

3 PË. Po, si thashë edhe më herët, në Zatriq shkuam bashkë me
4 z. Thaçi dhe me Shaban Shalën dhe urdhërova kameramanin tim,
5 se unë isha përgjegjës për ekipin televiziv, që të xhirojë
6 disa imazhe nga Rahoveci, fshatrat e Anadrenisë, ishte një
7 pozitë shumë e mirë për xhirime të tilla, por komandanti lokal
8 i UÇK-së i fshatit Zadriq, profesor Idriz Vehapi, urdhëroi që
9 të mos xhirohej asnjë sekondë. Kjo është e vërteta, dhe kam
10 përmendur edhe në librin tim, dhe me të vërtetë isha në pozitë
11 shumë të vështirë që kisha kaluar nëpër shumë punkte të
12 policisë serbe për të depërtuar në zonë të luftës, dhe kisha
13 pengesa që të kryeja me sukses misionin tim si gazetar.

14 PY. Pra a është e saktë që Idriz Herapi [Sipas përkthimit]
15 nuk të ka lejuar që të bëni xhirime, pavarësisht faktit që ti
16 ishe bashkë me Hashim Thaçin aty?

17 PË. Po, është e vërtetë. Shumë e vërtetë.

18 PY. Kur ka ndodhur kjo, Dëshmitar?

19 PË. Ka qenë qershor i vitit 1998.

20 PY. Një tjetër ngjarje që ka ndodhur është intervista që keni
21 bërë me Naim Malokun në tetor të vitit 1998. A ju kujtohet
22 kjo, Dëshmitar?

23 PË. Po, shumë mirë më kujtohet. E kam realizuar këtë
24 intervistë me eprorin e UÇK-së Naim Malokun në tetor të vitit
25 1998, në fshatin Lladrovç të Malishevës.

- 1 PY. Ju vendosët që ta intervistonit Naim Malokun sepse
2 mendonit ose e konsideronit atë si oficer të mirë apo jo?
- 3 PË. Ashtu e kam vlerësu dhe ashtu ka qenë.
- 4 PY. Vendimin për ta intervistuar atë e keni marrë vetë ju?
- 5 PË. Vetë -- vetëm unë i kam marrë vendimet. Askënd s'e kam
6 pyet.
- 7 PY. Çfarë roli kishte Naim Maloku në atë kohë, nëse e dinit,
8 kuptohet.
- 9 PË. Nuk e di saktë por ka qenë një nga eprorët e Ushtrisë
10 Çlirimtare të Kosovës, ka qenë në Shtabin Operativ. Çfarë
11 detyre saktë, nuk e di. Se nuk më ka interesuar, por kam pasur
12 vlerësime pozitive se është intelektual i ngritur, dhe një
13 epror që ka qenë shumë aktiv në të gjitha zonat e luftës.
- 14 PY. Ju nuk është se kërkuar leje, ose nuk është se i treguat
15 askujt nga Shtabi i Përgjithshëm se do shkonit dhe do
16 intervistonit Naim Malokun. Kështu është, Dëshmitar?
- 17 PË. Jo, nuk i kërkoja leje. E takova rastësisht, se ishte
18 luftë. E takova rastësisht në fshatin Lladrovç të Malishevës
19 dhe e luta për një intervistë. Bile e ndava në një dhomë
20 tjetër, që ta realizoja një intervistë për gazetën -- revistën
21 javore *Zëri*.
- 22 PY. Kur Hashim Thaçi e mori vesh që e kishit intervistuar
23 Naim Malokun, ai të tha që duhej të ishte konsultuar, apo jo?
24 Përpara se sa ta intervistonit atë? Ka ndodhur kështu apo jo,
25 Dëshmitar?

1 PË. Po, ashtu ka qenë. Ashtu ka ndodhur, ashtu më tha z.
2 Thaçi. Sigurisht ka menduar që për [E pakuptueshme] të
3 qëndrimit që -- për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës të flasë
4 vetëm zëdhënësi UÇK-së, z. Jakup Krasniqi. Unë e theva këtë
5 urdhër, duke vlerësuar se është në interes të opinionit që të
6 botohen edhe intervista edhe me eprorë të tjerë të UÇK-së,
7 sepse kishte nevojë që edhe të tjerët të dilnin të prezantonin
8 luftën heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

9 PY. A është e saktë të thuhet se pavarësisht rezistencës së
10 ose mospëlqimit të z. Thaçi, ju pavarësisht kësaj, e botuat
11 intervistën e bërë?

12 PË. Po, e botova revistën dhe konsideroj se kam bërë mirë që
13 e kam botuar. Unë isha gazetar i pavarur dhe nuk ishte
14 korrekte që të merrja urdhra nga askush.

15 PY. A keni vuajtur ndonjë pasojë, a keni pasur ndonjë pasojë
16 nga Shtabi i Përgjithshëm që e keni kryer dhe keni botuar
17 intervistën pa marrë leje paraprakisht?

18 PË. Jo, nuk kam pas pasojë. Kur jam takuar pas botimit të
19 intervistës në zonën e Llapit, z. Thaçi më tha "kishe botuar
20 intervistën", tha. "Po, e kam botuar". Edhe vetëm qeshi dhe
21 vazhdoi rrugën e vet që kishte me kolegët e vet.

22 PY. Në rregull. Sa i takon mbulimit të zhvillimeve në zonën
23 operative të Llapit në tetor të vitit 1998, a ju kujtohet hera
24 e parë që keni shkuar për të bërë xhirime në zonën e Llapit,
25 Dëshmitar?

1 PË. Po, shumë mirë më kujtohet. Isha në redaksinë e revistës
2 Zëri, duke dorëzuar një shkrim që e botoja herë pas here. Dhe
3 aty takova Fehmi Bakiun, i cili është pjesë e zyrës së
4 përfaqësuesit të përgjithshëm politik të Ushtrisë Çlirimtare
5 të Kosovës, z. Adem Demaçin në Prishtinë dhe më tha, "Nuhi,
6 tha, Baca Adem të ka kërkuar që mundësisht të shkosh edhe në
7 zonën operative të Llapit për të bërë imazhet e duhura për
8 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës", sepse nuk kisha qenë
9 asnjëherë në zonën operative të Llapit dhe e vlerësova se
10 është ide e mirë, dhe t'i thashë z. Demaçit që të ma sigurojë
11 vozitësin. Ai ma dha vozitësin e tij, Shasivarin, dhe bashkë
12 me kameramanin Abaz Zeka, kemi shkuar në tetor të vitit 1998
13 edhe në zonën operative të Llapit.

14 PY. Në rregull. Pra, Adem Demaçi ishte personi që të kërkoi
15 që të shkonit në zonën operative të Llapit për të bërë ca
16 intervista. Kështu, Dëshmitar?

17 PË. Po, z. Demaçi kërkoi dhe kërkesa e tij ishte shumë e
18 arsyeshme. M'i krijoji kushtet për të shkruar për të xhiruar
19 dhe shkova dhe mbarova detyrën time ashtu siç duhet.

20 PY. Ai ishte personi që bëri koordinimin për ty në mënyrë që
21 të kishe mundësi që të shkonit në zonën e Llapit. Kështu?

22 PË. Z. Demaçi koordinoi shkuarjen time dhe të Abazit në zonën
23 e Llapit.

24 PY. Në rregull. Si e keni kuptuar ju rolin e Adem Demaçit në
25 atë kohë?

1 PË. Po roli i Adem Demaçit ishte shumë i rëndësishëm për --
2 jo vetëm për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, por mbarë
3 opinionin e Kosovës sepse ishte një figurë, një simbol i
4 rezistencës për liri dhe pavarësi, dhe bëri mirë që Ushtria
5 Çlirimtare e Kosovës e caktoi përfaqësues të përgjithshëm
6 politik me seli në Prishtinë. Veprimi i tij në qendër të
7 Prishtinës ishte shumë i rëndësishëm, sepse kishte takime me
8 diplomatë evro-perëndimorë, dhe afirmonte luftën e drejtë të
9 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Z. Demaçi kishte detyrë që të
10 formonte institucionet e Kosovës, dhe me ato rrethana të bënte
11 një lloj asambleje të Kosovës, ku do të përfshiheshin të
12 gjitha subjektet politike dhe ushtarake të Kosovës. Por siç
13 dihet, nuk ka arritur ta kryejë me sukses këtë mision, si
14 thashë edhe më herët në dëshminë time, për shkak se një pjesë
15 e faktorit politik shqiptar nuk ishte në nivel të detyrës, në
16 nivel të përgjegjësisë që kishte, dhe krijonte dilema në
17 opinion për zhvillimet në zonat e luftës dhe për zhvillimet në
18 përgjithësi.

19 PY. Si e keni kuptuar rolin e z. Thaçi në atë kohë? Çfarë
20 roli mendoni ju që ka pasur z. Thaçi duke filluar në qershor
21 dhe duke vazhduar deri nga fundi i vitit. Ose më mirë të
22 fillojmë nga maji, nga maji deri në nëntor.

23 PË. Roli kryesor i z. Thaçi ka qenë, sa e kam kuptue unë, për
24 informim. [E pakuptueshme] kam bashkëpunu drejt -- ngushtë
25 shumë me z. Thaçi për të gjitha punët që kam kryer si gazetar

1 në zonat e luftës. Ai ka qenë përgjegjës për informim. Nuk e
2 di që është marrë me çështjet e tjera. Sipas informacioneve të
3 mia, ai është marrë vetëm me informim deri vonë, pastaj kur
4 është zgjedhur përfaqësues politik i UÇK-së.

5 PY. Në rregull. A e keni parë ndonjëherë me sytë tuaj z.

6 Thaçi që të jepte urdhra ushtarake UÇK-së?

7 PË. Jo, asnjëherë.

8 PY. Tani do flasim për një tjetër temë. A ju kujtohet në
9 shtator të vitit 1998 që keni pasur një diskutim me Hashim
10 Thaçin në praninë e Jakup Krasniqit dhe Bislum Zyrapit?

11 Domethënë, një diskutim të pakëndshëm. A ju kujtohet kjo,
12 Dëshmitar?

13 PË. Po, shumë mirë më kujtohet ky diskutim i pakëndshëm. Pas
14 xhirimit që bëra në zonën e Drenicës, kryesisht në zonën e
15 Drenicës, përgjithshëm djegiet, për vrasjet, për masakrat që
16 kishin ndodhur në zonën e Drenicës po dhe në zona të tjera nga
17 ana e policisë dhe ushtrisë serbe, i bëmë bashkë me Abaz Zekën
18 dhe ato imazhe që ishin të tmerrshme dhe e informova z. Thaçin
19 që i kam bërë këto xhirime. Z. Thaçi insistoi që në fund të
20 dokumentarit të shënohet "Emisionin e mbështeti Drejtoria për
21 Informim e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës". Unë i thashë "nuk
22 i bën nder Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që të dalë titra aty
23 që "E mbështeti" kur emisioni ka imazhe për djegie dhe vrasje,
24 për masakrat ku Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk e kishte
25 arritur të bënte rezistencën e duhur forcave ushtarake dhe

1 policore serbe, të cilat ishin shumëfish më të mëdha,
2 shumëfish më të pajisur me armatim, dhe thashë, "Unë e
3 vlerësova që nuk duhet t'i bënte nder UÇK-së të dilte 'e
4 mbështeti emisionin' ku ishin ato imazhe të tmerrshme".
5 PY. Si u zgjidh ajo situatë? A patët epërsi juve? Domethënë,
6 fituat ju në fund? Si u zgjidh situata?
7 PË. Nuk ishte puna këtu kush fiton e kush humb, por unë e
8 mbroja atë etikën time profesionale. Insistoj që të mos të
9 shënohet ashtu. Unë e konsultova. Jam shumë njeri i arsyeshëm,
10 tolerant dhe konsultova me z. Krasniqi, i cili ishte njeri më
11 i moshuar edhe më këshilloi. Tha, "Nuhi", tha, "është mirë,
12 tha, që ta respektosh, tha, sugjerimin e z. Thaçi. Edhe unë,
13 tha, po të sugjeroj, tha, që ta qes titrën ashtu si e
14 mbështeti drejtorja për informim e UÇK-së". Dhe unë në interes
15 të informimit që të vazhdoja bashkëpunimin si gazetar në zonat
16 e luftës, sepse pa përkrahjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
17 dhe të popullit nuk do të kisha mundur ta realizoja detyrën
18 time, dhe e vlerësova se duhet të lëshoj pe, dhe mos të bëhem
19 kryeneç, në interes të informimit, ta qes edhe atë titër në
20 fund të dokumentarit. Dhe ashtu veprova.

21 Dhe kështu nuk pat -- nuk zgjati shumë kjo, ky diskutim i
22 pakëndshëm.

23 PY. Tani le të flasim për rastin kur jeni prezantuar për herë
24 të parë me Hashim Thaçin. Për herë të parë me Hashim Thaçin
25 jeni prezantuar nga maji i vitit 1999?

1 PË. Po.

2 PY. Kontakti i parë në këtë periudhë ka qenë, Dëshmitar?

3 PË. Po, ka qenë në fund të majit të vitit 1999. Ashtu sa e di
4 unë.

5 PY. Në vitin 1998 --

6 PË. Në 1998, po.

7 PY. Në vitin 1998. A është e vërtetë që për herë të parë e
8 keni takuar në shtëpinë e Isuf Gashit, të Bacës?

9 PË. Po, është e vërtetë se e kam takuar për herë të parë z.
10 Thaçi në shtëpinë e dhëndrit të familjes sime, Isuf Gashi, të
11 Bacës.

12 PY. Si ndodhi? Ju kujtohet, si e bëri të mundur ai që të
13 takoheshit ju me z. Thaçi?

14 PË. Po, unë shkova bashkë me nipin, djalin e Bacës, Flurimin,
15 se ishte anëtari i Zërit, dhe duke ditur se Baca ishte i
16 angazhuar në mënyrë aktive në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës,
17 Flurimi më sugjeroi që është mirë të vish atje dhe takohem me
18 njerëzit kompetentë për informim. Dhe ashtu ndodhi, nuk vonoi
19 shumë dhe u takova me z. Thaçi dhe biseduam.

20 Paraqita idenë time që të jem në shërbim të informimit të
21 opinionit për zhvillimet në zonat e luftës dhe z. Thaçi e
22 mbështeti idenë time dhe u morëm vesh që pas disa dite, pasi
23 të vendosë për caktimin e zëdhënësit të Ushtrisë Çlirimtare të
24 Kosovës, z. Krasniqi si zëdhënës, unë dhe Abazi ta xhirojmë
25 paraqitjen e tij të parë publike.

1 PY. I keni thënë ZPS-së se familja juaj ka lidhje me Hashim
2 Thaçin përmes Isuf Gashit. Na e shpjegoni, çfarë lidhje është
3 kjo?

4 PË. Po, si thashë, Isuf Gashi është dhëndër i familjes sime.
5 Bashkëshortja e z. Isuf Gashi ka qenë vajza e xhaxhait tim.
6 Lidhjet i kam pas me Isuf Gashin. Kurse Isuf Gashi ka pas fam
7 -- lidhjet me z. Thaçi. Dhe kështu u kriju besimi. Domethënë,
8 atëherë a dasht me pas besim. Edhe UÇK-ja edhe për gazetarët,
9 edhe për njerëzit e tjerë që kanë vepruar në zonat e luftës,
10 të kenë besim në njerëz të besueshëm që ta kryenin detyrën me
11 besim, me besnikëri dhe me dinjitet.

12 PY. Kur u takuat me z. Thaçi, a të tha z. Thaçi çfarë
13 funksioni kishte në UÇK, për çfarë ishte përgjegjës?

14 PË. Nuk më tha. Tha për informim, për gaz -- me gazetarët. Me
15 mua [E pakuptueshme] me u marr vesh, nuk më tha as nuk i
16 kërkova as emrin, as mbiemrin, as pozitën. Nuk ja kam kërkova
17 unë, se kohë e vështirë. Në atë periudhë ishte e
18 paimagjinueshme që ta pyesësh dikë si e ke emrin, pe nga je,
19 çfarë detyre ke në UÇK. Veç ishin pyetje pa lidhje.

20 PY. Po, a ju tha ai ju që ishte përgjegjës për informimin dhe
21 merrej me gazetarët?

22 PË. Ashtu, ashtu më tha. Kështu e kuptova edhe unë rolin e
23 tij.

24 PY. Pas këtij kontakti, ju thatë që z. Thaçi ju ka kontaktuar
25 ju për paraqitjen e parë publike të zëdhënësit të UÇK-së.

1 Kështu?

2 PË. Po. Ka -- më ka kontaktuar z. Thaçi me telefon pas disa
3 ditësh. Domethënë, me 10, kah data 10, 11 qershor të vitit
4 1998.

5 PY. Kjo ka qenë rreth tetë a dhjetë ditë pasi e kishit takuar
6 për herë të parë z. Thaçi, kështu?

7 PË. Ashtu i bie. Si -- ashtu i bie afërsisht.

8 PY. Më jepni një çast, ju lutem.

9 Dëshmitar, do t'ju pyes për intervistën me Bislim
10 Zyrapin. Në gusht të vitit 1998 keni intervistuar edhe Bislim
11 Zyrapin, kështu?

12 PË. Po, gusht të vitit -- gjysmën e dytë të gushtit të vitit
13 1998 e kam intervistuar z. Bislim Zyrapin në Likovc të
14 Drenicës.

15 PY. Ka qenë një takim i planifikuar paraprakisht, apo ka qenë
16 rastësor?

17 PË. Jo, ka qenë takim i rastësishëm. Unë u ktheva nga zona
18 operative e Dukagjinit, pas rënies së Llozhanit, pas ofensivës
19 në Dukagjin ku mora disa imazhe. Atje dy ditë kam qenë. U
20 ktheva në Drenicë dhe aty takova rastësisht z. Zyrapin.

21 PY. Dhe më pas intervistuat z. Zyrapin, kështu?

22 PË. Po. E vlerësova se do ishte me interes të -- të
23 intervistohet z. Zyrapin sepse në gusht të vitit 1998 ishte një
24 ofensivë e tmerrshme e forcave ushtarake dhe policore serbe në
25 të gjitha zonat ku vepronte Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe

1 kishte edhe civilë të vrarë, kishte edhe shtëpi të djegura,
2 dhe shkolla, dhe ambulanca, dhe objekte të tjera.

3 PY. Po përveç lejes së vet z. Zyrapi, të duhej leje nga
4 ndonjë person tjetër për ta intervistuar?

5 PË. Z. Zyrapi ishte epror i lartë shtabit operativ,
6 udhëheqësi i shtabit operativ. Vlerësova se nuk ka nevojë të
7 marr leje të posaçme nga askush tjetër.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, duhet të
9 kalojmë në seancë private për pyetjet e radhës.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
11 seancë private për të mbrojtur dëshmitarin.

12 [Seancë private]

13 [Seancë private teksti i fshirë]

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Nuhi Bytyqi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 92

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.
2 Misetiç.

3 Z. MISETIC: [Përkthim]

4 PY. Dëshmitar, flasim për lirimin e disa gazetarëve, në
5 thonjëza, serbë më 27 nëntor të vitit 1998. A keni qenë i
6 pranishëm në lirimin e dy gazetarëve serbë dhe dy veprimtarëve
7 shqiptarë në Dragobil, më 27 nëntor të vitit 1998?

8 PË. Po, më 27 nëntor të vitit 1998 kam qenë dhe kam ndjekur
9 lirimin e dy gazetarëve serbë dhe dy veprimtarëve politikë
10 shqiptarë në Dragobil të Malishevës.

11 PY. Si u informuat ju që do të liroheshin këta persona?

12 PË. Saktësisht nuk e di. S'e di as se si e kam shkru në
13 librin tim, por e di se me rastin e 28 nëntorit, festës sonë
14 kombëtare, ishte marrë vendim që në bashkëpunim me KDOM-in
15 amerikan dhe me shefin e misionit të vëzhgueseve të OSBE-së në
16 Kosovë, zotin, ambasadorin William Walker, që të lirohen dy
17 gazetarë serbë dhe dy veprimtarë politikë shqiptarë. Shkuam
18 bashkë me kolegët e tjerë. Ka pas -- të gjitha mediave, edhe
19 shqiptarë, edhe ndërkombëtarë. Shkuam në Dragobil nga
20 Prishtina dhe e përcollëm këtë ngjarje.

21 PY. Dëshmitar, do të shohim çfarë i keni thënë ZPS-së. Për
22 këtë dua të shohim provën materiale P01252.1, faqja 62,
23 rreshtat 10 deri në 13 në anglisht. Të shohim nëse ju ndihmon
24 kjo kujtesë. Ju ka bërë pyetje Prokuroria:

25 "A jeni i informuar ditën e lirimit se kush do të lirohej

1 dhe kush do t'i lironte?"

2 Ju jeni përgjigjur:

3 "Na ka informuar zyra e Adem Demaçit, dhe atje kanë qenë
4 të pranishëm të gjithë gazetarët."

5 Ju kujtohet?

6 PË. Po. E tash po më ku -- e riktheva kujtesën. Ashtu është.
7 Zyra e Adem Demaçit na ka informu. Nj'ashtu. Se unë isha në
8 Prishtinë në atë kohë, dhe e mora vesh dhe shkuam bashkë me
9 kolegët nga Prishtina. Kemi shku me një taksì.

10 PY. A ju kontaktuan ju paraprakisht nga Shtabi i Përgjithshëm
11 që do të ndodhnin këto lirime? Ju kontaktoi dikush
12 paraprakisht për lirim?

13 PË. Nuk më kujtohet. Singerisht, s'më kujtohet, por e morëm
14 informacionin nga zyra e Demaçit. Bashkëpunojta edhe me Muhamet
15 Mavrajn, që ishte kryeredaktori i gazetës Bota e Re, dhe
16 bashkë me Muhametin kemi shkuar në Dragobil, më 27 nëntor të
17 vitit 1998.

18 PY. A pe ndonjë anëtar të Shtabit të Përgjithshëm të
19 pranishëm fizikisht në momentin e lirit?

20 PË. Po, nga Shtabi i Përgjithshëm ishte Sokol Bashota, i cili
21 në emër të Shtabit të Përgjithshëm, bashkë me ambasadorin
22 Walker, i liroi gazetarët serbë dhe dy veprimtarët politikë.
23 Aty ishin, si thashë edhe përfaqësuesit e tjerë të mediave që
24 vepronin në Kosovë.

25 PY. A more ndonjë informacion atë ditë pse këta "gazetarë"

1 serbë ishin mbajtur të ndaluar?

2 PË. Nuk kishim ndonjë informacion zyrtar me shkrim, po
3 kuptova se ata kishin tejkaluar kompetencat e tyre si gazetarë
4 dhe ishin hasur në zonat e luftës pa lejen e UÇK-së dhe,
5 domethënë i kishin tejkaluar kompetencat e tyre si gazetarë.

6 Se gazetarët i kanë kompetencat vetëm me informu, jo me
7 ba për -- incizime, ose me marr shënime të tjera që nuk janë
8 në harmoni me detyrën e tyre.

9 PY. Ju kujtohet prej kujt i keni marrë këto informacione
10 lidhur me arsyet e ndalimit të gazetarëve?

11 PË. Prej luftëtarëve të UÇK-së.

12 PY. Ju kujtohet për cilët --

13 PË. Jo --

14 PY. -- bëhet fjalë?

15 PË. [E padëgjueshme]

16 PY. Në rregull. A pate mundësi të flisje me dy veprimtarët
17 shqiptarë ditën e lirimit?

18 PË. Po, kur u liruan dy veprimtarët shqiptarë. A mund t'ua
19 përmend emrat?

20 PY. Po.

21 PË. Jakup Kastrati dhe Cen Desku. Aty ishte i pranishëm edhe
22 shefi i misionit amerikan Shaun Byrnes, me rastin e lirimit,
23 dhe i them kameramanit Abaz Zeka që të xhirojë në atë moment.
24 Aty ishte një deklaratë e z. Desku, se ishte një keqkuptim.
25 UÇK-ja dhe LDK-ja kanë të njëjtin qëllim dhe çdo është -- ka

1 qenë në rregull. Çdo gjë do të shkojnë në rregull. Qëllimi
2 jonë i njëjtë, i përbashkët. Ishte keqkuptim i vogël. Çdo gjë
3 është në rregull. Bile ju uroj festën kombëtare luftëtarëve të
4 UÇK-së që ishin në momentin e lirimit. Urime festa, dita e
5 flamurit.

6 Dhe kështu ka qenë, një deklaratë shumë spontane e z.
7 Desku për këtë që çësht -- për këtë çështje.

8 PY. Në rregull.

9 PË. Çfarë përshtypje t'u krijua për gjendjen e tyre fizike
10 pas lirimit?

11 PY. Gjendja e tyre fizike ishte shumë në rregull. Nuk vërejta
12 kurrgjë si diçka -- kanë pas ndonjë maltrajtim a diçka. Asgjë
13 nuk vërehej. Disponimi ishte në nivel, edhe ashtu fitova
14 përshtypjen dhe ashtu ishte.

15 PY. Po gjendja fizike e dy "gazetarëve" serbë?

16 PË. Edhe gjendja e tyre fizike ishte e mirë. Ata dhanë
17 deklaratë të shkurtra, se në rregull ka qenë. Është bërë mirë
18 që na kanë liruar, dhe ashtu. Nuk kam vërejtur diçka të keqe
19 me ta.

20 PY. Dëshmitar, do t'ju bëj disa pyetje për disa pyetje për
21 LDK-në tani. Në librin tuaj --

22 Z. MISETIC: [Përkthim] -- dhe mund ta shohim edhe në
23 ekran. Është prova materiale P01264, faqja SPOE00128600,
24 anglishtja, dhe në shqip.

25 PY. Dëshmitar, paragrafi i parë thotë kështu:

1 "Deri sa në Drenicë dhe Dukagjin u bëhej rezistencë
2 forcave ushtarake dhe policore serbe, në Prishtinë diplomatët
3 amerikanë dhe evropianë vinin për të biseduar me kryetarin e
4 Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ibrahim Rugovën. Në të njëjtën
5 ditë, kur Rugova u takua me diplomatët amerikanë, Richard
6 Holbrook dhe Robert Gelbardt, Rugova kishte deklaruar se "...
7 ne nuk e dimë kush janë këta që po luftojnë". Dhe, "ata janë
8 dorë e zgjatur e Serbisë". Ndërkaq, diplomati amerikan
9 Gelbardt kishte deklaruar se "UÇK-ja mund të përfshihej në
10 listën e organizatave terroriste. Në anën tjetër Serbia
11 dëshironte ta tregonte forcën. Thjesht s'ishte e gatshme të
12 bisedonte me shqiptarët për të ardhmen e Kosovës".

13 Dua të sqarojmë diçka në këtë paragraf. Kur keni cituar
14 dikë që ka thënë -- ky personi që ka thënë "nuk e dimë kush
15 janë këta që po luftojnë", fjalët e kujt keni cituar ju këtu?
16 PË. Këto janë fjalët e Ibrahim Rugovës.

17 PY. Po ky citimi që thotë "ata janë dorë e zgjatur e
18 Serbisë", fjalët e kujt janë këto?

19 PË. Të Rugovës.

20 PY. Sipas teje, ose të paktën si e k -- jo, do ta bëj pyetjen
21 kështu. I ke dëgjuar me veshët e tu që e ka thënë këtë?

22 PË. Po i ka thënë disa herë në konferencat me gazetarët që i
23 ka mbajtur me gazetarë që i ka mbajtur në Prishtinë çdo të
24 premtë. Këto janë publike. Unë intervistë nuk kam bërë por
25 është, është -- disa herë kur kam pyetur gazetarët, e ashtu

1 përafërsisht është shprehur.

2 Unë e thashë edhe më herët. Lidershipi politik i
3 Prishtinës nuk ka qenë në nivel të përgjegjësisë që kishte ato
4 rrethana të luftës. Nuk e kishte guximin, por ishte shumë
5 oportunist. Paraqitej se s'po ndodhte asgjë në zonat e luftës,
6 edhe pse atje zhvillohej luftë për liri. Edhe mungonte
7 gatishmëria për ta mbështetur në të gjitha mënyrat Ushtrinë
8 Çlirimtare të Kosovës, për ta ndër -- mbështetur popullatën
9 civile, për të -- për ta mbështetur luftën për liri.

10 Për shkak të këtij oportunitizmi dhe ndodhën shumë
11 zhvillime jo të mira në zonat e luftës. Sepse po të kishte
12 Kosova një Franjo Tugjman, si e kishte Kroacia dhe si - po të
13 kishte Kosova një Alija Izetbegovic si e kishte Bosnja, që
14 udhëhiqnin luftën e popullit të tyre për liri, po ta kishte
15 edhe Kosova dhe Rugova në krye të rezistencës për liri,
16 situata në zonat e luftës, në përgjithësi në Kosovë do të
17 ishte më shumë më e volitshme. Populli do të bashkohej më
18 shumë rreth UÇK-së dhe lufta do të kishte më pak pasoja. Kjo
19 është esenca e kësaj.

20 PY. Dua që të jem i qartë. Kjo fjalia që thotë "ata janë dorë
21 e zgjatur e Serbisë", ai për cilët e kishte fjalën? Kush ishin
22 këta "ata"?

23 PË. Po, për UÇK-në, kuptohet.

24 PY. A ke parë ndonjë reagim prej UÇK-së për këto deklaratat?
25 Vetë personalisht, ke parë ndonjë kundërpërgjigje?

1 PË. Në ato rrethana nuk kam qenë në gjendje që të kem ndonjë
2 -- të shoh ndonjë reagim publik, sepse kam qenë, qarkulluar me
3 ditë të tëra në zonat e luftës, dhe nuk kam pas kohë as të
4 përcjell mediat. Por e di se në radhët e UÇK-së nuk ka pasur
5 urrejtje ndaj Lidhjes Demokratike të Kosovës, as Rugovës, as
6 ndaj askujt, por vërejtjet kanë qenë që duhet që Rugova dhe
7 faktori politik shqiptar të unifikohet dhe të bëjë apel te
8 populli që ta mbështesë më fuqishëm Ushtrinë Çlirimtare të
9 Kosovës. Këtu ka qenë esenca. Mos të keqkuptohet as këtu në
10 këtë Gjykatë, as në opinion, se UÇK-ja ka qenë kundra LDK-së
11 ose partive politike. Se nuk ka qenë periudha për të luftuar
12 për pozitë, a për karrige a po, për ta çliru Kosovën.

13 PY. Aty ku thotë ai "nuk e dimë kush janë këta që po
14 luftojnë". Domethënë, sipas teje, ai nuk e njihte ekzistencën
15 e një organizate? Edhe thoshte dhe prandaj tha që "ne nuk e
16 dimë kush janë këta"?

17 PË. Po ashtu, ai ishte oportunist. Ai kishte program i cili
18 mendonte se Kosova mund të çlirohet pa luftë, me mjete
19 paqësore, me konferenca për shtyp, me apele për paqe. Por
20 Serbia, eh --

21 PY. Në rregull.

22 PË. -- nuk i merrte parasysh ato.

23 PY. Po, më konkretisht e kam pyetjen. Domethënë, si duhet ta
24 kuptojmë ne këtë kur thotë ai "ne nuk e dimë kush janë këta që
25 po luftojnë". Domethënë, sipas teje, ai nuk e pranonte që

1 ekzistonte UÇK-ja? Kështu e ke kuptuar?

2 PË. Ashtu e kam kuptuar. Po në një farë mënyre e pranonte por
3 nuk e mbështeste si duhet, si lideri i popullit shqiptar, si
4 lider politik, si ishte. Kishte një përkrahje të madhe në
5 popull e populli për atë kishte hezitime, a të luftonte, apo
6 të prisnin urdhrin e Rugovës. Rugova nuk jepte urdhër për
7 luftë.

8 PY. Do të shohim edhe një dokument, para se të bëjmë pushimin
9 e drekës.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, të vendoset në ekran
11 materiali me numër DHT231 - më falni 03972.

12 PY. Dëshmitar, ky është një artikull i *New Your Times*, i
13 datës 14 gusht i vitit 1998. Dhe përshkruan formimin që ka
14 bërë Ibrahim Rugova në mes të gushtit të vitit 1998, pra ka
15 formuar një delegacioni, i cili nën ombrellën ndërkombëtare do
16 të negocionte me Serbinë për t'i dhënë fund konfliktit. A ju
17 kujtohet të ketë ndodhur në verën e vitit 1998, të ketë qenë
18 problem në verën e vitit 1998, se kush do të fliste në emër të
19 shqiptarëve në këto negociata me Serbinë?

20 PË. Po, ka pas përpjekje që të bëhet një ekip i unitetit,
21 edhe aty ishin të barabartë të merrnin pjesë vetëm
22 përfaqësuesit e partive politike shqiptare që vepronin në atë
23 periudhë në Kosovë, por ishte përjashtua faktori ushtarak dhe
24 politik i UÇK-së.

25 PY. Po, pra z. Rugova gjatë verës vijonte ta mbante të

1 përjashtuar UÇK-në dhe nuk e bënte pjesë zyrtare se -- apo si
2 një përfaqësim zyrtar të shqiptarëve të Kosovës. Kështu?
3 PË. Po, ashtu është. Nuk e bënte. Ashtu është.

4 PY. Nëse lexojmë paragrafin e tretë, e keni edhe në shqip në
5 ekran, çfarë kanë propozuar ndërkombëtarët në verën dhe
6 vjeshtën e vitit 1998. Thuhet:

7 "Ndoshta edhe më shkatërrues për strategjinë diplomatike
8 perëndimore, dimë si kryesori i z. Rugova parashikoj se ekipi
9 negociator do të dyshonte, pa dyshim, sepse qeveritë
10 perëndimore këmbëngulnin se nuk mund të negociojmë pavarësinë
11 e Kosovës, gjë që e kërkojnë pothuajse të gjithë shqiptarët
12 etnikë."

13 Pyetja e parë: A është e vërtetë që në verën e vitit
14 1998, me sa keni ju dijeni, kuptohet, me sa mund -- me sa keni
15 vënë ju re, a është e vërtetë që gjithë shqiptarët etnikë
16 donin pavarësinë e Kosovës, pothuajse të gjithë shqiptarët
17 etnikë?

18 PË. Po, po, ky ishte përcaktim i gjithë popullit shqiptar të
19 Kosovës për pavarësi. Ishte vullneti i gjithë shqiptarëve të
20 Kosovës për pavarësi.

21 PY. Në atë kohë, ju kishit ndonjë dijeni që në verën dhe
22 vjeshtën e vitit 1998 komuniteti ndërkombëtar këmbëngulte dhe
23 thoshte që e vetmja gjë që mund të negociojmë për shqiptarët e
24 Kosovës është autonomi brenda Republikës së ish-Jugosllavisë?

25 PË. Po, ashtu ishte. Ashtu ishte. Faktori ndërkombëtar dhe

1 Serbia mendonin që duhet të japin disa të drejta shqiptarëve
2 dhe t'i jepnin lloj autonomia, jo pavarësi.

3 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kërkoj të
5 pranohet ky dokument, përpara se të bëjmë pushimin.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime?

7 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti me
9 numër DHT03972 pranohet, dhe do të klasifikohet si publik.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, klasifikimin publik
11 e ka, po desha t'ju pyes, vetëm këtë faqe apo të dyja faqet
12 doni që të pranohen?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, vetëm kjo faqe mjafton.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Materiali me DHT03972
15 bashkë me përkthimin në gjuhën shqipe, merr numrin e provës
16 materiale 1D00158. Faleminderit.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, shoh orën

18 --

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
20 tani kemi pushimin e drekës. Pushimi zgjat një orë e gjysmë,
21 njësoj si dje. Do të rikthehemi në sallë në orën 14.30 që të
22 vijojmë me dëshminë tuaj.

23 Tani mund të dilni nga salla e gjyqit.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Për qëllime planifikimi, mund t'ju

1 them që do të respektoj orarin që kisha thënë më përpara.

2 Rreth 2 orë. Do të kem edhe një gjysmë ore nga ana ime dhe do
3 të përfundoj.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
5 shumë mirë.

6 Rikthehemi në orën 14.30.

7 --- Pushimi fillon në orën 13.02

8 --- Seanca rifillon në orën 14.30

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara sesa
10 të fillojmë, do pranojmë provat që kanë një numër, që kanë
11 marrë një provë materiale të përkohshme me numrat përkatës
12 P01274, 1275, edhe 1276. Janë artikujt e lajmeve që janë
13 artikuj autentikë. Janë relevantë dhe kanë vlerë provuese, të
14 paktën për çështjen që na ka njoftuar Prokuroria. Pra, janë
15 informuese sa i takon Shtabit të Përgjithshëm dhe lidhen me
16 ndalimin dhe keqtrajtimin e paligjshëm. Nuk është se lidhen me
17 vërtetësinë e fakteve që parashtrohen në të, por vetëm
18 thjeshtë për qëllime informimi.

19 Po ashtu do të pranojmë provën që ka marrë numrin e
20 përkohshëm të provës materiale P01283, që është fotografi e z.
21 Jashari dhe ka vlerë provuese.

22 Mund të vazhdojmë tani me dëshmitarin.

23 Znj. Asistente, mund ta sillni në sallë dëshmitarin.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam një
25 pyetje lidhur me materialin që është mohuar. Neve parashtrojmë

1 që fotografia ka vlerë të pavarur për sa i takon origjinës së
2 saj dhe është një fotografi e cila identifikon një komandant
3 të policisë ushtarake dhe do të donim të pyesnim në qoftë se
4 është e mundur që vetëm mbi këtë bazë të mund të pranohet
5 fotografia.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka vlerë
7 provuese. Nuk e kuptojmë vlerën provuese të kësaj fotografie.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Në rregull.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është se
10 po vëmë në diskutim se kush është personi i cili paraqitet në
11 atë fotografi, por thjesht nuk ka vlerë provuese.

12 Z. HALLING: [Përkthim] E kuptova. Pra, kemi gjithashtu
13 edhe diçka nga dje dhe donim t'ju thonin që sa i takon
14 parashtrimin F02355, në qoftë se nuk ka problem do të kërkonim
15 që të riklasifikohej si publike.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
17 kundërshtim nga palët sa i takon riklasifikimit të këtij
18 parashtrimi?

19 Duket sikur nuk ka kundërshtim kështu që do të
20 riklasifikohet.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
23 jemi gati të vazhdojmë. Z. Misetiç do të vazhdojë me pyetjet e
24 veta.

25 Mund të vazhdoni z. Misetiç.

- 1 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Gjykatës.
- 2 Znj. Sekretare, do ju kërkoja që të paraqisnit në ekran
- 3 tani provën materiale P01264, në faqen SPOE00128727.
- 4 Sekretare, ju lutem kalojmë deri në fund të faqes.
- 5 PY. Dëshmitar, në fund fare të kësaj faqes që keni përpara në
- 6 të djathtë te kjo kutia në të djathtë, kush është ky personi?
- 7 PË. Në të djathtë jam unë.
- 8 PY. Në rregull. A e shikoni çfarë këmishë keni veshur këtu,
- 9 çfarë bluze keni veshur, Dëshmitar?
- 10 PË. Po.
- 11 PY. Do ju kërkoja që ta mbani pak mend, ta fiksoni pak, sepse
- 12 do ju tregoj një tjetër material dhe do ju bëj një pyetje që
- 13 lidhet me këtë.
- 14 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares tani të
- 15 kalojmë në provën materiale edhe thjesht ngrijeni videon në
- 16 sekondën e 3-të.
- 17 [Luhet videoincizimi]
- 18 Z. MISETIC: [Përkthim]
- 19 PY. A e njihni kush është ky person, Dëshmitar? Ky personi që
- 20 keni përpara?
- 21 PË. [E padëgjueshme]
- 22 PY. Kush është ky?
- 23 PË. Ky është Ukë Bytyqi.
- 24 PY. Kjo është videoja që ju keni incizuar në qershor, me 24
- 25 qershor 1998, apo jo, Dëshmitar? Të paktën kështu thuhet sipas

1 librit tuaj.

2 PË. Po, kështu është, me 24 qershor 1998 është xhiruar
3 deklarata e Ukë Bytyqit.

4 PY. Në rregull.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani le të kalojmë te sekondi i 3-
6 të. Dhe i lutem Sekretares që ta ngrijë në ekran. Ose nuk ka
7 problem mund ta transmetoni të gjithë videon edhe për nja 2, 3
8 sekonda të tjera këtu.

9 [Luhet videoincizimi]

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të vazhdoni pak dhe më tej
11 krahun aty.

12 [Luhet videoincizimi]

13 PY. Dëshmitar, a jeni ju këtu? Domethënë dora e këtij personi
14 a jeni ju, se është e njëjta bluzë që pamë edhe në fotografinë
15 e mëhershme.

16 PË. Po, dora ime. Unë jam aty.

17 PY. Dëshmitar, dëshiroj që të flasim pak për datat. Në
18 intervistën që i keni dhënë ZPS-së, për procesverbal është
19 prova P01264 Pjesa 1, duke filluar nga rreshti 10, ju thoni si
20 më poshtë:

21 "Gjërat mund të harrohen dhe disa gjëra të caktuara ose
22 disa data ndoshta datat mund të jepen pak më herët ose pak më
23 vonë dhe dua të jem i sigurtë dhe i hapur me ju."

24 A ju kujtohet t'ja keni thënë këtë Prokurorit, Dëshmitar?

25 PË. Po, jam kam thënë edhe në Prishtinë, e ja kam thënë edhe

1 këtua në Hagë.

2 PY. Kur keni ardhur në Hagë përpara një jave i keni dhënë ca
3 shënime Prokurorit. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

4 PË. Po.

5 PY. Dua të lexoj një pjesë të shënimeve dhe do t'ju kërkoj të
6 më thoni pastaj nëse është e saktë apo jo ajo çfarë lexova. Ju
7 thoni:

8 "Sikurse e kam përmendur edhe në dëshminë e parë që kam
9 dhënë përpara Prokurorit me datë 30 dhe 31 korrik të vitit
10 2019 në Prishtinë, gjatë luftës unë nuk kam guxuar që të mbaj
11 në ditar disa emra dhe data të shënuara në libër. Kërkoj që të
12 mirëkuptohem lidhur me datat nga Trupi Gjykses dhe nga
13 publiku."

14 A ju kujtohet t'ja keni thënë këtë Prokurorit, Dëshmitar?

15 PË. Po, ashtu kam thënë.

16 PY. Unë po ju parashtroj si më poshtë, Dëshmitar, ju tregova
17 sot paradite që ajo çfarë ju pretendoni se ka ndodhur me 17
18 qershor në Bardhin e Madh, domethënë, ju z. Veseli dhe z.
19 Thaçi keni veshur të njëjtat rroba dhe ju thashë unë që a
20 është e mundur që me datë 19 [Sipas përkthimit] dhe pas disa
21 ditësh domethënë me datë 26 juve të vishnit të njëjtat rroba.
22 Juve më thatë që është e mundur të kishim veshur të njëjtat
23 rroba.

24 Ndërkohë që tani ju tregova një fragment tjetër dhe i
25 takon që me datë 24 qershor i keni ndryshuar rrobat e veshur.

1 Domethënë, me fjalë të tjera çfarë po më mundohem të them,
2 pavarësisht për të dhënë datat më të sakta, mund të jetë që
3 datat të mos jenë të sakta siç i keni thënë edhe në dëshminë
4 që i keni dhënë Prokurorit. A pajtoheni me mua, Dëshmitar?
5 PË. Ashtu mund të jetë. por e di që kjo datë është shumë e
6 saktë me 24 qershor të vitit 1998 që është xhiruar kjo
7 deklaratë.

8 PY. Në rregull. Nuk e kam fjalën për këtë. Por, a e pranoni
9 që data që keni dhënë në libër, madje edhe në dëshminë tuaj
10 për atë kohë që ti mbështetesh te kujtesa jote, mund të mos
11 jenë të sakta, sepse unë sapo ju demonstrova, sapo ju tregova
12 që ju gjatë atyre nëntë ditëve në fakt i keni ndryshuar
13 teshat, nuk është se i keni mbajtur të njëjtat rroba gjithë
14 kohën?

15 PË. Po, ashtu është normale nuk i kam mbajtur gjatë të gjithë
16 kohës. Kur kam pas mundësi kam pas ndonjë bluzë rezervë se
17 s'kam pasë nevojë me shku në Prishtinë ka qenë me postbllloqet
18 edhe ashtu kanë qëndruar luftëtarët e UÇK-së ashtu qëndruar
19 edhe unë edhe kameramani, edhe Zeka. Aty i kemi ndërru,
20 ndonjëherë kemi ndërru normal që ka qenë vera. Kemi mund që
21 një bluzë me e përdor dy javë ditë, ose tri javë. S'e di a po
22 më kuptoni çfarë dua të them.

23 PY. Po, po, e kuptojmë. E kuptojmë, megjithatë ajo çfarë po
24 mundohem të them unë është që datat sikurse e thashë edhe më
25 përpara, datat në librin tuaj, sikurse e keni thënë në shënime

1 Prokurorit por edhe në intervistën në 2019 mund të ndodhë që
2 datat të mos jenë të drejta, të sakta. A e pranon këtë
3 Dëshmitar?

4 PË. Ashtu është, ashtu është. E kam pranë edhe e pranoj edhe
5 tani.

6 PY. Faleminderit. Dëshmitar, përpara sesa të shkonim për
7 pushim unë po diskutoja për politikën e bashkësisë
8 ndërkombëtare në gusht që u ishin parashtruar përfaqësuesve
9 shqiptarë dhe vetëm autonomia do të lejohej në negociatë me
10 Serbinë dhe se pavarësia nuk ishte një tezë për diskutim.
11 Besoj që ju kujtohet ky diskutim që patëm para pushimit të
12 drekës, apo jo, Dëshmitar?

13 PË. Po, shumë mirë më kujtohet edhe atëherë do të thotë ashtu
14 ka qenë raporti i forcave ndërkombëtare dhe Serbia po të
15 pyetej as sot -- edhe sot nuk e pranon shtetin e Kosovës, edhe
16 sot e minon shtetin e Kosovës bashkë me Rusinë edhe kjo
17 Gjykatë konsideroj se është përpjekje për minimin e shtetit të
18 Kosovës sepse këto janë çlirimtarët dhe janë themeluesit e
19 shtetit të pavarur të Kosovës.

20 PY. Dëshmitar, thjesht po ju pyes që a e kuptoni që politika
21 e bashkësisë ndërkombëtare ishte autonomia? A pajtoheni me mua
22 lidhur me këtë?

23 PË. Po, në atë periudhë ashtu flitej. Nuk ofrohej më tepër.

24 PY. A keni qenë në dijeni që Slobodan Milosheviqi në fund të
25 shtatorit, i kishte deklaruar përfshirë këtu edhe

1 përfaqësuesve ndërkombëtarë që UÇK-ja ishte shkatërruar
2 efektivisht?

3 PË. Po, ashtu mendonte Milosheviqi dhe donte t'a fuste frikën
4 te populli shqiptar që të mos ta mbështeste Ushtrinë
5 Çlirimtare të Kosovës. Dhe unë në nëntor të vitit 1998 e
6 përgatita një dokumentar special se UÇK-ja ekziston se UÇK-ja
7 është këtu dhe vepron dhe punon për të çliruar përfundimisht
8 Kosovën.

9 PY. Kjo është videoja ku paraqitet edhe z. Thaçi, apo jo,
10 Dëshmitar?

11 PË. Po, të njëjtin dokumentar, po.

12 PY. Juve ju tregua një fjali nga Prokurori sot paradite ku z.
13 Thaçi flet për faktin se institucionet serbe kanë kryer luftë
14 speciale kundër UÇK-së në veçanti për ta portretizuar atë që
15 ishte shkatërruar. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

16 PË. Po.

17 PY. Sa i takon përmendjes së disa elementëve autonomë, ju nuk
18 e dini në qoftë se z. Thaçi e kishte fjalën për ndërkombëtarët
19 që kishin ardhur në Kosovë me një plan për propozimin
20 autonomisë apo nëse ai i referohej apo e kishte fjalën për
21 dikënd tjetër? Çfarë qëndrimi keni ju lidhur me këtë,
22 Dëshmitar?

23 PË. Nuk e di për ç'ka ka menduar z. Thaçi, por në atë
24 periudhë edhe disa faktorë ndërkombëtarë kanë mendu se mjafton
25 autonomia për Kosovën edhe disa individë në Prishtinë ndoshta

1 kanë mendu pikërisht se mjafton autonomia për Kosovë, se është
2 zgjidha autonomia për Kosovën, por populli shqiptar i Kosovës
3 nuk është pajtuar me këtë.

4 Dhe këtë arsye kur i është [E pakuptueshme] të gjitha
5 mjetet demokratike, të gjitha mjetet paqësore për realizimin e
6 qëllimit për pavarësi është aktivizuar Ushtria Çlirimtare e
7 Kosovës për të luftuar, për të zhvilluar luftë frontale kundër
8 forcave policore dhe ushtarake serbe.

9 PY. Megjithatë, a ishit në dijeni që jo vetëm në verë, por
10 edhe gjatë vjeshtës, Christopher Hill kishte ardhur me plane
11 të cilat ja kishte paraqitur ndërmjet të tjerëve edhe UÇK-së
12 që kishte autonominë si propozim. A jeni në dijeni të kësaj
13 gjëje, Dëshmitar?

14 PË. Po, kam qenë në dijeni për këtë.

15 PY. Dëshmitar, tani do të kalojmë në një temë tjetër, por
16 përpara sesa do të bëj këtë do ju bëj disa pyetje të
17 përgjithshme.

18 Ju jeni një gazetar i mirënjohur. Në kohën kur e keni
19 shkruar librin në 2019, a e ke pas dëgjuar për atë çfarë quhet
20 ndryshe si raporti i Marty?

21 PË. Po, kam dëgjuar.

22 PY. E kishe lexuar ti raportin e Marty?

23 PË. E kam lexuar këtë raport. E konsideroj se është raport
24 joreal, është përpjekje e Serbisë dhe e Rusisë për ta
25 kriminalizuar luftën e drejtë të UÇK-së.

1 PY. Në qoftë se e ke lexuar raportin, atëherë besoj se e dini
2 se në të përmendet grupi i Drenicës dhe Hashim Thaçi. A është
3 e saktë kjo, Dëshmitar?

4 PË. [E padëgjueshme]

5 PË. Unë po ju them që raporti i Marty është botuar në 2011.

6 Besoj që keni parë përmendje të raportit në media dhe
7 thashetheme apo fjalë që z. Thaçi ishte shënjestra e hetimit.
8 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

9 PË. Po, është e saktë. Është akuzuar UÇK-ja për trafikim
10 organesh që ishte një aktakuzë qesharake dhe shumë e
11 paqëndrueshme. Ishte një gënjeshtër.

12 PY. Në rregull. Dëshmitar, në mënyrë që t'i japim një
13 panoramë të plotë Trupit Gjykues do lexoj një pjesë tjetër të
14 librit në mënyrë që të kuptojmë pak më mirë marrëdhënien që
15 keni patur ju dhe z. Thaçi në kohën kur është shkruar libri. E
16 kuptoni, Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Do i kërkoj Sekretares
19 të paraqesë në ekran provën materiale P1264. Kjo është një
20 ndër pjesët që është e pranuar si provë materiale kështu që do
21 të përmend numrin ERN. Është dokumenti DHT04004 deri në
22 DHT04006 në anglisht dhe SPOE00351217 deri në 00351603, në
23 faqe 636 dhe 637. Do të fillojmë në faqen 636 në shqip.

24 DËSHMITARI: Mungon në gjuhën shqipe, nuk është teksti në
25 gjuhën shqipe.

1 Z. MISETIC: [Përkthim]

2 PY. Prisni për një çast dëshmitar.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Më thonë që duhet të kërkoj që të
4 paraqitet në ekran faqja 351357.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
6 flisni përpara mikrofonit se nuk ju dëgjuam. Është numër i
7 ndryshëm nga 357, apo jo?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, kjo është faqja po thjesht nuk
9 po shfaqet në ekran.

10 DËSHMITARI: Mund ta bëni pyetjen z. Avokat, mund ta bëni
11 pyetjen lirisht.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull.

13 PY. Unë do të lexoj pjesën përkatëse, pjesët përkatëse të
14 librit, por përpara sesa të bëj leximin dua t'ju them që në
15 këtë pjesë të librit përshkruhen përpjekjet tuaja për të marrë
16 mbështetje financiare nga Qeveria e Kosovës në mënyrë të tillë
17 që të përgatisni dokumentar për luftën dhe për UÇK-në. A është
18 e vërtetë kjo, a është një përmbledhje e saktë kjo, Dëshmitar?

19 PË. Po, e vërtetë është. Kam bërë disa filma dokumentarë por
20 nuk ka pasur përkrahje të mjaftueshme nga institucionet e
21 atëhershme për realizimin e tyre.

22 PY. Do të lexoj pjesët përkatëse. Në libër ju thoni që:

23 "Më vjen keq të them por është detyra e ish-kryeministrit
24 të Kosovës Hashim Thaçi, dhe kabineti qeveritar i
25 kryeministrit Ramush Haradinaj si udhëheqës dhe mbështetës të

1 luftës çlirimtare nuk kanë sponsorizuar asnjë projekt për film
2 dokumentar edhe pse unë kam dorëzuar si skriptin ashtu edhe
3 kërkesën zyrtare.”

4 Më tej vijohet:

5 “... Unë kam dorëzuar disa skripte dhe kërkesa për
6 mbështetje financiare për këto projekte shumë të rëndësishme
7 në institucionet tona, kryesisht i kam dorëzuar në Qeverinë e
8 Republikës së Kosovës, por fatkeqësisht ata nuk më kanë
9 mbështetur mua siç duhet.

10 “Në vitin 2008 dhe 2009 unë kam dorëzuar një kërkesë te
11 Qeveria e Thaçit për mbështetjen e një filmi dokumentar për
12 rrugëtimin e Kosovës drejt çlirimit dhe pavarësisë së saj, por
13 nuk kam marrë asnjë mbështetje. Shuma e kërkuar ishte shumë
14 minimale. Ishte vetëm 14.000 euro. Por, përderisa u kërkuar që
15 të zvogëlohej akoma më tepër, kjo mua nuk -- kjo insistim nuk
16 m'u duk serioze dhe nuk pranova.”

17 Pra, e para, a ju kujtohen këto ngjarje dhe së dyti a
18 është e drejtë që këto ngjarje ju kanë mërzhitur juve në atë
19 kohë dhe për këtë arsye keni vendosur që t'i përfshini në
20 libër?

21 PË. Kjo që kam shkruar është shumë e vërtetë. Kam desht ta
22 paraqes gjendjen reale sesa institucionet e Republikës së
23 Kosovës i kanë mbështetur jo vetëm projektet e mia por edhe
24 projekte të tjera të kolegëve të tjerë që pasqyrojnë historinë
25 tonë më të re, historinë shumë të dhimbshme të popullit tonë,

1 prandaj edhe i kam shkruar ashtu si është.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Vazhdojmë qëndrojmë në të njëjtën
3 faqe, pra në faqen 637, në qoftë se nuk e kam gabim. Faqja
4 tjetër në anglisht. Kjo është faqja e duhur.

5 PY. Paragrafi i dytë nga fundi në anglisht thotë:

6 "Shumë procese gjyqësore kundër çlirimtarëve janë pasuar
7 ndërkohë që janë nxjerrë shumë dosje dhe fletë-arrestime ndaj
8 tyre nga regjimi i Beogradit dhe janë deponuar akuza dhe padi
9 nga njerëz që kanë bashkëpunuar me okupatorin."

10 Pra, këtu përshkruani, Dëshmitar, që jeni në dijeni të
11 faktit që ka pasur procese gjyqësore ndaj personave që ju
12 thoni kanë qenë bashkëpunëtorë me okupatorin. Çfarë ke dashur
13 të thuash me këtë, Dëshmitar?

14 PË. Kam dashtë të theksoj se në Kosovë pas luftës janë
15 mbajtur disa procese gjyqësore ndaj ish-luftëtarëve të UÇK-së
16 në të cilat kanë dhënë, kanë kontribuar edhe disa individë të
17 cilët janë të instrumentalizuar nga Serbia për qëllime të
18 njohura për të mohuar luftën e drejtë të UÇK-së dhe për të
19 akuzuar UÇK-në për kinse ka bërë krime.

20 Këto kanë qenë disa procese gjyqësore në Kosovë por kanë
21 qenë procese gjyqësore në Hagë ndaj z. Limaj dhe ndaj z.
22 Haradinaj.

23 PY. Pra, ju me ç' duket keni qenë në dijeni të faktit që
24 personat që i janë nënshtruar proceseve gjyqësore domethënë
25 kanë qenë personat të cilët pretendohej që të kishin kryer

1 krime kundër bashkëpunëtorëve. Domethënë, ka pasur procese
2 gjyqësore kundra tyre që konsideroheshin të ishin
3 bashkëpunëtor. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

4 PË. Ka pasë procese të tilla, sa di unë ka pasë edhe këto i
5 din opinionin.

6 PY. Atëherë në qoftë se do të shikojmë më poshtë në
7 paragrafin tjetër, ju përmendni që ka pasur madje edhe presion
8 nga qarqet ndërkombëtare. Është paragrafi i fundit që kemi
9 këtu në ekran. Thoni që:

10 "Ka pasur gjithashtu presion nga qarqet ndërkombëtare për
11 krijimin e një gjykate speciale për krimet e luftës."

12 E keni fjalën për këtë Gjykatë, apo jo?

13 PË. Po, po.

14 PY. Pra, kur ti ke shkruar librin, ju e dinit që kishte
15 njerëz të cilët ishin pjesë e proceseve gjyqësore për krime
16 kundër bashkëpunëtorëve dhe që po krijohej ose po themelohej
17 kjo Gjykatë, apo jo, Dëshmitar?

18 PË. Po, po.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani kalojmë te faqja tjetër që
20 është 767 në versionin në anglisht, që është SPOE00351557 në
21 versionin në shqip.

22 PY. Ndërkohë që paraqitet kjo në ekran, pjesa tjetër e librit
23 që dëshirojmë që të shohim është pjesa kur ju kishit aplikuar
24 që të bëheshit drejtor i RTK, domethënë i Radio Televizionit
25 të Kosovës. Është e saktë kjo, Dëshmitar?

1 PË. Po, e saktë është.

2 PY. Unë do ju lexoj atë çfarë keni shkruar ju në libër.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Një çast se po presim që të
4 paraqitet edhe anglishtja edhe shqipja.

5 DËSHMITARI: Mund ta bëni pyetjen lirisht, as s'keni
6 nevojë me prit.

7 Z. MISETIC: [Përkthim]

8 PY. Në libër keni shkruar sa i takon kërkesës për t'u bërë
9 drejtoj i RTK-së:

10 "Hashimi më dha kundërshtimin e tij mua. U largua -- u
11 largova shumë i zhgënjyer për Hashimin. Sjellja e tij ishte
12 injoruese, mosnjohëse për sakrificat e mia gjatë luftës dhe
13 për mbështetjen e medias që i kisha dhënë atij, shokëve të tij
14 në momentet më të vështira dhe më sfiduese kur kishin shumë
15 pak mbështetës. Pavarësisht të gjithë mbështetjes që ja kisha
16 dhënë Hashimit dhe shokëve të tij që prej periudhës së
17 çlirimit, si edhe pas periudhës së çlirimit unë e dija që nuk
18 isha shumë i përshtatshëm për Hashimin dhe për miqtë e tij
19 sepse ata nuk mund të më manipulonin mua për interesat e tyre
20 të përditshme. Mbështetja e mëhershme për të dhe për shokët e
21 tij ishte si rezultat i prejardhjes politike nga lufta
22 çlirimtare dhe nuk ishte mbështetje që donte të thoshte që të
23 mbështetej manipulimi i tyre ndaj të tjerëve."

24 Është shumë e qartë nga kjo pjesë, Dëshmitar, që ju ishit
25 i mërziur me Hashim Thaçin në këtë pjesë të librit, për

1 mënyrën sesi ai e kishte trajtuar kërkesën tuaj për t'u bërë
2 drejtoj i RTK-së.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
4 ju lutem, a do të mund të vazhdoni që të bëni pyetje të cilat
5 janë relevante?

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Po këto janë pyetje hyrëse dhe
7 pastaj tek pyetjet e tjera do të shikoni relevancën e
8 pyetjeve.

9 DËSHMITARI: Z. Avokat, nuk isha i mërziur po unë e kam
10 shkru një realitet me insistimin e disa miqve të mi, disa
11 kolegëve të mi në RTK, unë aplikova për drejtor të
12 përgjithshëm të RTK-së. Ta them të drejtën edhe atëhere e dija
13 se nuk do të zgjidhesha sepse politika kërkon sigurisht njerëz
14 më fleksibil, ma të dëgjueshëm, çdo politikë edhe atëhere edhe
15 sot. Por e kam shpreh një realitet si ka qenë, por nuk isha i
16 mërziur për këte.

17 Z. MISETIC: [Përkthim]
18 PY. Dëshmitar, dua të shohim një pjesë të librit ku diskutoni
19 përgatitjen e dokumentarit në nëntor të 1998. Së pari, thoni
20 që z. Thaçi kishte një version të papërfunduar që e kishte
21 përgatitor. A kishit një kopje të këtij versioni të
22 papërfunduar kur e përgatitët librin?

23 PË. Jo. E diskua bashkarish. Unë ia dhashë disa teza në të
24 cilat duhej të përgjigjej z. Thaçi të japë konstatimet e tij.
25 Ishte një version paraprak jodefinitiv. Ndoshta ka pas ndonjë

1 version tjetër por është realizuar versioni i cili ka qenë më
2 i pranueshëm për publikun. Sepse unë e kisha një përvojë pak
3 më gjatë se z. Thaçi. Z. Thaçi nuk kishte përvojë në atë kohë
4 për paraqitje publike para opinionit. Unë kisha përvojën time
5 dhe si gazetar dhe si njeri që jetoja në Prishtinë e dijsa
6 mentalitetin e Prishtinës, të zonave që nuk ishin të përfshira
7 në luftë sepse ato nuk e përjetonin luftën si e përjeton
8 popullata civile në zonat e luftës.

9 PY. Dëshmitar, do t'ju pyetje që duhet ta kisha bërë më
10 përpara. Kur thoni dhe i thatë Prokurorit në fakt, që jeni
11 takuar me z. Thaçi edhe ai e kishte lexuar librin dhe tha që
12 libri është i vërtetë. Ju kujtohet kjo?

13 PË. Po, më kujtohet.

14 PY. A ishte befasi për ju, tani që ju lexova dhe këto pjesët
15 ku përmendej ai, që ai në fakt s'ka kundërshtuar këto gjëra që
16 keni shkruar ju, nuk ka pas ndonjë kontestim për gjërat që
17 keni shkruar ju dhe ka thënë që jo libri është shumë real? A
18 nuk është befasi për ju kjo duke marrë parasysh ngjyrimin që i
19 keni bërë ju këtij përshkrimi në librin tuaj?

20 PË. Po tash shikuar nga distanca kohore, 26 vjeçare, unë
21 ngjarjet e asaj periudhe i kam pa ashtu si i kam paraqitur në
22 librin tim. Mund të mos jenë ndoshta në harmoni me
23 aktualitetin, por konsideroj se janë ngjarje të vërteta. Ato
24 në pikëpamje të mia si thashë edhe dje në dëshminë time, janë
25 opinione të mia, ashtu si i kam pa unë. Tash na nuk kemi pas

1 kohë me bisedu gjerësisht për çdo faqe se këtu janë 768 faqe
2 edhe z. Thaçi, sigurisht, nuk ka arrit t'i lexojë ato kur jam
3 takuar me të, të gjitha ato. Po ka qenë një vlerësim i
4 përgjithshëm, janë përfshirë ngjarjet më të rëndësishme.
5 PY. E pranoj këtë që ju besoni se ishin të vërteta, po unë po
6 them këtë, i the Prokurorisë kur ju bëri pyetje se z. Thaçi të
7 kishte thënë ty se libri është real dhe unë po them, a nuk
8 është habi për ju duke marrë parasysh sesi e keni përshkruar
9 ju atë në libër, nuk është habi për ju që ai të ketë thënë
10 është real duke marrë parasysh ngjyrimin e përshkrimit që keni
11 bërë ju?
12 PË. Nuk po ju kuptoj çka doni të thoni.
13 PY. Dëshmitar, flasim për seancën përgatitore. Kur e shkruat
14 librin, a e kishit një kopje të draftit, versionit të
15 papërfunduar që mendohet se kishte shkruar z. Thaçi rreth
16 datës 30 tetor 1998, a e kishit një kopje të këtij drafti kur
17 e shkruat këtë libër?
18 PË. Nuk kisha kopje, por ma tregoi për afërsisht fjalinë e
19 parë si ka menduar ta thotë.
20 PY. Pra, kjo fjali e parë, është e bazuar në çfarë mbani ju
21 mend se keni parë, se keni shkruar 26 vite pas faktit apo jo?
22 PË. Po, sigurisht.
23 PY. Domethënë, ju keni vendosur dhe citime në të. Por, në
24 fakt, në të vërtetë nuk është një citim i mirëfilltë por është
25 diçka të cilën ju e bazoni në kujtesën tuaj, është ajo që ju

1 kujtohet ju, ama nuk mund të thoni me 100 për qind që ishte
2 fjalë për fjalë e saktë?

3 PË. Keni të drejtë. Ashtu është.

4 PY. A e pranoni se këtë e keni shkruar në një kohë, ku keni
5 një farë ndjesie negative përkundrejt z. Thaçi gjatë kohës që
6 keni shkruar librin siç dhe e keni përshkruar në libër. E
7 pranoni këtë?

8 PË. Jo, kurrsesi nuk e pranoj se kam pas ndonjë tendencë
9 negative ndaj as atëherë, as tani, as kurrë. Se nuk jam prej
10 atyne gazetarëve që mbaj inate dhe shkruajnë me porosi ose me
11 diktate.

12 PY. Faleminderit.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, do të doja që
14 të pranoheshin faqet përkatëse të librit që përdora me
15 dëshmitarin nëse nuk janë të pranuar.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund t'ju
17 pyes a jeni dakord të gjitha palët që ta marrim të gjithë
18 librin në tërësinë e vet dhe ta pranojmë.

19 Z. Emerson, ju thatë diçka dje, kishit një rezistencë,
20 dikush prej jush tha që nuk ishte dakord.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po. Shqetësimi im ishte që nuk
22 është i përkthyer i gjithë libri dhe dëshmitari ka dhënë
23 dëshmi për ato pjesë që lidhen me deklaratën e dëshmitarit
24 edhe shënimet përgatitore. Nuk e di nëse duhet të pranojmë
25 pjesë të mëtutjeshme të librit.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë po ju
2 pyes a pajtoheni të katër ekipet që ta pranojmë librin. Po me
3 sa duket jo.

4 Z. TULLY: [Përkthim] Dhe ne konfirmojmë që do t'i
5 tregojmë disa fragmente dëshmitarit që nuk janë të përkthyer
6 në anglisht por as ne nuk jemi dakord që të pranohet i gjithë
7 libri.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull atëherë. Më lejoni tani
9 që të gjej faqet që më nevojiteshin mua.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Ose mund ta bëj më vonë në mënyrë
12 që të mos çojmë kohën dem.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëheni me
14 shkrim dhe është dhe më saktë në këtë mënyrë.

15 Z. MISETIC: [Përkthim]

16 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Me kaq i përfundova pyetjet.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,
18 është radha juaj. Vetëm kimi parasysh që në orën 3.30 do të
19 bëjmë një pushim të shkurtër.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më jepni vetëm pak minuta sa të
21 organizohem.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pa problem.

23 Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson:

24 Z. EMMERSON: [Përkthim]

25 PY. Dëshmitar, ju i keni dhënë ZPS-së, po edhe Mbrojtjes

1 thatë ju, çdo gjë që kishit nën zotërimin tuaj, kështu?

2 PË. Ashtu është.

3 PY. Tani i pamë materialet që keni pasur në zotërim, ato janë
4 disa fotografi ose janë pjesë xhirimesh ku është edhe Kadri
5 Veseli, kështu?

6 PË. Po.

7 PY. Unë do t'ju them diçka dhe, më korrigjoni nëse e kam
8 gabim, ka një hendek në dokumentacionin tuaj sepse nuk ka
9 imazhe të Kadri Veselit nga periudha e fund qershorit 1998 dhe
10 13 marsit 1999. Pra, nga kjo periudhë në këtë periudhë nuk ka
11 asnjë imazh të Kadri Veselit. Tani ju e dinit që z. Veseli
12 gjatë kësaj periudhe apo për një pjesë të kësaj periudhe nuk
13 ka qenë në Kosovë ka qenë jashtë vendit, e dinit ju këtë?

14 PË. E dija që ka lëvizur jashtë vendit, por nuk kam pas
15 xhirime të tij në atë periudhë se z. Veseli nuk ka qenë dhe
16 përfaqësues politik ose figurë që ka qenë i autorizuar që të
17 japë deklaratat publike për opinion. Për atë dhe nuk ka
18 xhirime.

19 PY. E keni përmendur dhe në libër rolin që ka pasur pranë
20 shërbimit informativ. Ju e dinit çfarë bënte ai jashtë
21 Kosovës? A e mësuar në ndonjë periudhë të mëvonshme çfarë
22 bënte ai jashtë Kosovës gjatë periudhës që mungonte në Kosovë,
23 që nuk ishte në Kosovë?

24 PË. Jo, nuk e dija. Po sigurisht që ka kry detyrën e vet duke
25 informuar shtetet aleate, shtetet mike të Kosovës për

1 zhvillime në Kosovë dhe çështje të tjera. Nuk i di detajet.
2 PY. Do të shohim disa nga xhirimet për të cilat komentuat në
3 qershor të 1999 dhe keni përmendur edhe z. Veseli i cili ka
4 qenë në shoqërinë dhe është përshkruar aty dhe është thënë që
5 ka qenë në shoqërinë e shefit të shërbimit informativ të
6 Shqipërisë.

7 Dhe duam të jemi të qartë 100 për qind se për çfarë po
8 flasim, zotnia me të cilin e keni parë më 17 qershor, në
9 videon e 17 qershorit ishte shefi i shërbimit informativ
10 shqiptar, i SHIK-ut, apo jo, Fatos Klosi?

11 PË. Ashtu është, po.

12 PY. Tani do të doja t'i merrnim gjërat sipas radhës
13 kronologjike. Shohim periudhën pararendëse dhe do të doja të
14 bënim disa korrigjime nëse është e mundur.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Fillimisht do të doja që të
16 shfaqej në ekran prova materiale P1267 në sekondën e 00:03.
17 Dhe nuk duam që të shohim videon po thjesht të qëndroj imazhi
18 i ngrirë. Sepse e kemi parë një herë këtë video. Një çast.
19 Mbase do të shohim një sekondë ose disa sekonda më përpara ju
20 lutem. Kjo.

21 PY. A e mbani mend që ua tregojë këtë pjesë të dokumentarit,
22 u tregua në këtë pjesë të dokumentarit ku folësi përshkruan
23 një komunikim ku përfshihej dhe një thirrje nga Kadri Veseli
24 në front?

25 PË. Po, z. Avokat. Kështu flet profesor Mujë Rugova dhe

1 kujtimet e tij. Çka flet ai, ai mban përgjegjësi.

2 PY. Patjetër. Po nëse ju kujtohet në momentin që ju bënë
3 pyetje për këtë, unë kërkoja disa sqarime për datat.

4 Kjo është një video që është përgatitur dhe ka lidhje me
5 karrierën ushtarake të Agim Qelajt, apo jo, është në nder të
6 tij?

7 PË. Po. Kjo është një pjesë e dokumentarit kushtuar heroit të
8 Kosovës, Agim Qelaj.

9 PY. Nëse ju kujtohet, nuk është nevoja ta nxjerrim sërish në
10 ekran po por nëse ju kujtohet komenti që bën folësi këtu është
11 që më 12 mars, pas vrasjes së familjes Jashari, Agim Qelaj
12 shkoi në Kosovë në zyrën - më fal - shkoi në zyrën e qeverisë
13 së Kosovës në Bon dhe ka marrë një thirrje nga Kadri Veseli në
14 front.

15 Dhe z. Halling ju pyeti "Në çfarë date e kishte fjalën
16 ai, kur është bërë kjo thirrje telefonike?". Dhe ju u
17 përgjigjët dhe thatë "Besoj se ka qenë 12 marsi i vitit 1998".

18 PË. Z. Avokat, kështu thotë Mujë Rugova. Kur është e saktë
19 nuk muj me dit. Nuk jam i sigurt.

20 PY. Nuk është nevoja ta shohim dhe një herë transkriptin
21 sepse të gjithë e kemi përpara dhe është e pranuar si provë.
22 Por nuk ka pasur front më 12 mars 1998? Nuk ka pasur asnjë
23 front ushtarak asgjekundi.

24 PË. Keni të drejtë. Nuk ka pas luftë intensive frontale. Ka
25 pas disa aktivitete të vogla po nuk ka pas luftë intensive

1 frontale.

2 PY. Po.

3 PY. Dhe unë nuk kam qenë në atë periudhë në zonat e luftës.

4 Do të thotë, s'kam pas as njohuri ma tepër.

5 PY. Pra, ajo që thotë folësi është kjo, më 12 mars Agim Qelaj

6 shkoi në zyrën e Qeverisë së Kosovës në Bonn, nuk bëhet ndonjë

7 specifikim për datat, por ngjarja e radhës, konflikti i radhës

8 pas masakrës së Jasharëve ishte futja e forcave serbe në

9 pjesën perëndimore të Kosovës që arriti kulmin në sulmin që i

10 bënë familjes së Haradinajt, kullave të Haradinajt --

11 PË. Po. Më 24 mars

12 PY. -- më 24 mars. Pajtoheni me mua?

13 PË. Po, pajtohem.

14 PY. Dhe periudha kur u hap konflikti ka qenë goxha më vonë

15 gjatë vitit. A pajtoheni?

16 PË. Pajtohem.

17 PY. Domethënë, nuk ka pasur front dhe s'mund të ketë qenë

18 Kadri Veseli në ndonjë front më 12 mars përveç nëse ka qenë i

19 përfshirë në masakrën e Jasharëve, por askush nuk e ka thënë

20 këtë në asnjë moment.

21 PË. Keni të drejtë, z. Avokat.

22 PY. Tha folësi, besoj se pajtoheni me mua, duhet ta ketë

23 pasur fjalën për ndonjë datë të mëvonshme dhe jo për 12 marsin

24 --

25 PË. Me siguri.

1 PY. -- sepse kjo mund të jetë data e vet masakrës së

2 Jasharëve?

3 PË. Ajo ka qenë si orientim. Do të thotë, krejt vullnetarë si
4 kanë ardhë nga perëndimi që ju kanë bashkëngjitur UÇK-së kanë
5 qenë pas ndodhjes së epopesë në familjen Jashari më 5, 6 dhe 7
6 mars. Aty ka fillu në mënyrë masive të vijnë mërgimtarët, të
7 vijnë vullnetarët nga Evropa dhe nga Amerika. Kurse betejat
8 frontale kanë fillu ma vonë fundi i prillit, fillimi i majit
9 si është më 8 dhe 9 maj në Grykën e Llapushnikut dhe beteja të
10 tjera.

11 PY. Po. Pra, sulmit që u bë tek Jasharëve dhe Haradinajve në
12 mars, këtu po flasim për data në fillim të prillit dhe fillim
13 të majit kur vërtetë filluan të hapeshin frontet kur Kadri
14 Veseli apo kushdo tjetër mund të ketë bërë një thirrje
15 telefonike, mund të kenë qenë në front?

16 Duhet të përgjigjeni me zë. A pajtoheni me propozimin që
17 bëra unë?

18 PË. Pajtohem. Pajtohem.

19 PY. Faleminderit. Më jepni një sekondë, ju lutem. Z. Halling
20 ju tregoi një video të një dasme, dasma e një ushtari të UÇK-
21 së, dasma e Naser Krasniqit. Ju kujtohet? Dhe atje pamë disa
22 persona mes të cilëve dhe z. Veseli edhe që qëlluan me armë
23 në ajër. Ju kujtohet?

24 PË. Po, patjetër.

25 PY. Dhe ju komentuat dhe thatë se kjo është një traditë,

1 është diçka e zakonshme që ndodh nëpër dasma, është një

2 traditë për dasma, kështu?

3 PË. Ashtu është. Ashtu është dhe ashtu e paraqit taman atë

4 atmosferën reale që ishte në dasma. Këndohej edhe ishte një

5 moment gëzimi. Jo vetëm për Naserin, por edhe për shokët e

6 tij, për bashkëluftëtarët e tij. Dhe në dasma zakonisht në

7 Kosovë dhe tani dhe atëherë është shtënë me armë.

8 PY. Që të jemi të qartë. Kur thoni është traditë, nuk është

9 traditë e UÇK-së kjo, është traditë e lashtë --

10 PË. Është traditë e popullit.

11 PY. -- e moçme?

12 PË. Është traditë e moçme e popullit tonë, e popullit

13 shqiptar.

14 PY. Që daton që na periudha kur u shpikën armët në atë pjesë

15 të botës, apo jo?

16 PË. Ashtu është.

17 PY. Apo kur filluan të kishin armë?

18 PË. Ashtu është.

19 PY. Ka qenë një nga mënyrat se si festoheshin dasmat?

20 PË. Kur ka momente gëzimi ashtu është.

21 PY. Gjithashtu edhe kur lindte një fëmijë, apo jo?

22 PË. Ashtu. Ashtu është.

23 PY. Dua të flas tani për mbledhjen ku keni qenë dhe ju po për

24 qëllime xhirimi që të xhironit këtë paraqitjen publike të z.

25 Krasniqi si përfaqësues apo si zëdhënës.

1 Dua të sqaroj diçka për periudhën kohore këtu. A e kam
2 kuptuar drejt unë që ju keni udhëtuar atë ditë, pra, më 12
3 qershor sepse ju mendonit se ngjarja do të xhirohej më 12 --
4 do të ndodhte më 12 qershor?

5 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, ka një shtrembërim këtu. Sepse
6 dëshmitari ka përmendur datën 13 qershor.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj se ka
8 të drejtë.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim]

10 PY. Mirë do ta bëj pyetjen ndryshe unë atëherë. Fillimisht
11 udhëtimi ishte planifikuar për datën 12 apo për 13 qershor?

12 PË. Më 12 qershor kam qenë unë në fshatin Negroc të Drenovcit
13 ku jam takuar me komandant Ferat Shalën, komandant Pëllumbi
14 dhe kam pritur aty deri më 13 qershor, jemi nisur në mbrëmje
15 për në Kleçkë. Kështu. Kjo është e vërteta.

16 PY. Kur ishe në Negroc, aty e mësove që do të bëhej paraqitja
17 publike?

18 PË. Jo, për paraqitjen publike e kam mësu më herët pas
19 bisedës me z. Thaçi, por aty erdhi e u takova me z. Kadri
20 Veseli dhe më tha se mund të shkoj në vendin e caktuar. Z.
21 Veseli e caktoi një luftëtar të UÇK-së Idriz Hysenaj i cili na
22 përcolli deri në hyrje të fshatit Tërpezë. Nga hyrja e fshatit
23 Tërpezë e deri në Kleçkë na ka vozitur komandant Haxhi Shala,
24 komandant Topi. Kjo është e vërteta.

25 PY. Që të jem i qartë, kur u largove nga Prishtina për këtë

1 xhirim, çfarë dite?

2 PË. Nga Prishtina më 11 ose 12, ashtu. S'e di saktë. 11 ose
3 12 qershor.

4 PY. Dhe ndaluar në këtë moment që të merrnit udhëzime të
5 mëtutjeshme për vendin dhe për organizimin, apo jo?

6 PË. Po, se unë nuk e dija atëherë ku do të xhirohej paraqitja
7 e parë publike e z. Krasniqi. Kam shkuar në Negroc ku ka qenë
8 shtabi lokal në shtëpinë e Halim Krsniqit. Pastaj kam shku në
9 shtëpinë e familjes së mikut të vëllaut tim, Jetullah Hoxhës,
10 Halit Hoxhës dhe atje jam taku me z. Veseli për të shkuar
11 pastaj në Kleçkë për të realizuar paraqitjen e parë publike.

12 PY. Faleminderit. Të flasim tani për vitin 1999.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares të na
14 ndihmonte që të shihnim një pjesë të videos që e kemi ne në
15 listën tonë të materialeve që është me numër 1213, DKV1213
16 deri në 1213 -- po, më falni, kjo është. Ky është fillimi, që
17 nga fillimi që nga sekonda 00:00 deri në 01:55.

18 PY. Janë nja dy pjesë që duam të shohim përpara se t'ju bëj
19 pyetjet. Data e videos është 11 prilli.

20 [Luhet videoincizimi]

21 "[Zëri] Sot është 8 prill 1999. Jemi duke evakuuar të
22 plagosurit nga Lugina e Baicës për Vuçak".

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ndalojmë këtu. Do të doja të
24 shihnim dhe pjesën e dytë të xhirit dhe do të doja të
25 shihnim nga minuta 02:02 deri në minutën 02:19.

1 [Luhet videoincizimi]

2 Z. EMMERSON: [Përkthim]

3 PY. Sikurse e dëgjuat, unë e thashë gabim datën. Sipas
4 kameramanit ka qenë 8 prilli 1999, dy javë pas fillimit të
5 bombardimeve të NATO-s. Dëshmitar, e kishit parë ndonjëherë
6 këtë xhirimin më përpara, mesa ju kujtohet?

7 PË. Një pjesë të xhirit e kam parë se është përdorur për
8 film dokumentar kushtuar invalidëve të luftës.

9 PY. Pikë së pari, ajo që shohim ne këtu, në përgjithësi,
10 është situata kur refugjatët po largohen nga Kosova, po ia
11 mbathin kur i thonë, po largohen, pajtoheni?

12 PË. Po, z. Avokat. Është e vërtetë se në atë periudhë një
13 pjesë e madhe e popullatës civile ishte larguar nga Kosova, jo
14 vetëm nga shtëpitë e tyre këtu në zonat që ishin strehuar në
15 zonat e luftës, po një pjesë e madhe ishte larguar krejtësisht
16 nga Kosova. Ishte dëbuar me dhunë nga Kosova, nga Prishtina,
17 nga të gjitha qytetet e Kosovës. Dhe kishte mbetur një numër i
18 vogël i popullatës civile në malet e Kosovës, në malet e
19 Drenicës, në malet e Dukagjinit.

20 PY. Thatë që keni parë një dokumentar për trajtimin e të
21 plagosurve, kështu?

22 PË. Po. Unë e kam përgatitur një film dokumentar për
23 invalidët e luftës, për të plagosurit gjatë luftës. Edhe disa
24 sekuenca, nuk është xhirimi i tërë këtu, s'po e shoh, po disa
25 sekuenca i kam përdorur për një film dokumentar.

1 PY. Faleminderit.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] I drejtohem Kryegjykatësit, a
3 është momenti i përshtatshëm.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
5 bëjmë dhjetë minuta pushim. Do kthehemi në 4.00 pa 20.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim
8 për dhjetë minuta.

9 --- Seanca ndërpritet në orën 15.30

10 --- Seanca rifillon në orën 15.40

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

12 Asistente, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të fillojmë këtë seancë me
14 të njëjtën pamje ku e përfunduam seancën e mëparshme në ekran.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
17 Dëshmitar. Do të vazhdojmë më tej me pyetjet e z. Emmerson.

18 Z. Emmerson, mund të vazhdoni.

19 Z. EMMERSON: [Mikrofoni çaktivizuar].

20 Ju kërkoj ndjesë. A mund të fillojmë në fillim të pjesës
21 që keni përpara në ekran. Duhet të jetë në minutën 02:02,
22 ndoshta do të ishte mirë që të transmetoni pjesën e videos
23 deri sa të arrijmë te pjesa që na intereson për diskutimin.

24 [Luhet videoincizimi]

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ndalojeni këtu, ju lutem.

1 Faleminderit.

2 PY. Dëshmitar, a e njihni personin që është në fotografi?

3 PË. Po, si jo. Është z. Kadri Veseli.

4 PY. A keni qenë në dijeni ose në atë ose në kërkimet që keni
5 bërë për dokumentet pasardhës që kanë të bëjnë me luftën, pra
6 a keni qenë në dijeni për rolin e z. Veseli në shoqërimin e
7 refugjatëve dhe trajtimin e personave të lënduar dhe të
8 plagosur?

9 PË. Shumë ka kontribuar bashkë me luftëtarët e tjerë të
10 lirisë, bashkë me mjekët që kanë në kohë edhe të Ushtrisë
11 Çlirimtare të Kosovës. Ka ndihmuar që t'u ndihmohet popullatës
12 civilëve, sidomos të plagosurve në zonat e luftës.

13 PY. Kjo është diçka të cilën ju e keni zbuluar gjatë
14 hulumtimeve që keni bërë për programet apo thjesht e dinit në
15 atë kohë?

16 PY. E dija se isha në kontakt me luftëtarët të UÇK-së me
17 njerëzit në ato zona, që jetonin në zonën e Drenicës dhe në
18 zonat e tjera. Ata më informonin.

19 PY. A është e mundur ndoshta po ndoshta jo, po a është e
20 mundur nga videoja të thoni nëse këta janë refugjatë po
21 largoheshin në drejtim të perëndimit apo në drejtim të jugut?
22 E tregoni dot nga videoja? Është e mundur ta tregoni një gjë
23 të tillë? Në qoftë se jo, na thoni jo, po kjo është pyetja.

24 PË. Nuk po shoh pamje këtu konkrete, por se në atë kohë nuk
25 kam qenë në zonat e luftat, nuk kam qenë as në Kosovë kam qenë

1 në Tiranë dhe nuk mund të them diçka më hollësisht. Po nëse i
2 shoh imazhet mund të komentoj.

3 PY. Në rregull. Të ndalojmë pak këtu tek kundërshtoj video
4 nëse është e mundur.

5 Tani le të vazhdojmë pak më përpara në video ose le të
6 flasim për periudhën e demilitarizimit dhe tërheqjen e forcave
7 serbe. Dhe për këtë arsye do të shohim një video që jua tregoi
8 z. Halling. Z. Halling kam përshtypjen që iu tregoi disa pjesë
9 shumë të shkurtra të kësaj video që do të shikojmë bashkë
10 tani. Është një video në të cilën ju keni dhënë komentet tuaja
11 kur ju tregua gjatë marrjes në pyetje nga Prokuroria.
12 Gjithashtu është një video të cilën e keni parë gjatë seancës
13 përgatitore.

14 Do të ishte mirë që të merrnim pak kontekst këtu sa i
15 takon kohës. Së pari, a pajtoheni me mua se koha për afërsisht
16 gjatë periudhës kur forcat serbe filluan të tërhiqeshin ka
17 qenë diku nga data 9 qershor dhe ka përfunduar pak a shumë nga
18 data 20 qershor? Si ju duket kjo periudhë kohore? Ka qenë pak
19 a shumë në këtë periudhë që janë tërhequr serbët, Dëshmitar?
20 PË. Po. Kjo është e saktë që thoni ju se me 9 qershor është
21 nënshkruar Marrëveshja e Kumanovës për kapitullimin e ushtrisë
22 serbe dhe largimin e saj nga Kosova. Edhe pastaj kanë disa
23 ditë deri me 20 qershor të vitit është larguar ushtari dhe
24 polici i fundit nga Kosova. Është fjala për forcat serbe.

25 PY. Përsëri, a e dini datën e hyrjes së forcave të para të

1 KFOR-it në qershor në Kosovë?

2 PË. Po, me 11 qershor 1999.

3 PY. Nëse të them se datat që kemi dëgjuar në prova për hyrjen
4 e forcave të KFOR-it në Prizren ka qenë data 14 qershor.

5 PË. Po.

6 PY. Kjo datë a të duket datë e saktë, e drejtë ty?

7 PË. [Nuk ka përgjigje]

8 PY. Tani, në të njëjtin kontekst, a jeni në dijeni që një
9 kontingjent forcash drejtohej nga komandanti Dreni në drejtim
10 të Prizrenit me datë 13 qershor kundër urdhrit, domethënë në
11 përgjigje të urdhrit të shprehur të Agim Çekut?

12 PË. Kam dëgjuar pas luftës, por nuk mund ta konfirmoj atë
13 saktë. Kam dëgjuar që ashtu, se unë me 14 qershor kam hy vetë
14 nga Shqipëria në Kosovë. Nuk kam qenë me 13 qershor në
15 Prizren.

16 PY. A e dinit ju që komandant Drini ishte zhveshur nga
17 përgjegjësitë e tij komanduese përpara kësaj nga Agim Çeku?

18 PË. Jo, nuk e dija. Singerisht ta them, nuk e dija.

19 PY. Shumë mirë, në rregull. A e dini kush është Tahir Sinani,
20 Dëshmitar?

21 PË. Po, shumë mirë e di. Tahir Sinani ka qenë një ndër
22 komandantët më të zotë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

23 PY. Në fakt, në atë kohë, pra në fillim të qershorit, ai ka
24 qenë komandanti i zonës së Pashtrikut, apo jo, Dëshmitar?

25 PË. Po, e di që ka qenë komandant i zonës së Pashtrikut.

1 PY. A e dini se ka pasur një periudhë kohe kur komandant
2 Drini vazhdoi që të vepronte sikur ishte komandant pavarësisht
3 që ishte caktuar Tahir Sinani në vend të tij?

4 PË. Kam dëgjuar, kam dëgjuar.

5 PY. Dhe kur i ishte thënë të mos shkonte në Prizren me datë
6 13 qershor pavarësisht që kishte marrë urdhër për të mos
7 shkuar, ai shkoi përpara sesa të futeshin forcat e KFOR-it në
8 Prizren.

9 PË. Mund të jetë e saktë.

10 PY. Atëherë, në qoftë se e shikon këtë nga jashtë, a do të
11 pajtoheshit me mua se duket se forcat nën komandantin Drini
12 nuk po funksionin në zinxhirin e komandës, apo jo?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtojmë nuk ka lidhje me
14 diskutimin.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në rregull atëherë do e bëj
16 ndryshe në qoftë se Trupi Gjykses e rrëzon kundërshtim, do ta
17 bëj ndryshe pyetjen.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është
19 skajore. Vetëm një fije e hollë e ndan ndërmjet të qenit e
20 pranueshme dhe e papranueshme kërkesën e Prokurorit.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim]

22 PY. Nëse komandanti përgjegjës, për shembull, komandanti i
23 një ushtrie të rregullt, Agim Çeku në rastin në fjalë që ishte
24 shefi i Shtabit të Përgjithshëm, në qoftë se ai caktonte ose
25 emëronte dikënd tjetër si komandant zone dhe komandanti i

1 mëhershëm i zonës më pas vepron duke thyer udhëzimin e
2 drejtpërdrejtë nga komandanti i Shtabit të Përgjithshëm
3 atëherë si do e përshkruanit një situatë të tillë?

4 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtojmë.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në rregull, nuk e di tani.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk besoj që
7 është personi i duhur për t'ju përgjigjur kësaj pyetjeje.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] E pranoj këtë, megjithatë ai mund
9 të dëshmojë se çfarë po ndodhte me lidërshtipin aktual në atë
10 fazë në atë periudhë, sepse Prokuroria i bëri pyetje lidhur me
11 këtë temë.

12 PY. Së pari, bisedat për demilitarizim të cilat kulminuan në
13 mbërritjen e Gjeneralit Mike Jackson dhe nënshkrimin e
14 përbashkët të marrëveshjes për demilitarizimin ku UÇK-ja u
15 pajtua me dorëzimin e armëve të veta, pra ky është një proces
16 i cili ka ndodhur, siç na keni thënë edhe më herët në dëshminë
17 tuaj, pra, është një proces i cili ndodhi në Fshatin e Ri,
18 nëse nuk e kam gabim. Megjithatë, është Fshati i Ri,

19 Kështu për procesverbal kështu quhej, kështu ishte emri i
20 vendi, apo jo, Dëshmitar?

21 PË. Aty është zhvilluar në Fshatin e Ri është zhvilluar disa
22 bisedime lidhur me marrëveshjen ku ka qenë z. Thaçi, pastaj ka
23 qenë z. James Rubin dhe të tjerë edhe z. Veseli ka marrë pjesë
24 aty. Edhe pastaj edhe në Divjakë një pjesë, edhe nga Divjaka
25 me helikopter special të KFOR-it delegacioni i UÇK-së është

1 nisur në drejtim të Shtabit të KFOR-it në Prishtinë, ku është
2 nënshkruar marrëveshja për demilitarizim me 22 qershor të
3 vitit 1999.

4 PY. Puna paraprake --

5 PË. [E padëgjueshme]

6 PY. Tani, puna paraprake është kryer - të kërkoj ndjesë për
7 mënyrën se si po e shqiptoj. Por, puna paraprake është bërë në
8 Fshatin e Ri. Nuk po ju kërkoj të na e thoni se ku gjendet ky
9 në hartë se mund ta bëjmë edhe vetë. Por a mund të na
10 shpjegosh pak ku gjendet Fshati i Ri, në lindje? Në lindje të
11 Prishtinës apo jo? Jo të Prizrenit se e thashë gabim.

12 PË. Po.

13 PY. Domethënë sa larg në lindje të Prishtinës është ky fshat?

14 PË. Një orë, gati një orë është me makinë nga Prishtina. Më
15 pak se një orë, me siguri.

16 PY. A është afër kufirit ky fshat?

17 PË. Jo, jo. Është në komunën e Malishevës aty afër zonës ku
18 ka vepruar Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së dhe Qeveria e
19 Përkohshme e Kosovë pikërisht ka vepruar në Fshatin e Ri.

20 PY. Qartazi gjatë kësaj periudhe kohe sikurse na thatë, ka
21 pasur biseda paraprake që kryheshin ndërmjet subjekteve të
22 ndryshme të përfshira për të gjetur një mënyrë se si të
23 realizonin procesin e çarmatizimit, në qoftë se mund ta quaj
24 kështu të UÇK-së. Domethënë çarmatimin e UÇK-së përpara sesa
25 të futej KFOR-i por duke e bërë këtë çarmatim me konsensus.

1 PË. KFOR-i ishte futur brenda në Kosovë por marrëveshja ishte
2 për demilitarizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe
3 transformimin e saj. Ashtu është thirrur saktë marrëveshja.
4 KFOR-i ishte brenda, por tash KFOR-i merrte kompetencat për
5 siguri në mbarë territorin e Kosovës dhe pas Marrëveshjes së
6 Rambujesë duhej që të bëhej edhe marrëveshja për
7 demilitarizimin dhe transformimin e UÇK-së.

8 PY. A keni qenë i informuar ju për përfaqësues të vendeve të
9 tjera, të shteteve të tjera që kanë ardhur në Kosovë për
10 procesin e këtyre negociatave?

11 PË. Po, po. Kanë qenë kryesisht diplomatët amerikanë në krye
12 me James Rubin, pastaj edhe diplomatë të vende të tjera në
13 kuadër të NATO-s, vendeve të NATO-s, aleate të Shteteve të
14 Bashkuara të Amerikës, edhe Shqipëria, edhe nga Shqipëria kanë
15 qenë.

16 PY. Kur thoni "diplomatë" është eufemizëm ky për zyrtarë
17 informativë apo jo?

18 PË. Po diplomatë edhe njerëz ushtarakë, disa profile të
19 ndryshme.

20 PY. Po Fatos Klosi nuk është se ka qenë diplomat apo jo, nuk
21 është se ishte as person ushtarak.

22 PË. Po, shef i Shërbimit Informativ Shqiptar, po.

23 PY. Në videon që iu tregoi Prokurori gjatë seancës
24 përgatitore Fatos Klosi ka folur me Kadri Veseli, apo jo,
25 Dëshmitar?

1 PË. Po, në video shihet Fatos Klosi, Kadri Veseli dhe një
2 amerikan.

3 PY. Do ta shohim edhe videon për pak. Por, e gjithë kjo,
4 domethënë, e gjithë videoja është regjistruar në Fshatin e Ri
5 gjatë asaj periudhe kohe, apo jo, Dëshmitar?

6 PË. Në Fshatin e Ri është. Ashtu është.

7 PY. A keni pasur dijeni ju që ka pasur negociate ose
8 bashkëbisedime intensive që janë zhvilluar në atë fshat gjatë
9 asaj periudhe ku ishin të përfshirë edhe ndërkombëtarët?

10 PË. Po, [E padëgjueshme] informata, po.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në rregull, të shohim videon. Më
12 jepni vetëm një minutë. Atëherë për procesverbal, videoja
13 është 087008-1, dhe transkripti ka absolutisht të njëjtin
14 numër, por përfundon me AT në fund. Nuk është e nevojshme
15 transkripti në fakt sepse nuk është se kemi shumë biseda që
16 dëgjohen aty. Dhe dëshiroj që të transmetohen katër pjesë të
17 kësaj videoje.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për
19 procesverbal bëhet fjalë për provën materiale P01296.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Shumë faleminderit. Atëherë
21 fillojmë në 02:20 deri në 02:26. Në fakt e thashë gabim 02:20
22 deri në 02:40 është pjesa - sekuenca ose fragmenti i parë i
23 videos që kërkoj që të transmetohet.

24 [Luhet videoincizimi]

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Të kalojmë deri tek 02:40.

1 [Luhet videoincizimi]

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Tani të transmetohet videoja nga
3 05, pra minuti 5-të sekonda e 41, jo 04:41 dhe 04:45.

4 [Luhet videoincizimi]

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] Atëherë do të ishte mirë që të
6 shikonim pak më shumë nga videoja.

7 PY. Megjithatë, Dëshmitar, me aq sa mundët të shikonit nga
8 këto bisedat te pjesa e brendshme, a e njohët Ardian Rekën
9 [Sipas përkthimit] si shef i Shërbimit Inteligjent, Shërbimi
10 Informativ i Jashtëm Shqiptar?

11 PË. S'e kam njohtë atë. Vetëm Fatos Klosin.

12 PY. Po Adem Rekën [Sipas përkthimit] a do e njihje?

13 PË. Unë s'e kam njoft [E padëgjueshme].

14 PY. Ose nënshkrimin e tij a do ta njihnit në qoftë se do ta
15 shikonit? Domethënë, e njihnit si person, nënshkrimin e a
16 njihnit në atë kohë?

17 PË. As në atë kohë, as tash s'e di kush është ai.

18 PY. Prokuroria pretendon që janë kryer disa krime në Prizren
19 gjatë kësaj kohe. Domethënë, nga periudha 15 deri në 23
20 qershor, 22-23 qershor. Me sa keni ju dijeni këto biseda kanë
21 vazhduar deri më datën 21 kur u nënshkrua marrëveshja. A është
22 kështu, Dëshmitar?

23 PË. Po, deri me 21 janë ba bisedat, me 21 është nënshkruar
24 marrëveshja në Prishtinë.

25 PY. A keni qenë i pranishëm në ceremoninë e nënshkrimit të

1 marrëveshjes? Besoj se po, por --

2 PË. Po, kam qenë.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në rregull. Më lejoni një moment
4 që të gjej numrin ekzakt të provës që do të kërkoj të
5 paraqitet tani. Është në provën materiale DKV01839 [Sipas
6 përkthimit].

7 PY. Atëherë do të shikojmë dy copëza videoje nga kjo
8 ceremoni.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në fakt ka një transkript kjo
10 videoja megjithatë thjeshtë mund të transmetojmë videon bashkë
11 me audion për ta dëgjuar se çfarë thuhet.

12 [Luhet videoincizimi]

13 Z. EMMERSON: [Përkthim]

14 PY. A e njohët z. Thaçi dhe z. Veseli në këtë fragmentin e
15 videos që pamë, Dëshmitar?

16 PË. Po, i njoha të dytë, edhe z. Thaçi edhe z. Veseli, aty
17 ishin.

18 PY. Po Gjeneralin Mike Jackson, të gjithë domethënë që kanë
19 mbërritur në të njëjtën kohë.

20 PË. Po, e dallova. Ai ishte nikoqiri aty, komandanti i KFOR-
21 it, i pari i KFOR-it në Kosovë, dhe ishte që e nënshkroi edhe
22 marrëveshjen.

23 PY. Pikërisht. Besoj se është e drejtë të thuhet tani apo jo,
24 që procesi i negociatave ka filluar përpara sesa të mbërrite
25 Gjenerali Mike Jackson, apo jo, Dëshmitar?

1 PË. Patjetër. Disa ditë janë zhvilluar negociatat për tekstin
2 final të marrëveshjes se ka qenë -- kam informacione që kanë
3 qenë disa formulime të cilat nuk janë, nuk kanë qenë të
4 pranueshme plotësisht për UÇK-në.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja që të transmetojë
6 tani videon DKV1240, që është një regjistrim tjetër i shkurtër
7 që ka të bëjë me ceremoninë nënshkruese të marrëveshjes me
8 datë 21 qershor.

9 [Luhet videoincizimi]

10 "[Zëri] Në komandën e KFOR-it në Prishtinë më 21 qershor,
11 gjenerali Michael Jackson bashkë me ish-udhëheqësin politik të
12 UÇK-së dhe kryeministri i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës
13 Hashim Thaçi firmosën marrëveshjen kalimtare për transformimin
14 e UÇK-së".

15 Z. EMMERSON: [Përkthim]

16 PY. Në këtë video a e shikojmë ceremoninë nënshkruese në të
17 njëjtën shtab të NATO-s, në të njëjtin vend të NATO-s ku neve
18 pamë z. Veseli dhe z. Thaçi që të mbërrinin bashkë me
19 gjeneralin Mike Jackson, Dëshmitar?

20 PË. Po, të njëjtën ditë ka qenë edhe z. Veseli dhe u
21 nënshkroi marrëveshja midis z. Thaçi dhe gjeneralit Michael
22 Jackson, në të njëjtin vend në shtabin e KFOR-it në Prishtinë.

23 PY. Një çast, ju lutem. Pyetja e fundit që desha t'ju bëja
24 për këtë videon është kjo: Personi me xhaketë të kuqe në
25 video, në videon e dytë, e njohe këtë person që të ishte Larry

1 Rossin?

2 PË. Po, e njoha. E kam njoft edhe atëherë është ky diplomati
3 Larry Rossin, të cilin e kam takuar në Dragobil të Malishevës
4 gjatë periudhës së luftës, por ka qenë i pranishëm edhe në
5 ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes për transformimin dhe
6 demilitarizimin e UÇK-së.

7 PY. Larry Rossin, siç thatë edhe ju, në atë kohë ka qenë një
8 diplomat amerikan që më pas u bë përfaqësues i SRSG-së,
9 përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm, kështu?

10 PË. Po.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të
12 pranoni këto dy pjesë të videos?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
14 kundërshtime?

15 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, s'kemi kundërshtime. Dhe ne
16 madje do të thonim që të pranohet dhe videoja e tretë që ka
17 numrin DKV01213.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju faleminderit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
20 Materiali DKV1239, DKV1240 dhe DKV01213 pranohen. Për këtë e
21 kishit fjalën?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Po, bëhet fjalë për videon e parë.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ishte pjesa në male.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ne e kemi
25 parë dhe këtë përpara.

1 Dakord. U pranuan.

2 Një çast, ju lutem.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Videoja DKV01213 dhe
4 transkriptet, marrin numrin e provës materiale 2D00022.
5 Klasifikimi është konfidencial.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mund ta riklasifikoni si publike.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
8 [Përkthim] Riklasifikoheni.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Videoja e dytë DKV1239,
10 merr numrin e provës materiale 2D00023. Kjo është e
11 klasifikuar si publike.

12 Dhe videoja e fundit DKV1240 merr numrin e provës
13 materiale 2D00024. Edhe kjo ka klasifikimin publik.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
15 Të tria videot janë me klasifikim publik tashmë.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim

17 PY. Dëshmitar, besoj se ju thatë, që të gjithë përfaqësuesit
18 e përfshirë në negociata, erdhën në Fshatin e Ri me helikopter
19 të KFOR-it për ceremoni nënshkruese në Prishtinë, kështu?

20 PË. Erdhën nga Divjaka në bazën e KFOR-it në Prishtinë.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kaq pyetje kisha. Faleminderit.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
23 Dëshmitar.

24 Z. Tulli, gati?

25 Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit.

1 Pyetje të palës tjetër nga z. Tully:

2 Z. TULLY: [Përkthim]

3 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Ka qenë një ditë goxha e lodhshme.

4 Do kem disa pyetje deri në fund të seancës së sotme dhe disa

5 pyetje për nesër paradite. Quhem Eric Tully. Dhe përfaqësoj

6 këtu Rexhep Selimin.

7 Do të filloj me disa pyetje që ju ka bërë dje Prokurori

8 që kishin lidhje me vizitën e parë që keni bërë ju në Drenicë

9 ku jeni takuar për herë të parë me Rexhep Selimin. Të gjitha

10 pyetjet që do të kem unë lidhen me një shënim që ishte në një

11 bllok shënimesh që ua tregojë Prokuroria. Shënimi kishte datën

12 18 maj 1998 dhe aty thuhet se Nuhi Bytyqi ka kërkuar që të

13 bënte një xhirim për një program special për shpërndarjen e

14 ndihmave në Drenicë dhe këshillin e emergjencave.

15 Si fillim: A ju kujtohet që u bisedua për këtë?

16 PË. Po, më kujtohet. Më kujtohet shumë mirë.

17 PY. Në rregull. Ka qenë ditë e gjatë për të gjithë. Të gjithë

18 jemi të lodhur. Tani do të doja të flisnim si kemi shkuar në

19 Drenicë në atë periudhë të vitit.

20 Fillimisht, kur shkove në Drenicë në këtë kohë ju keni

21 qenë gazetar i pavarur, apo jo, por keni pasur një lidhje me

22 një televizion, po apo jo?

23 PË. Po patjetër.

24 PY. TVSH, kështu?

25 PË. Me televizionin shqiptar. Gazetar i pavarur por

1 vullnetarisht jam paraqitur që të informojë nga zonat e
2 luftës.

3 PY. Në rregull. Përpara kësaj kishit punuar për RTP-në dhe u
4 larguat në vitet 1990, kështu?

5 PË. Po. Më 5 korrik 1990 të gjithë gazetarët dhe punëtorët e
6 tjerë shqiptarë të Radio Televizionit të Prishtinës janë
7 larguar me dhunë nga studiot tona.

8 PY. Në rregull. Kur shkuat në Drenicë për të bërë xhirimin,
9 ju ua bërë të qartë të gjithëve që kishit lidhje me TVSH-në,
10 apo e dinin personat që ju punonin dhe për TVSH-në?

11 PË. Jo, nuk e dinin që punoja për TVSH se unë herë pas here
12 kam përgatitur disa emisione nga Kosova dhe nga diaspora, por
13 nuk kam qenë pjesë e ekipit të rregullt të televizionit
14 shqiptar nga Kosova

15 PY. Nuk po të them që keni qenë staf i brendshëm. Po, për
16 shembull, në librin tuaj - është një faqe që ka marrë numrin e
17 Prokurorisë SPOE00128602 - kur jeni takuar me Fehmi Lladrovcin
18 keni thënë:

19 "Më vonë në atë mbrëmje, i kërkova Lladrovcit të jepte
20 një intervistë për TVSH-në lidhur me luftën çlirimtare të
21 Kosovës".

22 Nuk po them që ishit personel i brendshëm i TVSH-së --

23 PË. Po.

24 PY. -- po nëse po xhironit diçka si gazetar i pavarur këtë do
25 ta transmetonte TVSH-ja, ajo jo?

1 PË. Po, patjetër. Për Televizionin Shqiptar ashtu ka qenë
2 ideja.

3 PY. Flasim për kronologjinë kohore. Sipas librit tuaj në
4 prill të 1998 keni shkuar të flisni me z. Shaban Hoxha që ka
5 qenë anëtar i këshillit të emergjencave në mënyrë që t'ju
6 jepte leje që të hynit në zonën e Drenicës që të shkoni të
7 xhironit bashkë me kameramanin Abaz Zekën, kështu?

8 PË. Ashtu është.

9 PY. Për procesverbal, Shaban Hoxha ka qenë si pikë kontakti
10 nga një anë e këshillit të emergjencave qendror dhe nga ana
11 tjetër i këshillit të emergjencave komunale, pra mes këtyre
12 këshillave dhe UÇK-së. Pra, ishte si ura lidhëse me këtyre,
13 kështu?

14 PË. Ashtu e di unë.

15 PY. Jemi ende në prill, në prill shkoni tek Musë Jashari,
16 takoheni me Musë Jasharin.

17 Z. TULLY: [Përkthim] Do t'ju lexoj diçka në faqen 232 -
18 më falni sa ta gjej. SPOE00128602.

19 PY. Dhe thoni:

20 "Takimi i parë me uniformat e UÇK-së ka qenë në Baicë të
21 Drenocit, një mbrëmje në prill të 1998. Musë Jashari kishte
22 veshur uniformën, ai ishte një nga anëtarët në njësitet e parë
23 të UÇK-së dhe bashkëluftëtar i luftëtarit legjendar Adem
24 Jashari".

25 E dimë që s'e dini me saktësi datën, por ama jeni i

1 sigurt që ka qenë prill?

2 PË. Mund të jetë fundi i prillit. Fundi i prillit fillimi i
3 majit, po. Se dhe në libër nuk e kam thënë saktë. Këtë s'e kam
4 ditë. Ju thashë disa herë që nuk kam mbajtur ditar.

5 PY. Në rregull. Nuk po ju pyesja për saktësinë e datës, po në
6 libër keni thënë prilli, i qëndroni prillit?

7 PË. Ashtu kam thënë, ashtu kam mëndu. Po mund të jetë fillimi
8 i majit.

9 PY. Në rregull. Më pas jeni takuar me Fehmi dhe Xhevë
10 Lladrovcin dhe ky ka qenë përkrah Musë Jasharit edhe
11 luftëtarëve të tjerë të UÇK-së dhe këtë e keni përmendur në të
12 njëjtën faqe, apo jo?

13 PË. Po. Po, ashtu është. Është fjala për të njëjtën ditë dhe
14 për të njëjtën ngjarje.

15 PY. Të njëjtën ditë?

16 PË. Kur jam takuar me Musë Jasharin, jam takuar edhe me Fehmi
17 Lladrovcin dhe me Xheve Lladrovcin.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
19 ngadalësoni pak të dy dhe sidomos me pyetjeve dhe përgjigjeve
20 dhe ju lutem flisni sa më ngadalë të jetë e mundur të dyja
21 palët.

22 Z. TULLY: [Përkthim] Ju e keni fjalën e fundit se ju jeni
23 Gjykatësi

24 PY. Në libër thoni:

25 "Ditën e nesërme ..."

1 Domethënë, të nesërmen pasi u takuat me të gjithë këta
2 shkuat te shtëpia Hysenajt të takoheshit me Ilaz Selimin. Pra,
3 ka qenë një periudhë dy ditore nga takimi me Musë Jasharit dhe
4 Ilaz Selimin, kështu?

5 PË. Po. Aty kemi bujtur dhe të nesërmen jam takuar me Ilaz
6 Selimin dhe pastaj dhe me Rexhep Selimin.

7 PY. Rexhepi erdhi tek shtëpia Hysenajve në të njëjtën ditë që
8 takove Ilaz Selimin apo të nesërmen?

9 PË. Unë e di se të njëjtën ditë është. Tash 26 vite kanë
10 kaluar. Di që dy ditë kam qenë aty. Ditën e parë në mbrëmje
11 kemi shkuar, ka qenë, s'ka pas as rrymë. Edhe të nesërmen jemi
12 takuar me Rexhep Selimin -- me Ilaz Selimin pastaj dhe me
13 Rexhep Selimin.

14 PY. Pra, kjo që përshkruani ju në librin tuaj ka zgjatur për
15 një periudhë dy ditore, kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Të flasim për datën 18 maj. Nuk ka mundësi që takimi me
18 Rexhep Selimin të jetë mbajtur më 18 maj --

19 PË. Jo.

20 PY. -- duhet të ketë qenë shumë herët, ndonëse ju nuk ju
21 kujtohet me saktësi data?

22 PË. Jo, jo. S'është. Mund të jetë fillimi i majit. Mund të
23 jetë fillimi i majit. 18 maji në fund është.

24 PY. Në rregull. Duam të ishim të qartë.

25 Flasim për takimin që keni pasur me z. Selimi.

1 Përpara se të takoheshit -- ose do ta them kështu. Është
2 e qartë nga ajo që u ka thënë z. Selimi dhe kritika që kishte
3 për TVSH-në, se ai po ashtu e kishte kuptuar që ju kishit një
4 lidhje me TVSH-në sepse ju do të përcillnit atje dokumentar,
5 apo jo?

6 PË. Po. Unë isha deklaruar se jam i gatshëm që në kuadër të
7 televizionit shqiptar të përgatis të gjitha ato kronika,
8 emisione, dokumentare nga zonat e luftës. Dhe Rexhepi i bëri
9 ato vërejtjet që të cilat dhe unë si gazetar, si producionist
10 i pranova, por unë nuk isha pjesë e atij ekipi dhe nuk mbaja
11 përgjegjësi për mënyrën e riformimit në atë periudhë. Unë isha
12 ai që e theva akullin. U paraqita vullnetarisht. U angazhova
13 që ta paraqesë në mënyrë reale gjendjen në Kosovë, gjendjen
14 sidomos në zonat e luftës.

15 PY. Në rregull. Mesa kuptoj kritika ishte tek çështjet
16 humanitare kryesisht dhe jo në fakt te lufta çlirimtare e UÇK-
17 së, domethënë, më shumë kritika lidhej me çështjet humanitare
18 sesa me luftën, apo jo?

19 PË. Këto ishin kritika në përgjithësi për informimin, mënyrën
20 e informimit, mungonin imazhet nga zonat e luftës. Zakonisht
21 jepeshin disa raporte telefonike nga Prishtina, kështu që
22 gazetarë që raportnin nga Prishtina nuk e kishin një pasqyrim
23 real të gjendjes në zonat e luftës edhe vërejtjet e z. Selimi
24 ishin shumë të arsyeshme. Për atë edhe unë e paraqita që të
25 bëjmë imazhet televizive nga zonat e luftës dhe ta paraqesim

1 gjendjen reale, ashtu si ishte nga zonat e luftës një gjendje
2 shumë e vështirë.

3 PY. Dje në përgjigje të një pyetjeje të Prokurorit që është e
4 reflektuar në transkriptin e ditës së djeshme në faqen 59, ju
5 thatë:

6 "... e gjithë popullata ishte e pakënaqur me
7 informacionin që vinte nga zonat e luftës ..."

8 E kam kuptuar unë drejtë nga përgjigja juaj që në fakt
9 kritika që bëri z. Selimi s'ishte kritikë që e kishte vetëm
10 ai? Ishte diçka që ju e kishit dëgjuar dhe prej persona të
11 tjerë.?

12 PË. Po ju kuptoj. Nuk është bërë ndonjë anketë kështu e
13 detajuar se të gjithë janë të pakënaqur e janë të kënaqur, por
14 përgjithësi ishte që opinionin nuk ishte i kënaqur informimin
15 nga zonat e luftës. Edhe unë si gazetar po ashtu nuk isha i
16 kënaqur. Ashtu ishte opinionin dhe i z. Selimi, por dhe në
17 përgjithësi e opinionin.

18 PY. Dje kur ju treguan një komunikatë politike të UÇK-së
19 kritika që theksohej në atë komunikatë ishte një ndjesi e
20 përgjithshme çfarë ndienin personat në përgjithësi sa i
21 takonin raportimit në këto zona, kështu?

22 PË. Ashtu, po.

23 PY. Flasim tani për shënimin. Në shënim thuhet Nuhi Bytyqi
24 reporter i RTP-së kërkon të filmojë për një program special
25 diçka për ndihmat në Drenicë dhe për këshillin e emergjencave.

1 Askush nga personat që takove këto dy ditë në Drenicë nuk
2 e dinte që ju punonit për RTP-në atje, personat që takuat atje
3 e dinin që ju punonit për RTP-në?

4 PË. Jo, se nuk kishte RTP atëherë. Ishte një ekip i vogël që
5 punonte për televizionin shqiptar, por ashtu është identifiku
6 emri im si gazetar i RTP-së se kam punuar në RTP.

7 PY. Megjithatë, ata që e kanë bërë shënimin në atë bllok i
8 bie që nuk është, i takon që ai personi që ka bërë shënimin
9 është një person që nuk e keni takuar ju ato ditë sepse do ta
10 dinte për ndryshe që ju nuk punonit për RTP-në, apo jo? Por që
11 fakt do ta transmetonit për TVSH-në këtë? A e pranoni
12 parashtrimin tim?

13 PË. Po. Këtë Ymer Halimin e kam takuar bashkë me Shaban
14 Hoxhën në Prishtinë edhe jemi konsultuar sesi ta realizojmë
15 një emision të posaçëm për gjendjen e popullatës civile dhe
16 për ndihmat humanitare, furnizimin me ndihma, me ushqim dhe me
17 artikuj tjerë elementar ushqimor dhe mjekësor.

18 PY. Kjo është xhiruar ë 22 maj 1998, për këtë po thua?

19 PË. Me siguri atë ditë është xhiruar.

20 PY. Në rregull. Po e lë këtë temë për momentin dhe do të
21 flasim për përshkrimin, atë që keni xhiruar kur keni bërë
22 programin. Kjo është në fakt e përshkruar në faqen

23 SPOE00128608:

24 "Për herë të parë si korrespondent i TVSH-së, në kronikat
25 e mia raportova që Ushtria Çlirimtare po luftonte kundër

1 policisë serbe dhe forcave ushtarake dhe se UÇK-ja po
2 konsolidonte edhe gjithnjë e më shumë rangjet e veta, po bëhej
3 gjithnjë më e fortë, kishte një nivel më të mirë organizimi
4 dhe po merrte furnizime dhe armë për të luftuar forcat serbe
5 në Llaushë".

6 PË. Po, kjo është --

7 PY. Pra, kjo është diçka që u lejua të filmohej?

8 PË. Po. Jo, nuk është filmuar kjo. Kjo është raport telefonik
9 i imi nga Skënderaj. Thashë edhe ma herët, po data është e
10 saktë më 22 maj kam hyrë me kameramanin Abaz Zekaj në
11 Skënderaj. Dhe nga nënkëshilli për të drejtat e njeriut në
12 Skënderaj, nga telefoni i këtij nënkëshilli e kam dërguar një
13 kronikë për televizionin shqiptar për lajmet e televizionit
14 shqiptar. Do të thotë, nuk ka pas imazhe por kanë qenë imazhe
15 kryesisht nga arkivi. Por aty kam theksuar se Ushtria
16 Çlirimtare e Kosovës po lufton për çlirimin e Kosovës. Kam
17 përshkruar situatën dhe stacionimin e forcave të mëdha
18 policore në Skënderaj dhe në drejtim të Llaushës dhe të
19 fshatrave tjetër të kësaj komune.

20 PY. Këtu thotë "armë të rënda". Çfarë armatimesh të rënda
21 kishte UÇK-ja në prill të 1998?

22 PË. Jo, është fjala për maj, 22 maj, se mos ke ngatërru
23 datën. Më 22 maj.

24 PY. Po 22 maj. Po 22 maj.

25 PË. Po nuk kishte armatim të rëndë. Por doja para opinionit

1 me kriju përshtypjen se UÇK-ja ka armatim, të mos frigohen
2 njerëzit, ta mbështesin atë. Me inkuraju më shumë. Ky ka qenë
3 qëllimi im.

4 PY. Në fakt shumë nga pyetjet e mia ditën e nesërme do
5 fokusohen tek kjo.

6 Z. TULLY: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a mund ta mbyll
7 tani sepse do të vazhdoj nesër me këtë dëshmitar.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, në
9 rregull. Për sot mbaruam. Do fillojmë sërish nesër në orën
10 9.00. Dhe shpresojmë që nesër të mbarojmë dëshminë tuaj edhe
11 ju besoj doni të njëjtën gjë.

12 Tani mund të largoheni nga salla e gjyqit me Asistenten,
13 faleminderit që ishit këtu sot.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rifillojmë --

16 Z. HALLING: [Përkthim] A mund të na thotë Trupi Gjykses
17 për dëshmitarët rezervë, çfarë do bëjmë për dëshmitarët
18 rezervë?

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitarin e
20 dytë nuk do ta kemi. Dëshmitari i parë dy orë kishte pak a
21 shumë, apo jo, përfshirë këtu kundërpjetet dhe pyetjet e
22 Prokurorisë, kështu që mbase mund të kemi mundësi që ta
23 mbarojmë atë dëshmitar nesër.

24 Z. TULLY: [Përkthim] Unë nëse ju ndihmon do kem dhe 45
25 minuta nesër. Biles do përpiqem që të bëj gjysëm ore vetëm

1 nesër me këtë dëshmitar.

2 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Dhe unë do të kem gjysmë ore
3 më pak.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kështu që
5 ekziston një mundësi që ta vejmë dëshmitarin e parë rezervë që
6 ishte parashikuar për nesër po me siguri që dëshmitarin e dytë
7 jo.

8 Rifillojmë nesër në orën 9.00

9 --- Seanca mbyllet në orën 16.26

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25